

Raiffeisen Bank Albania

Annual Report 2010

WEL



**Raiffeisen
BANK**

Fitoni çdo sfidë

Since 2005, as a trusted financial partner, Raiffeisen Bank has helped its clients to reach their full potential. Rising up to the challenge launched by the Government of Albania to turn this amazing country into a top tourist destination, we would like to share with you a series of unpublished pictures of Albania's most attractive sites.

Që nga viti 2005, Raiffeisen Bank, si partner i besuar financiar ka ndihmuar klientët të realizojnë potencialin e tyre. Duke e pranuar sfidën e qeverisë Shqiptare për ta kthyer këtë vend të mrekullueshëm në një destinacion kryesor turistik, ne duam t'ju tregojmë ju, nëpërmjet një seti fotosh të papublikuara më parë, vendet më tërheqëse të Shqipërisë

COME

Raiffeisen Bank Albania

Raport Vjetor 2010

Përmbajtje

Mesazh nga Kryetari i Këshillit Drejtues	114
Mesazh nga Drejtori i Përgjithshëm	115
Misioni	116
Perspektivat dhe Planet për vitin 2011	117
Raporti i Bordit Drejtues	120
Zhvillimet ekonomike	120
Rezultatet Financiare	121
Raporti i Segmenteve	128
Segmenti Korporatë	128
Segmenti i Ndërmarrjeve të Mesme	129
Zhvillimi i Segmenteve të Klientëve	130
Divizioni i Produkteve	131
Divizioni i Zhvillimit të Rrjetit	133
Rrjeti i Shitjes dhe Shpërndarjes	134
Thesari dhe Bankingu i Investimeve	138
Të Ardhurat Fikse	138
Tregu i Parasë	138
Këmbimi Valutor	139
Shitjet e Thesarit	139
Përgjegjësi Sociale	142
Burimet Njerëzore dhe Trajnimet	146
Raporti i Auditorit të Pavarur	152
Raiffeisen Leasing	198
Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen sh.a	200
Raiffeisen Bank International një vështrim i shkurtër	202
RZB dhe Grupi Bankar Austriak Raiffeisen	203
Rrjeti i Raiffeisen Bank SHA	206
Adresa dhe Kontakte	207
Fjalori Raiffeisen	210



Antarët e Bordit Drejtues të Raiffeisen Bank SHA

Christian Canacaris

Drejtor i Përgjithshëm

Raphaela Bischof-Rothauer

Antar Bordi për Operacionet dhe TI

John McNaughton

Antar Bordi për Reatil

Alexander Zsolnay

Zëvendës Drejtor i Bordit Drejtues

Mesazh nga Kryetari i Këshillit Drejtues


Zonja dhe zotërinj,

Edhe pse drejtuesit ekzekutiv të bankave e kujtojnë 2009-ën si një vit shumë intensiv, 2010-ta solli standarte të reja nga pikpamja e intensitetit. Sidoqoftë, këtë herë përpjekjet tona kishin fokus të brendshëm, pasi kemi punuar për një riorganizimin të ndjeshëm të Grupit. Raiffeisen International, banka e mëparshme mëmë e Raiffeisen Bank Albania sh.a, u bashkua me pjesët më kryesore të biznesit të Raiffeisen Zentral Bank (RZB) për të formuar kështu Raiffeisen Bank Internamntional, e cila u regjistrua në regjistrin tregtar në Tëtor. Një nga qëllimet kryesore të bashkimit ishte kombinimi i rritjes së dëndur të Raiffeisen International në Evropën Qendrore dhe Lindore, me ekspertizën e zhvillimit të produkteve në fushën e Korporatave dhe Bankingut të Investimeve, duke gjeneruar kështu vlerë të shtuar si për klientët ashtu edhe për aksionerët tanë. Për më tepër, RBI tani përfiton nga mundësi më të mira rifinancuese – ndërkohë që më parë Raiffeisen International aksesonte më lehtë tregjet e kapitalit ndërsa RZB-ja tregjet e borxhit, RBI tashmë mund t'i aksesojë të dyja njëkohësisht.

2010-ta ishte gjithashtu viti gjatë të cilit tregu ynë primar; Evropa Qendrore dhe Lindore shfaqti shenjat e para të rimëkëmbjes pas humbjes së konsiderueshme të likuiditetit gjatë fundit të 2008-ës dhe rënies ekonomike. Rëniet në zhvillim gjatë 2009-ës ia lanë vendin përmirësimit të dukshëm ekonomik. Krahas stabilitetit në rritje në zonën e Evropës Qendrore dhe Lindore, pritshmëritë e ekonomistëve janë për një rikthim të këtyre tregjeve në nivele më të larta zhvillimi se ato të zonës së euros. Ne presim që rritja në Evropën Qendrore dhe Lindore të jetë 2 përqind më e lartë se në ekonomitë e Evropës Perëndimore. Nxitësi i këtij trendi është potenciali i vazhdueshëm për të qenë në nivelet e rajonit, i cili në terma afatgjatë do ta shndërrojë në zonën e zhvillimit të Evropës.

Pamvarsisht shkrirjes dhe zgjerimit të zonës sonë të operimit, Evropa qendrore dhe lindore do të mbetet në fokus të strategjisë sonë.

Rezultatet e vitit 2010 dëshmojnë që ne ndërmorrëm masat e duhura gjatë krizës. Edhe pse portofoli i kredive të këqija shënoi rritje të lehtë, rritje e cila ne presim të kulmojë gjatë vitit 2011, Grupi RBI shënoi fitime që kapën shifrën e 1,087 milionë Euro. Kjo do të thotë 142 përqind rritje krahasuar me vitin e kaluar, një performancë shumë e mirë edhe nga pikpamja ndërkombëtare. Rimëkëmbja ekonomike, masat e ndërmarra gjatë vitit aktual për të përmirësuar eficiencën dhe konkurrencën, ashtu sikurse edhe besimi i treguar nga klientët dhe aksionerët tanë, më bëjnë të ndjehem mjaft konfident për të gjithë Grupin gjatë 2011-ës.



Heinz Hödl
Kryetar i Këshillit Drejtues

Mesazh nga Drejtori i Përgjithshëm

Me kënaqësi ju njoftoj se Banka Raiffeisen e ka mbyllur me sukses vitin financiar 2010. Jam veçanërisht krenar për këtë, sepse viti 2010 ishte një vit i vështirë dhe me mjaft sfida. Megjithatë ne i arritëm objektivat tona të fitimit, ruajtëm pozicionin numër një në të gjithë treguesit kryesore, por mbi të gjitha përfunduam ristrukturimin e brendshëm të Bankës. Tani ne jemi gati për një vit të suksesshëm 2011.

Besimi te bankat u kthye në fillim të vitit dhe Banka Raiffeisen pati përsëri një rritje të depozitave. Pasivet tona u rritën me 9 përqind krahasuar me vitin 2009 dhe arritën në 1.8 miliard Euro duke na lënë në këtë mënyrë mjaft hapësirë për të kredituar ekonominë. Jemi banka së cilës i besojnë më shumë se gjysmë milionë klientë në mbarë vendin, të cilëve u ofrojmë një gamë të gjerë produktesh kursimi.

Kompanitë dhe individët treguan shenja pozitive për huamarrje duke rritur kërkesën për likuiditete, kërkesë e cila u plotësua nga Banka Raiffeisen. Ne rritëm ndjeshëm huatë si për korporatat kombëtare dhe ndërkombëtare. Kredidhënia ndaj kompanive të mëdha u rrit me 22 përqind në 460 milionë Euro, e cila tragon zhvillimin ekonomik. Si rrjedhojë, asetet tona u rritën me 10 përqind në 2 miliard Euro.

Niveli ynë i likuiditetit, i cili matet nga raporti kredi/depozita, vazhdoi të ishte i qëndrueshëm në 45 përqind, që do të thotë se rritëm kredidhënien dhe ishim në gjendje të investonim në bono thesari dhe obligacione të Qeverisë Shqiptare, duke e ndihmuar në këtë mënyrë edhe më shumë ekonominë e vendit.

Në fokusin tonë vazhdoi të mbetej përmirësimi dhe zgjerimi i rrjetit të degëve ku janë shtuar edhe dy qendra biznesi duke e çuar numrin e degëve në 103. Shërbimi ndaj klientit vazhdon të jetë në focus bashkë me ATM-të dhe pikat e shitjes (POS) duke u ofruar klientëve tanë të gjitha mjetet për të aksesuar llogaritë e tyre 24 orë në 7 ditë të javës.

Ne vazhduam të optimizonim bazën tonë të kostos dhe gjatë vitit të fundit arritëm një tjetër ulje të konsiderueshme të kostos duke e çuar raportin kosto / të ardhura në 31.8 përqind ose 0.17 përqind më të ulët se në vitin 2009

Raiffeisen Leasing vazhdoi të mbetej një zgjedhje mjaft e pëlqyer për kompani dhe individë që donin të financonin makineri, pajisje, automjete për transport mallrash dhe makina. Raiffeisen Leasing zë vendin e parë në tregun e lizing-ut në Shqipëri.

Raiffeisen Pensions pati një vit të jashtëzakonshëm duke përmbytur të gjithë hapat e nevojshëm ligjorë dhe duke u bërë kompania e parë e licensuar nga Autoriteti i Konkurrencës. Një gamë e re produktesh të pensioneëve u hodhën në treg në fund të vitit 2010, ndërkohë që gjatë vitit 2011 kompania do të jetë në funksion të plotë.

2011-ta do të jetë një vit me mjaft sfida. Ne do të na duhet të punojmë shumë për të arritur objektivat tona. Por ne jemi gati të përballemi me zhvillimet e reja, punonjësit tanë janë të trajnuar, të fokusuar, dhe të vendosur për ta parë Bankën Raiffeisen në pozicionin numër një në sektorin bankar në vend. Unë kam besim tek ata dhe e di se viti 2011 do të jetë një tjetër vit i suksesshëm për të gjithë ne. Ne do të bëjmë ndryshimin duke ofruar produktet dhe shërbimet më të mira, në mënyrën më të mirë nga profesionistët më të mirë.



Christian CANACARIS
Drejtor i Përgjithshëm
Kryetar i Bordit Drejtues



Misioni

Ne rrisim standardet bankare dhe bëjmë ndryshimin në jetën e konsumatorit duke ofruar produkte konkurruese dhe shërbime me cilësinë më të mirë.

Ne kërkojmë marrëdhënie afatgjata me klientët.

Si anëtarë të Raiffeisen Bank International, ne bashkëpunojmë ngushtë me RBI-në dhe me anëtarët e tjerë të grupit.

Ne arrijmë një kthim mbi kapitalin të qendrueshëm dhe mbi mesataren.

Ne i japim mundësi punonjësve tanë të jenë sipërmarrës, të tregojnë iniciativë dhe nxisim zhvillimin e tyre.

Perspektivat dhe Planet për vitin 2011

Pas sfidave të vitit 2010 Banka Raiffeisen vazhdon të rritet dhe t'i ofrojë më shumë ekonomisë së vendit. Konkurrenca do të mbetet e lartë në vitin 2011, por ne e dimë se çelësi i suksesit tonë është afrimi me klientët dhe bashkëpunimi me ta për t'ia dalë mbanë në këtë mjedis sfidues, ndërkohë që do të vazhdojmë investimet në produkte, shërbime dhe teknologji të reja.

Cilësia e shërbimit ndaj klientit në të gjitha segmentet tona do të vazhdojë të jetë përparësi. Trajnimi dhe zhvillimi i punonjësve, përmirësimi i efikasitetit, proceset e thjeshtësuara dhe një akses gjithmonë e më i përshtatshëm nëpërmjet kanaleve të shpërndarjes do të ndihmojnë për të arritur këtë qëllim.

Si Banka me kredithënien më të lartë në Shqipëri ne synojmë ta ruajmë këtë pozicion në vitin 2011, duke e vënë theksin në veçanti të rritja e cilësisë së portofoleve të ndryshme të kredive. Një rëndësi e veçantë do t'i jepet rritjes së segmenteve tona të biznesit, duke filluar nga klientët Individidë, Mikro, Bizneset e Mesme dhe deri te ata Korporatë.

Në segmentet e biznesit të Mesëm dhe Korporatë do të vazhdojmë të fokusohemi jo vetëm te kreditë, por edhe te ofrimi i një gamë të gjerë shërbimesh bankare si për bizneset ashtu edhe për punonjësit e tyre. Zgjerimi i shërbimeve të bankigut elektronik do të vazhdojë të mbetet përparësi në vitin 2011 dhe ne gjithashtu do të hedhim në treg produkte dhe shërbime risi.


Banka do të vazhdojë t'u ofrojë klientëve produkte të shkëlqyera depozitash dhe kursimesh nëpërmjet kushteve të reja dhe interesave mjaft tërheqëse. Bankingu elektronik për bizneset me pakicë do të plotësohet me hedhjen në treg të M-Payments, duke mundësuar për klientët Individidë fleksibilitet maksimal dhe mënyra të ndryshme për t'i kryer transaksionet bankare nëpërmjet telefonit celular kudo dhe në çdo kohë. Rrjeti i degëve vazhdon të përmirësohet me standardet e reja të cilat janë duke u zbatuar, si edhe me zhvendosjen e disa degëve në vende më të mëdha dhe më të përshtatshme për t'u ofruar klientëve tanë një shërbim më të mirë.

Bordi Drejtues i Bankës Raiffeisen dëshiron të falënderojë sinqerisht të gjithë klientët dhe partnerët e saj të biznesit për bashkëpunimin dhe mbështetjen e tyre gjatë vitit 2010. Jemi plotësisht të përkushtuar për të përmbytur kërkesat tuaja bankare dhe për t'ju ofruar një shërbim të cilësisë së lartë në çdo pikë takimi që ju keni me Bankën.

Ne kemi besim të plotë se do të vazhdojmë ta mbajmë këtë premtim në vitin 2011.



Christian Canacaris
Drejtor i Përgjithshëm



Alexander Zsolnay
Zëvendës Drejtor i
Bordit Drejtues



Raphaela Bischof
Antar Bordi për
Operacionet & TI



John McNaughton
Antar Bordi për Biznes Retail





Dhërmi: kombinimi perfekt i natyrës së virgjër dhe një fshati turistik që tërheq elitën e rinisë shqiptare. Një nga destinacionet më tërheqëse të stinën së verës, me det të kristlatë, fshati është 42 kilometra në jug të Vlorës dhe në një lartësi prej 200m mbi nivelin e detit.

Raporti i Bordit Drejtues

Zhvillimet ekonomike

Gjatë vitit 2010 Shqipëria vazhdoi të kishte një rritje më të mirë ekonomike se sa shumica e vendeve të tjera të rajonit. Rritja vjetore e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) gjatë tremujorit të tretë të vitit 2010 ishte 4.9 përqind sipas INSTAT-it. Vlerësimet e para për rritjen e përgjithshme vjetore të PBB gjatë vitit 2010 parashikojnë një rritje prej rreth 3.5 – 4 përqind.

Spektori ekonomik që ka patur performancën më të mirë gjatë vitit 2010 ka qenë industria me një rritje mbi 25 përqind nga viti në vit. Kjo për arsye se gjatë vitit 2010 janë rritur ndjeshëm eksportet e energjisë elektrike si pasojë e prurjeve të shumta të burimeve hidrike. Gjithashtu investimet e vazhdueshme për përmirësimin e infrastrukturës kanë ndikuar që transporti dhe sektori i shërbimeve të rriten me 11 përqind dhe 8 përqind përkatësisht. Sektori i cili vazhdon të vuajë është ndërtimi, me një rënie prej -24 përqind krahasuar me një vit më parë.

Polikat ekonomike të kujdesshme kanë bërë të mundur që inflacioni mesatar për vitin 2010 të jetë në nivelin e 3.5 përqind, duke qenë kështu brenda objektivit afatgjatë të 3±1 përqind.

Me gjithë nivelin e kufizuar të integritimit të Shqipërisë në tregjet financiare, kriza globale ka mundur gjithsesi të transmetohet në vend. Efektet e krizës përgjithësisht janë pasqyruar tek zhvlerësimi i monedhës vendase kryesisht kundrejt monedhës Evropiane. Që nga fillimi i krizës, zhvlerësimi kumulativ i monedhës vendase kundrejt Euros është rreth 14 përqind.

Ekonomitë e dobësuar të vendeve fqinjë si Greqia dhe Italia kanë patur një ndikim kryesor në transmetimin e krizës në Shqipëri. Të dy këto shtete janë partnerët kryesorë tregtarë të Shqipërisë, tregtia me të cilët përbën rreth 70 përqind të të gjitha eksporteve dhe rreth 40 përqind të të gjitha importeve. Rënia ekonomike e këtyre vendeve ka patur si pasojë uljen e eksporteve të shumë produkteve. Gjithashtu shumica e emigrantëve shqiptarë jetojnë në këto dy shtete dhe remitancat e tyre janë një burim shumë i rëndësishëm i të ardhurave në monedhë të huaj, kanë rënë me rreth -5.4 përqind nga viti në vit deri në fund të tremujorit të tretë të vitit 2010.


Defiçiti buxhetor u reduktua gjatë vitit 2010 si pasojë e uljeve të shpenzimeve qeveritare me -4.7 përqind dhe rritjen e të ardhurave me 8.5 përqind nga viti në vit.

Sistemi bankar në Shqipëri vazhdoi të ketë një rritje të qëndrueshme edhe në vitin 2010. Totali i aktivave të sektorit bankar tejkaloi vlerën e 7 miliard euro (e konvertuar) në fund të Dhjetorit 2010, duke u rritur me 11.8 përqind nga viti në vit ose me një vlerë prej rreth 752 milionë euro. Totali i kredive të dhëna nga i gjithë sistemi bankar u rrit me rreth 9.1 përqind krahasuar me një vit më parë, duke patur një rritje më të ulët se sa rritja e totalit të aktivave. Ky nivel relativisht i ulët i rritjes së kreditimit të ekonomisë reflekton situatën ekonomike të vendit.

Cilësia e portofolit të kredive bankare u përkeqësua ndjeshëm gjatë vitit 2010, ku rreth 14 përqind e të gjitha kredive janë kredi me vonesë. Në fund të vitit 2009 ky tregues ishte në nivelin 10.5 përqind të të gjitha kredive.

Niveli i besimit në sistemin bankar Shqiptar mbetet i lartë dhe kjo duket qartë nga rritja e volumit të depozitave prej rreth 17.6 përqind krahasuar me një vit më parë ose me rreth 880 milionë euro (të konvertuara) depozita të reja


Rritja e Prodhimit të Përgjithshëm Bruto (%nga viti në vit)



Rezultatet Financiare


Totali i aktiveve në fund të vitit 2010 ishte 277,984 milionë lekë (2009: 253,203 milionë lekë). Në 2010 vazhdoi zgjerimi i mëtejshëm i portofolit të kredisë, i cili në fund të vitit 2010 përfaqësonte 35 përqind (2009: 35 përqind) të totalit të aktiveve të bankës. Investimet në letra me vlerë vazhdojnë të zënë pjesën më të madhe të totalit të aktiveve të bankës duke përfaqësuar rreth 48 përqind të këtij totali në 2010 (2009: 51 përqind).

Struktura e Bilancit - Aktivi (në '000 LEK)




Totali i huave dhe paradhënieve për klientët në fund të vitit 2010 ishte 107,676 milionë lekë (2009: 94,277,312 milionë lekë) duke përfaqësuar kështu një rritje prej 14 përqind të portofolit të kredisë gjatë këtij viti. Sektori i Korporatave përfaqëson 63 përqind të totalit të portofolit të kredisë dhe zuri vendin kryesor në këtë portofol me një tepricë kredisë prej 67,364 milionë lekë (2009: 55,171 milionë lekë). Segmentet e Ndërmarrjeve të Mesme shënuan një rënie në portofolin e kredisë përkatësisht 5 përqind. U shënuan një rritje në portofolin e kredisë prej 77 përqind për segmentin e ndërmarrjeve të vogla me një tepricë prej 3,460 milionë lekë (2009: 1,952 milionë lekë).

Struktura e Hua dhe Paradhënie për klientët




Në 2010 portofoli i kredisë përbëhet kryesisht nga një kombinim i kredisë afatmesme prej 20 përqind (2009: 19 përqind) dhe paradhënies bankare prej 47 përqind (2009: 48 përqind). Kredia afatgjatë përfaqëson 21 përqind të totalit të portofolit të Bankës për 2010 (2009: 20 përqind).

Kredi gjatë vitit 2010
(në '000 LËK)




2010 shënoi një rënie 14 përqind të fitimit pas taksës në krahasim me 2009 në 5,361 milionë lekë (2009: 4,694 milionë lekë) duke ndryshuar raportin e kthimit mbi kapitalin nga 23.4 përqind në 2009 në 23.45 përqind në 2010. Dividendi i deklaruar dhe i paguar në 2010 është 2,206 milionë lekë (2009: 0).

Struktura e Bilancit - Pasiv (në '000 LEK)




Ashtu si në 2009, profili i depozitave të klientëve tregon një tendencë të depozituesve për t'u larguar nga depozitat me afat të shkurtër maturimi. Me qëllim përfitimin nga interesat më të larta, klientët po investojnë kursimet e tyre në depozita me afat më të gjatë maturimi. Totali i depozitave të klientëve në fund të vitit 2010 është 188,593 milionë lekë (2009: 163,231 milionë lekë).

Struktura e Depozitave (në '000 LEK)




2010 shënoi një rënie 14 përqind të fitimit pas taksës në krahasim me 2009 në 5,361 milionë lekë (2009: LEK 4,694 milionë lekë) duke ndryshuar raportin e kthimit mbi kapitalin nga 23.4 përqind në 2009 në 23.45 përqind në 2010. Dividendi i deklaruar dhe i paguar në 2010 është 2,206 milionë lekë (2009: 0).

Struktura e Kapitalit Aksioner
(në '000 LEK)




E ardhura neto nga interesat u rrit me 11 përqind ose nga 10,776 milionë lekë në 2009, në 11,980 milionë lekë në 2010. Rritja e të ardhurës nga interesat bashkë me rritjen e totalit të aktiveve të bankës prej 10 përqind, ndikoi në përmirësimin e kësaj të ardhure (llogaritur si raport i të ardhurës nga interesat mbi mesataren vjetore të totalit të aktiveve) duke e rritur atë me 26 pikë ose shprehur ndryshe nga 4.25 përqind në 2009 në 4.51 përqind në 2010.

Të ardhura neto
(në '000 LEK)



Shpenzimet administrative në total gjatë 2010 arritën në 1,578 milionë lekë (2009: 1,503 milionë lekë). Efiçenca operuese e Bankës – raporti kosto/të ardhura u përmirësua nga 32 përqind në 31.8 përqind. Në kategorinë e shpenzimeve “Tarifa dhe Konsulencë Ligjore” përfshihen dhe shpenzimet për administrimin e zyrës qendrore, të cilat arrijnë në 76 milionë lekë (2009: 211 milionë lekë). Shpenzimet për stafin u rriten me 10 përqind ose 2,041 milionë lekë në 2010 krahasuar me 1,727 milionë lekë në 2009.

Shpenzime operative 2010
(në '000 LEK)







Durrës Një nga qytetet më të vjetra të Shqipërisë, dhe porti më i madh i vendit, Durrësi shtrihet në një gadishull të vogël në bregdetin e Adriatikut. Është në një nga pikat më të ngushta të Adriatikut, dhe plazhi më i madh dhe më i vizituar në Shqipëri. Numri i turistëve, shumica e të cilëve frekuentojnë plazhin gjatë periudhës së verës është rreth 600,000 në vit.

Raporti i Segmenteve

Segmenti Korporatë

Segmenti Korporatë ka vazhduar të rrisë ndjeshëm portofolin e kredive dhe të depozitave, pavarësisht pengesave të ndryshme si rezultat i zhvillimeve ekonomike globale.

Zhvillimi i Segmentit Korporatë është në nivele të kënaqshme dhe në përputhje me parashikimet e bëra. Është rritur baza e klientëve të bankës në këtë segment gjatë vitit 2010 dhe në të njëjtën kohë janë intensifikuar marrëdhëniet me klientët ekzistues.

Raiffeisen Bank, ka mbajtur pozicionin e saj si lider në treg për këtë segment. Fokusi kryesor si dhe në vitet paraardhëse ka qenë ruajtja dhe përmirësimi i shërbimit ndaj klientëve ekzistues sikundër edhe përvetësimi i klientëve të rinj.

Ndryshimet në strukturën organizative, siç është krijimi i Departamentit të Menaxhimit të Shitjeve dhe Divizionit të Produkteve me njësi të dedikuara për Financat Tregtare, kanë dhënë rezultate pozitive në rritjen e portofolit, dhe kanë kontribuar në manaxhimin e marrëdhënieve me klientët në mënyrë më efektive.

Ekspertët e Divizionit të Korporatave ofrojnë një spektër të gjerë produktesh, shërbimesh, zgjidhjesh financiare të strukturara në përputhje me nevojat e bizneseve në mënyrë specifike.

Nga pikpamja e segmentimit të klientëve, Divizioni i Korporatave është i fokusuar në ndërtimin e marrëdhënieve afatgjata me:

- Korporatat vendase të cilat operojnë në tregun shqiptar;
- Korporatat ndërkombëtare aktualisht prezente ose të interesuara të investojnë në tregun shqiptar;
- Institucionet Publike dhe Pushtetit Qendror dhe Lokal;
- Institucionet Financiare.

Stafi i Divizionit Korporatë në sajë të eksperiencës disa vjeçare, është i gatshëm t’u sigurojë klientëve alternativën më të mirë bankare në Shqipëri duke garantuar besueshmëri, efektivitet, siguri dhe orientim drejt shërbimit ndaj klientit.

Shërbimi i dedikuar i klientelës së Raiffeisen Bank dhe njohja mjaft e mirë e nevojave të larmishme të klientëve ka dhënë rezultatet e saj në forcimin e marrëdhënieve të biznesit me operatorë të industrive si: Tregtimin e karburanteve dhe nënprodukteve të tij, Sektori i Energjisë së Rinovueshme, Projektet Infrastrukturore, Telekomunikacioni, Tregtisë, etj.

Portofoli i kredisë së segmentit të korporatave shënoi një rritje prej 21 përqind krahasuar me një vit më parë. Gjithashtu, edhe portofoli i depozitave të këtij Segmenti është rritur me mbi 94 përqind krahasuar me një vit më parë.

Përpos krizës ekonomike që shoqëroi vitin 2010 e cila pati ndikim në rritjen e kredive me probleme duke rritur vëmendjen e të gjithë strukturave të bankës përgjatë gjithë vitit, rezultatet e arritura dhe oportunitetet e tregut shqiptar na bëjnë të besojmë për zhvillime të suksesshme biznesi për vitet në vijim.

Të ardhurat e tjera të realizuara nga produkte dhe shërbime si: këmbimet valutore, produktet e Manaxhimit të Cash-it, etj, kanë patur një rritje të lehtë në krahasim me vitin 2009.

Është e rëndësishme të theksojmë se Raiffeisen Bank ka patur privilegjin t’u shërbejë 984 klientëve Korporatë që operojnë në Shqipëri dhe jashtë saj, duke vepruar si këshilltar kryesor financiar për më shumë se 20 përqind prej tyre.

Si pjesë e grupit bankar Raiffeisen Bank International – bankë lider në Evropën Qendrore dhe Juglindore, ne kemi patur mundësi që të përdornim sinergjinë e grupit si në ndarjen e njohurive ashtu edhe në financimet e projekteve të mëdha në Shqipëri.

Sektori Publik

Përgjatë vitit është arritur të ndërtohen dhe të ruhen marrëdhënie të shkëlqyera midis Raiffeisen Bank dhe Institucioneve Publike. Banka ka ruajtur pozicionin kryesor në marrëdhëniet me Sektorin Publik nëpërmjet strategjive specifike, produkteve dhe shërbimeve si dhe sistemeve të komunikimit të dedikuara në përputhje me kërkesat e këtij sektori. Disa nga projektet më të rëndësishme publike në infrastrukturë, janë mbështetur dhe përkrahur nga produktet dhe shërbimet tona Bankare.

Divizioni i Produkteve Korporatë

Manaxhimi i Cash-it

Pagesat dhe Shërbimet e Manaxhimit të Cash-it janë ndër bizneset kryesore në segmentin Korporatë. Gjatë vitit 2010 janë hedhur në treg produkte të reja, është përmirësuar shërbimi ndaj biznesit dhe punonjësit e Bankës janë trajnuar në mënyrë që të kënaqin nevojat e klientëve në lidhje me produktet e manaxhimit të Cash-it.

Projekte Financiare

Megjithëse kjo njësi është krijuar gjatë vitit 2009, numërohen disa projekte të cilat janë strukturuar dhe administruar suksesshëm gjatë vitit ushtrimor 2010. Raiffeisen Bank ka luajtur rolin e liderit në sindikimin e projekteve të rëndësishme financiare, duke bashkëpunuar me institute të tjera finciare vendase dhe të huaja gjithashtu.

Produktet e Financës Tregtare

Raiffeisen Bank sh.a iu ofron këshillim klientëve të saj lidhur me përdorimin e duhur të transaksioneve të financave tregtare në mënyrë që të reduktojë riskun në marrëveshjet tregtare me partnerët e huaj përkatës. Banka ka një numër të konsiderueshëm bankash korrespondente të klasit të parë të shpërndara në të gjithë botën, të cilat operojnë si partnerë për të siguruar një performancë të suksesshme në Transaksionet e Financave Tregtare. Gjatë vitit 2010 për të siguruar suport dhe këshillim për klientët rreth transaksioneve të Financave Tregtare, është krijuar një skuadër e përkushtuar me ekspertët më të mirë të bankës për këtë kategori produktesh.

Segmenti i Ndërmarrjeve të Mesme


Gjatë 2010-ës, i kemi kushtuar vëmendje, situatës së përgjithshme në tregjet financiare, duke u fokusuar kryesisht në kreditimet cilësore dhe shitjen e produkteve të depozitave. Gjithashtu, duke u bazuar në situatën e paraqitur të tregut në vitin 2010, kemi ndryshuar strategjinë e segmentit tonë për vitet e ardhshme.

Raiffeisen Bank është e para bankë në Shqipëri e cila ka ndarë Bizneset e Vogla (Segmentin Mikro) dhe Kompanitë e Mesme në mënyrë që të sigurohet më shumë kujdes për secilin nga segmentet. Gjatë vitit 2010, segmenti i Biznesit të Mesëm dizenoi paketa të reja të produkteve të cilat përpiqen të pasqyrojnë sjelljen e kompanive të mesme me llogaritë pranë Raiffeisen Bank.

Për segmentin e biznesit të mesëm është aplikuar gjithashtu një strukturë e re e manaxhimit gjatë vitit 2010. Manaxherët e marrëdhënieve me klientin u ri-integruan nën administrimin e drejtorisë së përgjithshme, veprim i cili reflekton fokusin e bankës për këtë segment. Struktura e re mundëson përgjigje të drejtpërdrejta dhe të shpejta të nevojave të bizneseve të mesme.

Pavarësisht nga kushtet e tregut dhe të politikës së rishikuar të kreditit, kemi financuar bizneset e mesme me kredi të reja për investime dhe për kapital punues, për një vlerë totale kredie në përdorim të kompanive prej 94 milionë Euro. Një vëmendje e veçantë i është kushtuar strukturës së portofolit dhe reduktimit të rrezikut nga mospërputhje të monedhës (shitje në monedhë të ndryshme nga monedha e kredisë) e cila mundësoi arritjen e rezultateve të mëposhtme në strukturën e portofolit:

Portofoli i Ndërmarrjeve të Mesme: Overdraft (Kredi Kufi) kundërsht Kredisë Personale



Në këtë vit, objektivi jonë ishte për të takuar më shpesh klientët tanë, për t’u siguruar që ne i njohim ata më në tërësi, dhe në mënyrë proaktive t’i këshillojmë se si të përballen me sfida të reja për aktivitetet e tyre. Ne vlerësojmë se një marrëdhënie e fortë profesionale me klientët e biznesit, është shumë e rëndësishme për bankën, për të kuptuar më mirë dinamikën e situatave të klientit, veçanërisht në sfidat e tyre për të përballuar kufizimet financiare dhe ekonomike gjatë vitit 2010. Nga ana tjetër, ne besojmë se klientët vetë, duhet të kenë partnerë të besueshëm dhe profesional, në mënyrë që të përfitojnë nga mbështetja e tyre në situata të vështira dhe të paparashikueshme financiare.

Zhvillimi i Segmenteve të Klientëve

Banka Raiffeisen manaxhon biznesin për individët në dy drejtime të rëndësishme – sipas produkteve dhe sipas segmenteve të klientëve. Manaxhimi sipas segmentit të klientëve na lejon të paraprijmë dëshirat e klientëve, të kuptojmë më mirë nevojat e klientëve dhe si përfundim të ofrojmë zgjidhje të duhura për një marrëdhënie të shëndoshë afatgjatë. Kjo pjesë e manaxhimit fokusohet në tre grupe të rëndësishme (Individë, Premium dhe Mikro) si dhe kërkon dhe përfshin nën-segmente për të rritur përfitueshmërinë për të gjithë biznesin ndërsa përmirëson avantazhet konkurruese si një bankë që fokusohet tek klienti.

Segmenti i Klientëve Individë


Ky segment përfaqëson bazën tonë më të gjerë të klientëve duke rritur numrin aktiv të tyre prej 10 përqind, deri në 613,000. Manaxhimi i marrëdhënies me klientin (CRM) u zgjerua në vitin 2010 për të na lejuar të kuptojmë dinamikën e marrëdhënies së çdo klienti me bankën (p.sh. përdorimi i produkteve), dhe për të bashkëngjitur oferta për shërbime shtesë kundrejt një grupi të madh klientësh, për të patur kështu një ndërveprim më personal. Në gjysmën e dytë të vitit 2010, pas implementimit të programit, Manaxhimi i marrëdhënies me klientin (CRM) organizoi 31 fushata, duke kontaktuar 95,000 klientë. Këto fushata rezultuan në 2.75 milionë Euro volume të reja kredie dhe 4 milionë Euro të ardhura të realizuara.

Në 2011 ne do të thellojmë të kuptuarit e kësaj baze të gjerë klientësh, do të implementojmë më shumë mjete të sofistikuar për CRM-në (CRM analitike), dhe do të rrisim personalizimin dhe penetrimin e ofertave të shitjeve të kryqëzuara tek klientët tanë më të mirë.

Segmenti Premium

Shërbimi Premium Banking iu prezantua plotësisht klientëve të segmentit në fillim të vitit 2010. Premium Banking ofrohet në 14 degë të vendosura strategjikisht me kënde të specializuara të shërbimit dhe 24 bankierë të dedikuar. Klientët Premium përfitojnë nga shërbimi i personalizuar, planet financiare dhe produktet të përshtatura për të plotësuar çdo nevojë individuale të tyre. Asnjë bankë tjetër nuk ofron shërbimin bankar Premium, kjo i jep Raiffeisen Bank një avantazh në tërheqjen, mbajtjen dhe rritjen e shërbimeve të përdorura nga klientët premium. Tashmë Premium Banking ka një portofol prej 649.9 million Euro depozita dhe 10 million Euro kredi. Gjatë vitit 2011 do të shtohen plane financiare dhe produkte të reja investimesh me qëllim që të rritet numri i klientëve të cilët gëzojnë këtë eksperiencë të veçantë dhe të personalizuar bankare.


Totali i i pasiveve dhe numri i klientëve



Segmenti Mikro

Segmenti i Bizneseve të Vogla ka vazhduar të rritet gjatë vitit 2010 duke arritur një portofol të aktiveve prej 23 milionë Euro dhe një portofol të pasiveve prej 15 milionë Euro. Përmirësimi i produkteve dhe rritja e eficiencës së procesit ndikuan pozitivisht në volumin e portofolit dhe në produktivitetin e shitjeve. 40 specialistë të marrëdhënies me Bizneset e Vogla të vendosur në 33 degë kanë ofruar një shërbim bankar të specializuar dhe të përkushtuar. Tashmë Segmenti numeron 12,350 klientë dhe krahasuar me një vit më parë është dyfishuar numri i klientëve të cilët kanë një kontratë huaje. Produktet e huasë përfshijnë: Overdraft, Kredi për Investim, Kredi për shume qëllime dhe Kredi hipotekare. Plotësimi i nevojave të përditshme të biznesit është bërë i mundur më së miri nëpërmjet paketave për bizneset: Paketa baze, Paketa argjend dhe Paketa e artë. Paketat përfshijnë llogari rrjedhëse, kartë debiti, pagesa, transferata, përdorimi i qendrës së informacionit, një specialist të përkushtuar dhe përfitime të tjera. Segmenti i Bizneseve të Vogla do të vazhdojë të jetë në fokus për Raiffeisen Bank në vitin 2011 duke synuar të rrisë pjesën e tregut nëpërmjet një shërbimi më të shpejtë dhe produkteve më konkurruese.

Kreditë Mikro dhe numri i kredive Janar
Dhjetor '10



Divizioni i Produkteve

Kartat e Kreditit

Karta e kreditit mbetet ende një produkt me penetrim të ulët në tregun bankar në Shqipëri. Gjatë tre viteve të fundit ka patur një rritje të ndjeshme të numrit të kartave të lëshuara, si dhe të transaksioneve të kryera me to. Gjatë vitit 2010 numri i transaksioneve të kryera me kartë krediti është rritur me rreth 30 përqind krahasuar me vitin 2009. Ndërsa numri i kartave të kreditit të lëshuara në treg është rritur me 18 përqind, por përsëri numri total i kartave të kreditit mbetet ende shumë i ulët krahasuar me potencialin e klientëve. Raiffeisen Bank ka shënuar një rritje prej 30 përqind në numrin e këtyre kartave të lëshuara gjatë 2010, si dhe në numrin e transaksioneve të kryera me to, ku rreth 80 përqind e zënë transaksionet e kryera në njesitë e shitjes (POS).

Strategjia e Raiffeisen Bank për 2011 është të udhëheqë fuqimisht rritjen e ndjeshme të numrit të kartave të kreditit në treg, e ndjekur më pas nga programe marketing për të stimuluar përdorimin e saj. Kjo strategji do të suportohet nëpërmjet fushatave të dedikuara CRM dhe Marketing.

Kartat e Debitit

Banka jonë vazhdon të mbetet lider në tregun e kartave të debitit. Përdorimi i këtyre kartave në pikat e shitjes (POS) është rritur kundrejt vitit të kaluar.

Klientet Pagamarrës

Ky segment përbën një vlerë të rëndësishme për Bankën, duke qenë se ata përfaqësojnë potencialin më të madh për shitjen e kryqëzuar të kredive dhe shërbimeve të tjera. Pavarësisht pozicionit tonë dominues tashmë në treg për këtë grup klientësh, paketave të ofruara të pagës dhe avantazhit në shërbimin e procesimit, ne do të vazhdojmë të përmirësojmë ofertat tona për të qëndruar Banka më e mirë në zgjedhjen e punëdhënësve dhe punëmarrësve.

Manaxhimi i marrëdhënies me punëdhënësit është i fuqishëm, proaktiv dhe i qendëruar tek klienti individ. Raiffeisen është banka me eksperiencë më të lartë në Shqipëri në procesimin e pagave dhe ka për qëllim të ofrojë shërbimin më të mirë ndaj punëdhënësve.

Avantazhet që ne ofrojmë kundrejt punonjësve janë:

1. Procesim i shpejtë i pagës. Ne kemi një eksperiencë në këtë shërbim më shumë se çdo bankë tjetër në vend dhe kemi investuar qendrueshëm gjatë viteve për tu siguruar se i dërgojmë shpejt kreditimet e pagave në llogaritë e klientëve.
2. Ne ofrojmë shërbimin unik të SMS ndaj klientëve, duke i dërguar kështu klientit mesazh njoftues pas çdo kreditimi të pagës, dietës apo shpërblimit.
3. Ne i ofrojmë klientëve lehtësira të mëdha për të aksesuar pagën e tyre. Raiffeisen Bank ka mbi 180 ATM në të gjithë Shqipërinë, më shumë se dyfishin e rrejtës të çdo banke tjetër. Klientët pagamarrës mund të kryejnë terheqje cash në ATM, pa komision.
4. Ne ofrojmë paketat më tërheqëse dhe me avantazh për klientët të cilët marrin pagën nëpërmjet bankës sonë, duke përfituar shumë shërbime falas, norma interesi preferenciale për kredinë, limit overdrafti në llogaritë e tyre, një shërbim të dedikuar ndaj klientit në mbi 100 degë dhe një shërbim Call Centre 24 orë në 7 ditë të javës.

Si rrjedhojë e nxjerrjes së VKM-së të muajit Prill 2010, punonjësve të Administratës Qendrore ju la zgjedhja e lirë e bankës ku do të kreditojnë pagën e tyre. Ky përbën një zhvillim të rëndësishëm në treg të cilin Raiffeisen Bank e mirëpret.

Si pasojë e rritjes së konkurrencës për këtë grup klientësh, Raiffeisen vazhdon të përmisojë shërbimet dhe produktet e saj për të qëndruar lider i fuqishëm në treg.

Depozitat

2010-ta shënoi një vit të rëndësishëm për sistemin bankar, i cili u shoqërua me një rritje në depozita, dhe u arrit stabilitet pas krizës ekonomike botërore. Depozitat për segmentin e klientëve individ u rritën ndjeshëm në 2010, pasi ne u fokusuam në transparencën, në çmime më konkurruese dhe më të leverdisshme, për të arritur në një rritje prej 105 milionë Euro gjatë vitit 2010.

Në fund të 2010-ës u lançua një platformë e re dhe bashkëkohore e sistemit të depozitave e cila na lejoi prezantimin te klientët tanë depozitues të mundësive të shumëllojshme dhe fleksibël të tregut. Kjo përfshinte zgjedhjen e kapitalizimit të interesit në bazë mujore, tre mujore, gjashtë mujore dhe vjetore, rinovimin automatik, mundësi për të riinvestuar interesin e fituar apo pagesa të interesit te palët e treta. Nëpërmjet kësaj platforme klientët mund të zgjedhin një datë maturimi specifike për depozitat e tyre, dhe të thyejnë depozitën në çdo moment pa asnjë komision. Ne jemi banka e vetme që ofrojmë kushte kaq fleksibël në tregun shqiptar.

Me një bazë të fuqishme depozitash, qëllimi i mëtejshëm është për të balancuar pjesën e tregut me nevojat optimale për likuiditet për Bankën si edhe për të mbajtur marzhe të pranueshme e për të përballur shpeshherë nga taktika çmimesh agresive nga shumë konkurrentë.

Transferrat e parave

Të ardhurat nga komisionet e transfertave/pagesave u rritën me rreth 10 përqind krahasuar me vitin 2009. 75 përqind e komisioneve të pagesave vijnë nga klientët individë dhe 25 përqind nga klientet e segmentit mikro. Rreth 41 përqind e transaksioneve nga transfertat e parave për këtë vit ishin nga pagesat në mbërritje, bazuar kjo në faktin që tregu Shqiptar vazhdon të jetë një vend pritës për paratë e dërguara nga emigrantët për familjet e tyre.

Kreditë

Edhe pse tregu i kredive për individë ka qenë më i ulët se në vitet përpara krizës, Raiffeisen ka vazhduar të jetë aktive në dhënie të kredive të reja me një cilësi të mirë ripagimi.

Proceset e brendshme, të tilla si aprovimi dhe mbledhja e kredive, janë forcuar për të siguruar cilësinë e portofolit ekzistues dhe portofolit të ri. Sistemi i procesimit të aplikimeve për kredi është përmirësuar për të siguruar një shërbim dhe vendim-marrje të shpejtë – si avantazh konkurrues kjo do të shërbejë për të tërhequr klientët e mirë pranë bankës tonë. Në segmentin Mikro, linja e produktit është përmirësuar duke qenë më pranë nevojave të këtyre klientëve mjaft të rëndësishëm, duke rezultuar me një rritje prej 60 përqind të portofolit të kredive.

Viti 2010 ka treguar një trend pozitiv në rritje të portofolit të kredive për individë. Kjo rritje është realizuar pavarësisht nga ndikimi i rënies ekonomike. Përmirësimi i proceseve dhe rishikimi i kriterëve të produktit, ka qenë një orientim thelbësor i vitit 2010 dhe do të vazhdojë të jetë në fokus të veçantë gjatë vitit 2011. Kjo do të na lejojë të jemi më efikas, më të shpejtë duke i shërbyer më mirë klientëve tanë dhe duke shfrytëzuar maksimalisht kapacitetet dhe përpeqjet tona.

Për të mbështetur kërkesën e tregut për kreditë hipotekare, Raiffeisen Bank ri-filloi kreditimin në monedhën Euro. Kjo u pasua nga një fushatë marketingu shumë e suksesshme gjatë tre muajve të fundit të vitit 2010, duke rritur portofolin e Kredisë Hipotekare me 12 përqind. Volumet e reja të kredive hipotekare dhe kredive personale të disbursuara gjatë kësaj fushate në fund të vitit kanë arritur nivelin më të lartë të kreditimit në vitet e fundit.

Procesi i shpejtë, afati më i gjatë i maturimit, shumat e kredisë më të larta dhe normat konkurruese të interesit, janë kriteret që e bëjnë bankën tonë më të fortën në tregun e kredive personale të pasiguruara. Ky produkt ka një grup mjaft të gjerë të synuar klientësh, pasi përfshin të gjithë klientët me të ardhura të verifikueshme. Ne kemi vazhduar të ofrojmë kredi personale dhe asnjëherë nuk ndaluan në ndryshim nga konkurrentët tanë të mëdhenj të cilët ndaluan ose kufizuan ofrimin e këtij produkti për disa grupe të veçanta klientësh.

Rrjeti i gjerë i bankomateve dhe i kartave të debitit Visa Electron janë avantazhet më të rëndësishme të cilat i lejojnë klientëve tanë përdorimin e limitit të Overdraftit në çdo kohë dhe çdo moment që ata kanë nevojë. Në vitin 2011 do të implementohet një sistem i ri aplikimi për Overdraft-in i cili do të sjellë disa ndryshime në përmirësimin e procesit dhe do të jetë në përputhje me kërkesat e klientëve tanë veçanërisht referuar ndryshimit të limitit të Overdraft-it.

Në produktin e financimit të menjëhershëm, Raiffeisen vazhdon të dominojë tregun. Rritja e mirë, marzhi fitimprurës dhe nivele të pranueshme të kredive të këqija e bëjnë këtë biznes të vogël por tërheqës, një produkt lider për bankën tonë. Në vitin 2011, ne do të përmirësojmë procesin e aprovimit dhe procesimit të kredive për të siguruar që t'i paraprijmë prishmërive dhe nevojave të klientëve.

Divizioni i Zhvillimit të Rrjetit

Gjatë vitit 2010 Divizioni i Zhvillimit të Rrjetit vazhdoi aktivitetin e tij fokusuar në zhvillimin dhe përmirësimin e kanaleve ekzistues të shpërndarjes bankare si dhe në ndërtimin e kanaleve të rinj elektronikë duke bërë të mundur ofrimin e shërbimeve më eficiente dhe në përputhje me kërkesat dhe profilet e klientëve. Shërbimet e Internet dhe SMS Banking u lançuan gjatë vitit 2010 për klientët individë dhe biznese të vogla, më i fundit ky në listën e shërbimeve dhe zgjidhjeve elektronike të ofruara nga Banka. Edhe për këtë vit, qëllimi kryesor ishte zhvillimi dhe shtrirja e mëtejshme e rrjetit të shpërndarjes për t'i dhënë klientëve tanë një akses më të shpejtë dhe të lehtë ndaj produkteve dhe shërbimeve të Bankës. Rrjeti bankar përfshin rrjetin e degëve, Shërbimin ndaj Klientit me Call Centre 24/7, rrjetit tonë të ATM, rrjetit të terminaleve POS, dhe shërbimi e Internet dhe SMS Banking. Në vitin 2010 Raiffeisen Bank vazhdon të zotërojë shpërndarjen më të gjerë në të gjithë indikatorët kryesor. Rrjeti ynë përbëhet prej 103 degësh në mbarë vendin, 185 ATM, 1,169 terminale POS dhe një ekip i dedikuar Call Centre të cilat i japin Bankës një zhvillim të larmishëm dhe bashkëkohor të rrjetit të saj në treg.

Rrjeti i Degëve

Gjatë vitit 2010 Raiffeisen Bank ruajti pozitat e saj si banka më e madhe në Shqipëri përsa i përket mbulimit gjeografik, përkatësisht me një rrjet prej 103 degësh. Qëllimi kryesor gjatë këtij viti ishte përmirësimi i rrjetit aktual duke rialokuar apo rritur në sipërfaqe degët aktuale me qëllim ofrimin e një rrjeti degësh modern dhe shumë funksional ku produktet dhe shërbimet tona t'u përcillen klientëve në mënyrë eficiente dhe në të njëjtën kohë të konkurojnë me bankat e tjera në treg. Gjatë vitit 2010 një koncept i ri i modelit të degës u aplikua në disa degë. Një ambient dege i mirëdizenjuar ofron një mundësi më të mirë për të përfutur nga gama e gjerë e produkteve dhe shërbimeve të ofruara nga banka jonë. Gjatë vitit 2010 u hap 1 degë e re dhe 4 të tjera u rialokuan ose u zgjeruan në vendndodhjet e tyre aktuale. Gjithashtu përmirësimi i fasadave të jashtme është implementuar në qytetet kryesore, një proces ky që do të vazhdojë gjatë vitit 2011 e cila do të përmirësoj imazhin e bankës.

Rrjeti i terminaleve POS

Në vitin 2010 Raiffeisen Bank zhvilloi më tej rrjetin e saj të gjerë të terminaleve POS në mbarë vendin. Ky shërbim u ofron klienteve tanë mundësinë e përdorimit të kartave të debitit dhe kreditit të markave VISA dhe MasterCard për blerje në pikat e shitjeve si edhe tërheqje cash pranë degëve të bankës. Deri në fund të vitit 2010 rrjeti POS numëroi 1,169 terminale, 24 prej të cilëve në degë të bankës (shërbimi Cash Advance). Rrjeti i terminaleve POS u shtri në 30 qytete të vendit duke ua ofruar këtë shërbim mbi 65 kategorive të ndryshme tregtarësh duke përfshirë hotele, agjenci udhëtimi, dyqane, restorante, pika karburanti, markete dhe qendra tregtare. Gjatë vitit të kaluar Banka rriti performancën këtij rrjeti duke u fokusuar në nevojat e qëndrimit e tregtarëve si edhe duke ndjekur hap pas hapi zhvillimet dhe kërkesat teknologjike të këtij tregu.

Rrjeti ATM

Gjatë vitit 2010 Raiffeisen Bank ruajti pozicionin lider në tregun bankar shqiptar me një total prej 185 ATM, dy herë më shumë se konkurrenti më i afërt. Llojet e kartave të pranuar janë VISA, VISA Electron, PLUS, MasterCard, Maestro dhe Cirrus, pa kufizime për ndonjë vend apo bankë lëshuese. Në 2010 tërheqjet në monedhën EURO u ofruan në 26 ATM në mbarë vendin. Rrjeti ATM i Raiffeisen Bank vazhdon të mbetet rrjeti i vetëm në treg i certifikuar plotësisht për teknologjinë e leximit të kartave me Chip për markat Visa dhe MasterCard duke i dhënë Bankës një avantazh të konsiderueshëm në aktivitetin e saj, por mbi të gjitha duke i ofruar kartëmbajtësve nivelet më të larta të sigurisë së transaksioneve.

Call Centre

Aktiviteti i Call Centre është prirja e telefonatave hyrëse dhe të ofrojë shërbime Telemarketing për të mbështetur oferta speciale për klientët (CRM). Ekipi i pritjeve të thirrjeve hyrëse i jep klientëve informacion për produktet si dhe asistencë lidhur me shërbimet bankare. Përveç kësaj, Call Centre mbështet tregtarët që përdorin POS-et e bankës. Që në janar

të vitit 2010 Call Centre ofron shërbim 24/7. Ekipi i telefonatave dalëse kontakton klientët e zgjedhur nëpërmjet telefonit dhe SMS-ve për oferta të dedikuara që janë pjesë e programit të manaxhimit të marrëdhënieve me klientët të bankës (CRM). Gjatë vitit 2010 u realizuan 86 fushata CRM. Call Centre manaxhon gjithashtu ankesat e klientëve. Përveç zgjidhjes së shpejtë dhe të kënaqshme të problemeve që mund të kenë klientët Call Centre mbledh dhe vlerëson informacionin e ankesave për të ndihmuar në përmirësimin e proceseve të brendshme të lidhura me cilësinë e produkteve dhe shërbimeve.

E-Banking

Duke filluar nga Gusht 2010, Raiffeisen Bank lançon bankingun nëpërmjet Internetit dhe SMS-së si shërbime të reja elektronike për individë dhe biznese. Ky është shërbimi që i siguron klientëve akses 24/7 në llogaritë e tyre dhe mundësinë për të kryer veprime me to në çdo kohë duke përdorur kanalet e reja elektronike, Internet dhe SMS Banking. Bankingu nëpërmjet internetit ofron informacion 24/7 për balancat dhe transaksionet e llogaritë e transferimin e fondeve drejt bankave kombëtare dhe ndërkombetare, pagesën e kartës së kreditit, pagesën e faturave të kompanive utilitare. Duke përdorur thjesht një pajisje telefonike celulare, klientët marrin informacion automatik si edhe me kërkesë mbi gjendjen e llogarisë dhe transaksioneve të fundit duke marrë dhe dërguar mesazhe SMS. Në vitin 2010, Raiffeisen Bank filloi dizajnimin dhe zhvillimin e një koncepti të shërbimit Mobile Banking në këtë mënyrë duke shtuar një kanal alternativ të sigurtë shërbimeve elektronike bankare. Shtimi i platformës së Internet Banking me një modul të ri të pagesës së taksës filloi në fund të vitit 2010, duke plotësuar dhe përbushur nevojat bankare të klientëve dhe duke përmirësuar bankën elektronike me shërbime të reja.

Rrjeti i Shitjes dhe Shpërndarjes

Viti 2010 ka dëshmuar përpjektet tona të vazhdueshme për të përmirësuar efikasitetin e rrjetit tonë të degëve, nga pikëpamja e performancës si dhe nga ana strukturore. Riorganizimi i rajoneve ka ulur nivelet si dhe ka rritur shkallën e manaxhimit duke bërë që drejtuesit e shitjeve dhe shpërndarjes të jenë më afër stafit të shitjeve dhe shërbimit si dhe ekperiencës me klientët. Rrjeti jonë i shpërndarjes së degëve tashmë përbëhet nga tetë distrikte, të cilat drejtohen nga një Drejtor Distrikti i cili raporton direkt në Drejtorinë e Përgjithshme në mënyrë që të sigurohet një qëndrueshmëri më e mirë në ekzekutimin e strategjisë tonë të biznesit. Shitjet dhe shërbimi janë më shumë se kurrë të ndërlidhura dhe pjesë e përgjegjësisë të përditshme të stafit tonë të degës. Shitjet në mënyrë cilësore në shërbim të klientëve mbetet fokusi jonë kryesor dhe programi i shpërblimit është ndryshuar për efekt të përsosmërisë së këtyre dy elementeve. Ne kemi futur indeksin e cilësisë së shërbimit të degës për të bërë matjen e performancës së degëve kundrejt objektivave të shitjeve dhe shërbimit në nivel individual sipas distrikteve dhe për të gjithë rrjetin. Në pjesën e shitjeve, ne kemi krijuar një praktike të re manaxhimi shitjesh për të bërë të mundur që i gjithë stafi jonë të ketë mbështetjen e nevojshme për të plotësuar sa më mirë nevojat e klientëve dhe për të arritur objektivat. Trajnimi, udhëzimi dhe mbështetja e stafit në degë do të jetë tashmë pjesë e punës së përditshme të manaxherëve tonë të shitjeve. Këto praktika janë testuar në mënyrë të suksesshme gjatë fushatës tonë të fundit të kredive të cilat dhanë rezultate të shkëlqyera dhe një numër rekord shitjesh të kredisë hipotekare.

Një fushë tjetër kryesore në vëmendjen tonë gjatë vitit 2010 ka qenë edhe segmenti i biznesit Mikro. Pas përmirësimeve të ndjeshme në pjesën e produkteve, çmimeve apo procesimeve, forca jonë shitëse iu përgjigj me një rritje të madhe të shitjeve në kredi mikro, duke rritur në këtë mënyrë portofolit me rreth 36 përqind në gjysmën e dytë të vitit. Në vitin 2011, forca jonë shitëse e Mikros do të vazhdojë të zhvillohet me trajnime më të avancuara shitjesh dhe manaxhimi.

Së fundi, ne mbetemi të angazhuar për të zhvilluar më tej financimin e menjëhershëm në qendrat tregtare (retail sales finance) me anë të marrëdhënieve tona të bashkëpunimit me partnerët tanë të jashtëm. Objektivi jonë i 2010 për shitjet direkte ishte ridizenjimi, për të siguruar rritje të qëndrueshme dhe fitimprurëse në këtë fushë. Një forcë e re e shitjeve direkte do të implementohet gjatë vitit 2011, e cila do të shërbejë si plotësuese e kanaleve të tjera të shitjeve duke identifikuar, kualifikuar pjesën e para-shitjeve në fushën e produkteve dhe shërbimeve kryesore për individët. Ndërkohë që në vitin e ardhshëm na presin shumë sfida, ne kemi besim që jemi në pozitën e duhur për tu përballur me to dhe për të fuqizuar pozicionin drejtues të Raiffeisen Bank në treg.



Tirana: Tirana është kryeqyteti i Shqipërisë si dhe qyteti më i madh i saj. Tirana moderne u themelua në 1614 nga Sulejman Bargjini, duke u populluar vazhdimisht dhe duke u bërë kryeqytet i Shqipërisë në 1920. Qyteti është qendër e universiteteve, si dhe e jetës politike, ekonomike dhe kulturore të vendit. Arkitektura ka influencë të konsiderueshme italiane dhe turke.

Kulla e Sahatit e Tiranës është ndërtuar në vitin 1822 nga Haxhi Ef'hem Bey. Ka 90 shkallë në formë spiraleje. Është 35 metra e lartë dhe deri në vitin 1970 ka qenë ndërtesa më e lartë e kryeqytetit. Kulla e Sahatit është e hapur për turistët që prej vitit 1996. Ajo është gjithashtu simbol i emblems së Bashkisë së Tiranës.





Llaman Plazhet perfekte dhe dielli që rrezaton nga lindja deri në muzg, janë vetëm pak nga tiparet ndjellëse të plazhit të Llamanit. Ky gji ka shumë për të ofruar, aty ku jeshilja e druve të ullinje ndërthuret bukur me blunë e thellë të detit Jon, me një harmoni perfekte.

Thesari dhe Bankingu i Investimeve

Të Ardhurat Fikse

Edhe gjatë vitit 2010 vijuan të ishim investuesit kryesor në tregun e letrave me vlerë të emetuara nga qeveria e Shqipërisë. Pavarësisht se kemi ulur pjesëmarrjen në tregun primar të bonove të thesarit në rreth 15 përqind të tij, ne kemi qenë të fokusuar në investime afatgjata veçanërisht në obligacione thesari ku aktiviteti ynë është rritur ndjeshëm dhe në fund të vitit zotëronim rreth 60 përqind të këtij tregu.

Gjatë viteve të fundit kemi vazhduar të ristrukturojmë portofolin tonë, i cili është i përbërë nga portofoli i tregtueshëm dhe portofoli i investimeve me letra me vlerë të mbajtura deri në maturim. Portofoli i tregtueshëm është rritur gjatë këtij viti duke arritur në 277 milionë Euro në fund të muajit Dhjetor. Duke qenë se obligacionet e thesarit afatgjata zënë rreth 76.8 përqind të portofolit tonë edhe transaksionet me to janë rritur ndjeshëm gjatë vitit të fundit.

Në tregun sekondar me bankat, njësia e të ardhurave fikse ka qenë shumë aktive, duke manaxhuar më së miri portofolin e letrave me vlerë dhe në të njëjtën mënyrë edhe investimet e reja.

Kemi ofruar mundësi dhe alternativa të ndryshme investimi për klientët tanë si individë ashtu edhe ata korporatë. Mund të themi që jemi krenarë sepse vazhdojmë të jemi kontribuesit kryesorë në tregun me pakicë të bonove si dhe obligacioneve të thesarit duke tregtuar (shitje dhe blerje) me klientë të ndryshëm në të gjithë vendin. Për të nxitur dhe shtuar më tej pjesëmarrjen e individëve në tregun primar dhe sekondar të letrave me vlerë kemi publikuar broshura informuese për publikun në të gjitha degët e Raiffeisen Bank.

Implementimi i sistemit Bloomberg si Front Office gjatë vitit 2010 bëri të mundur automatizimin e proceseve në lidhje me letrat me vlerë duke përmirësuar dhe rritur eficiencën në manaxhimin e portofolit të investimeve.

Raiffeisen Bank gjithashtu vazhdon të kryejë edhe aktivitetin e mbajtjes së regjistrit të letrave me vlerë të emetuara nga qeveria e Shqipërisë duke lejuar edhe investitorët e huaj të marrin pjesë në tregun tonë të letrave me vlerë. Jemi munduar të jemi pjesë e rëndësishme e një tregu në zhvillim duke qenë nismëtarë në transaksione të ndryshme dhe duke përdorur instrumenta financiare për të manaxhuar dhe zhvilluar më tej tregun vendas dhe portofolin tonë të investimeve. Kështu gjatë 2010 kemi shfrytëzuar mundësi të reja financimi duke realizuar për herë të parë transaksione REPO me bankat lokale të nivelit të dytë.

Tregu i Parasë

Viti 2010 ka qenë një vit i sukseshëm për njësinë e tregut të parasë veçanërisht nëse do ta krahasonim me vitin që e parapriu i cili u theksua nga kriza mbarëbotërore. Kjo njësi është karakterizuar nga një rritje e investimeve ndërbankare si në tregun lokal ashtu edhe atë ndërkombëtar, duke zhvilluar më tej aktivitetin e saj. Si volumi ashtu edhe numri i transaksioneve është rritur gjatë vitit 2010 dhe njësia e tregut të parasë së bashku me njësinë e shitjeve kanë kontribuar në likuiditetin afatshkurtër duke përmbyshur nevojat e bankës për të dhe duke qenë sa më atraktivë për klientët për të ofruar mundësi investimi në shuma dhe në periudha të ndryshme.

Njësia e tregut të parasë është bërë pjesë aktive e një tregu lokal në zhvillim duke kontribuar edhe në kuotimet ditore për publikimin e TRIBID/TRIBOR. Këto kuotime janë një aspekt i rëndësishëm i zhvillimit të tregut duke pasqyruar aktivitetin e tij, dhe njësia e tregut të parasë ka përditësuar vazhdimisht këto kuotime sepse interesat e tregut të parasë janë një indikator i rëndësishëm për të parashikuar dhe ndërmarrë veprime në një të ardhme të afërt. Gjithashtu Raiffeisen Bank është një prej kontribuesve kryesorë të zgjedhur nga Banka e Shqipërisë në panelin e bankave të TRIBID/TRIBOR. Njësia e tregut të parasë luan një rol kyç në manaxhimin e likuiditetit afatshkurtër duke bashkëpunuar ngushtë me departamentet e tjera dhe është gjithmonë në parim me rregullat dhe standartet e përcaktuara nga Banka Qendrore. Nga ana tjetër kjo njësi duhet motivuar për t'ju përgjigjur në kohë ndryshimeve dhe nismave, duke manaxhuar më së miri riskun dhe maksimizuar fitimin.

Këmbimi Valutor

Viti 2010 u karakterizua nga një luhatshmëri e lartë e kurseve të këmbimit. Euro u kuotua në nivele të larta kundrejt monedhës vendase afër nivelit psikologjik 140, kurse dollari amerikan arriti nivelin më të lartë në 2 vitet e fundit duke fituar më shumë se 19 pikë. Kjo luhatshmëri në kurset e këmbimit ndikoi shumë në tregun shqiptar ku pasojat e krizës financiare ndihën akoma në këtë treg. Këto zhvillime u reflektuan sidomos në kuotimet me spread të lartë, blerje/shitje, të bankave të nivelit të dytë.


Njësia e Këmbimeve Valutore u përpoq të jap mbështetjen maksimale në këtë treg të trazuar duke mbajtur një spread të vogël në blerje/ shitje si dhe duke kuotuar me çmime shumë konkurruese në tregun ndërbankar dhe me klientet. Volumet e transaksioneve të këmbimeve valutore janë rritur në krahasim me vitin 2009 duke arritur shumën 220 milionë Euro për muaj ku pjesën më të madhe e zënë veprimet EUR/USD, ndërkohë veprimet në tregun ndërbankar lokal dhe atë të huaj ishin më tepër se 180 transaksione në muaj.

Shitjet e Thesarit

Njësia e shitjeve të Thesarit u përpoq që të ruante pozicionin e saj në treg dhe fokusin te nevojat e klientit, duke bashkëpunuar plotësisht me njësinë e këmbimeve valutore, tregut të parasë dhe të ardhurave fikse. Edhe gjatë vitit 2010, sektori i shitjeve arriti që të ndihmonte klientët duke i konsultuar ata dhe duke ndërtuar një marrëdhënie edhe më të fortë, marrëdhënie e cila është një faktor shumë i rëndësishëm gjatë krizave financiare.

Viti 2010 ishte shumë më mirë në termat e xhiros me klientët korporatë krahasuar me vitin 2009. Gjithashtu, përmirësimi i kushteve makroekonomike në Shqipëri ndihmoi shumë në këtë drejtim. Norma shumë konkurruese, qofshin kurse këmbimi apo norma interesi, patën një impakt shumë të madh në rritjen e xhiros vjetore dhe ndihmuan në zgjerimin e pjesës së tregut.

Rritja e përfitueshmërisë dhe qëndrimi pranë nevojave të klientit ishin qëllimet kryesore të njësisës së shitjeve të thesarit.





Driloni është 4 km në lindje të Pogradecit, buzë liqenit të Ohrit. Rrugicat e ngushta, urat, mjellmat dhe pëllumbat i shtojnë veçantinë këtij vendi magjik, me burime me ujë të kristaltë të rrethuara me pemë dhe bimë dekorative. Liqeni i Ohrit dhe zona përreth tij janë një ekosistem unik dhe harmonik.

Përgjegjësi Sociale

Raiffeisen Bank në Shqipëri është e angazhuar për të sjellë produkte moderne dhe të shkëlqyera dhe shërbimet për klientët e saj. Në të njëjtën kohë ne i këshillojmë ata që të marrin vendimin më të mirë por jo vetëm për bizneset, por gjithashtu edhe për individët. Raiffeisen Bank në Shqipëri është në përputhje të plotë me rregulloret për transparencë të zbatuara nga ana e Bankës së Shqipërisë dhe autoriteteve të tjera mbikëqyrëse.

Raiffeisen Bank njih dhe merr shumë seriozisht përgjegjësitë sociale ndaj klientëve, të punësuarve, komunitetit dhe mjedisit. Raiffeisen Bank ka zhvilluar një plan të tërë për të ecur së bashku me përgjegjësit, sepse është zgjedhja numër një për më shumë se 600.000 klientë në të gjithë vendin. Raiffeisen Bank ka shpenzuar më shumë se gjysmë milionë euro në projekte sociale dhe ofron trajnime dhe përfitime të tjera për personelin. Raiffeisen Bank ka treguar angazhimin e saj në projektet që kanë ndihmuar shumë në përmirësimin e jetës së komunitetit. Politika e sponsorizimeve u përqëndrua gjithashtu edhe në arsim nën moton "Ne i ndihmojmë ata që ndihmojnë veten", Raiffeisen Bank ka sponsorizuar shumë aktivitete shoqërore, organizuar për argëtimin e fëmijëve. Mijëra fëmijë kanë përfituar nga këto aktivitete dhe fryma shoqërore ishte shumë e fortë.

Raiffeisen Bank me bashkëpunimin dhe bashkëpunimin e Bashkive të ndryshme kanë prerë shumë shirita në projekte të ndryshme sidomos për rindërtimin dhe pajisjen me libra të bibliotekave të shkollave dhe rikonstruksionin e oborreve të shkollave në Tiranë, Elbasan, Berat, Shkodër, Korçë, Durrës, etj. Përveç kësaj, Raiffeisen Bank është partner i Fakultetit të Ekonomisë prej 5 vitesh me sponsorizimin e Konferencës së Studentëve dhe Loja në Bursë e organizuar nga studentët e këtij fakulteti. Një tjetër projekt social gjithëpërfshirës i sponsorizuar nga Raiffeisen Bank ishte dhe Kampionati Kombëtar i Basketbollit për fëmijët në të gjithë Shqipërinë, ku morën pjesë 1.500 fëmijë.

Raiffeisen Bank i është bashkuar nismës së Bashkisë së Tiranës "Një-Qytetar-Një Pemë" për dy vjet me radhë, duke dhënë kontributin e tij në mbjelljen e pemëve në dy rruge kryesore të Tiranës, duke ndihmuar në këtë mënyrë në rritjen e vlerave të komuniteteve dhe ri-gjallërimin e tyre. Projekte të tjera të mbjelljes së pemëve janë sponsorizuar edhe në qytetet e Beratit, Krujës, Lushnjës, etj.

Raiffeisen Bank ka qenë prezent edhe në projektet mjedisore, ku ka financuar projektin për pastrimin e zonave bregdetare të vendit. Ishte gjithashtu i përfshirë edhe stafi i Bankës në pastrimin e bregdetit të Vlorës, Durrësit, Divjakës dhe Shëngjinit.

Raiffeisen Bank në Shqipëri është gjithmonë i pari që reagon kur ndodhin katastrofa. Raiffeisen Bank në Shqipëri ka dhuruar menjëherë 100 mijë euro për zonat e veriut të prekura dhe që vuanin nga përmbajtjet, ndërsa stafi ka dhënë dhurime vullnetare personale.

Raiffeisen Bank në Shqipëri, trajton ndryshe në drejtim të produkteve dhe shërbimeve disa segmente të caktuara si arsimit, pasi ata janë të klasifikuara me të ardhura nën të ulëta dhe beson se ata janë shumë të rëndësishme për shoqërinë. Prandaj, Raiffeisen Bank në Shqipëri ka synuar edukimin si një nga sektorët që ka nevojë të menjëhershme për mbështetje dhe ndikon drejtpërdrejt në të ardhmen e vendit. Raiffeisen ofron interesa të ulta të krijuara për produktet e kredisë për mësuesit, të cilët përndryshe do të përjashtoheshin nga ky lloj shërbimi financiar, sepse rrogat e tyre janë shumë të ulëta për t'u kualifikuar për kredi normale. Programi i kredisë është projektuar për t'u dhënë mësuesve akses në kapital dhe për të ndihmuar në përmirësimin e standardeve të tyre të jetesës. Programi përfaqëson një afrim të ri të biznesit, duke ofruar përfshirje financiare në komunitet për mësuesit në të gjithë vendin.

Si një iniciativë transformuese ai shoqëron reforma të reja qeveritare për sistemin arsimor. Sipas marrëveshjes së bankës me Ministrinë e Arsimit të Shqipërisë, mësuesit, profesorët dhe punëtorët e tjerë në sektorin e arsimit pagat e të cilëve kalojnë përmes Raiffeisen Bank përfitojnë nga ky produkt. Mësuesit me potencialin e tyre të lartë për përmirësimin e shoqërisë nëpërmjet arsimit janë një komunitet në nevojë në Shqipëri. Me pagat e mësuesve tashmë poshtë pagës mesatare të ulët të sektorit publik, mësimdhënia është ende një profesion me status të ulët në Shqipëri, pavarësisht vlerës së tij të lartë për shoqërinë. Shtrirja e nënpagesës ka një efekt negativ në motivimin, mësimin dhe të mësuarit me cilësi.

Vazhdimisht duke u përqëndruar dhe prioritetizuar përgjegjësitë dhe angazhimin ndaj komunitetit, një nga tregjet kryesore në fokus të Raiffeisen Bank është të mbështet investimet në sektorin e energjisë së rinovueshme. Shqipëria, në bazë të pozitës gjeografike, në morfologjinë territoriale dhe mbi burimet e veta natyrore, ofron kushte të favorshme për prodhimin e energjisë, të bazuar në mundësi të mëdha për burimet e ripërtëritshme të tilla si: era, dielli, gjeotermale, biomasa dhe ujë. Ndër burimet e tjera, gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka vendosur një përqëndrim të konsiderueshme në shfrytëzimin e energjisë nga burimet ujore dhe qeveria i ka dhënë më shumë se 90 Hidrocentraleve (HEC) marrëveshje të koncesionit për sipërmarrësit privatë në lidhje me ndërtimin e 263 HEC-eve të vogla. Politikat qeveritare dhe strategjitë janë duke mbështetur investimet në këtë segment dhe duke siguruar kushte të qëndrueshme tregut.

Raiffeisen Bank në Shqipëri është duke luajtur një rol aktiv në inkurajimin e investimeve në këtë fushë dhe bashkëpunimin me institucionet qeveritare si dhe Bankat ndërkombëtare (p.sh. KfW Bankengruppe) për përmirësimin e kuadrit rregullator. Deri tani Raiffeisen Bank ka përfunduar me sukses investimin e 3 hidrocentraleve të vogla bimore me kapacitet prodhimi prej më pak se 15 MW secila, ndërsa projektet e tjera janë në proces vlersimi.

Veç kësaj, me përmirësimin e kuadrit rregullator, fokusi i bankës do të shtrihet edhe në burime të tjera të rinovueshme si era, energjia diellore, termike etj gjithmonë duke kërkuar vendosjen e bashkëpunimeve të gjatë të qëndrueshme të biznesit me një fokus të madh mbi komunitetin.

Raiffeisen Bank në Shqipëri, përveç pagave konkurruese dhe të kënaqshme, ka për qëllim ofrimin e përfitimeve suplementare për punonjësit për të rritur motivimin e tyre për të punuar në bankë dhe angazhimin e tyre në përmbushjen e detyrave të tyre, duke ndihmuar në të njëjtën kohë për të kapërcyer dhe për të lehtësuar situata të ndryshme ekonomike dhe financiare që ata mund të kenë. Raiffeisen Bank aplikon termat dhe kushtet preferenciale për disa produktet dhe shërbime bankare për punonjësit e saj (kreditë, kartat e kreditit, depozita, etj). Të gjitha këto përfitime kontribuojnë në motivimin e stafit si dhe në përmirësimin e standardeve të tyre të jetës.





Puka është një qytet në veri të Shqipërisë. Qyteti është 838 m mbi nivelin e detit, duke e bërë një një nga qytetet më të larta në Shqipëri. Rrethohet nga 400 hektarë zonë jeshile me pisha. Ka një pamje mjaft piktoreske, veçanërisht në dimër, në mes të borës dhe ajrit të pastër. Është një vend tërheqës edhe gjatë verës për shkak të freskisë së tij, një arratisje nga nxehtësia e qytetit.

Burimet Njerëzore dhe Trajnimet

Ne e shohim stafin tonë si një lojtar kyç në arritjen e objektivave dhe suksesit të Bankës; për rrjedhojë, përmes programeve të burimeve njerëzore, ne fokusohemi në motivimin dhe kënaqësinë e tyre, duke ofruar një mjedis pune premtues dhe paketa financiare konkurruese.

Statistika

Në krahasim me vitin e kaluar, rritja e përqindjes së stafit është afërsisht 1 përqind në fund të vitit 2010, me një numër total prej 1,375 punonjësish.

Struktura e stafit mbetet e pandryshuar; 75 përqind e stafit të bankës janë femra dhe 25 përqind janë meshkuj. Mosha e organizatës është e re, me një moshë mesatare prej 35 vjetësh. Gjatë vitit 2010, numri total i ditëve të trajnimit arriti në 3,909 ditë. Mbi 950 punonjës kanë ndjekur të paktën një trajnim. Buxheti total i shpenzuar për aktivitete zhvillimi dhe trajnimi është 282,193 Euro.

Rekrutimi

Gjetja e kandidatëve më të mirë të mundshëm, të cilët mund të përshtaten me kulturën tonë dhe të japin kontributin e tyre brenda organizatës është një sfidë dhe një mundësi. Kjo sfidë arrihet duke investuar kohë në zhvillimin e marrëdhënieve me rekrutuesit, agjencitë ekzekutive të rekrutimit, universitetet dhe gazetatat.

Praktika

Banka jonë vazhdon të mbetet një nga kompanitë më atraktive për praktikantët, të cilët e kryejnë atë në përfundim të studimeve të tyre. Ky program është përdorur me sukses për të përzgjedhur dhe punësuar talentet e reja, më të mirë dhe më të motivuar nga universitete të ndryshme. Një iniciativë e re në këtë kuadër, e nisur në vitin 2010, është përfshirja e Raiffeisen Bank në programin FASTIP, duke mbështetur 4 studentë të cilët po vazhdojnë studimet e tyre në degën "Manaxhim Bankar" dhe të cilët do të punësohen pas diplomimit duke na përgatitur për konkurrencën në tregun e punës në të ardhmen.

Menaxhimi i Performancës

Politikat e Burimeve Njerëzore të Raiffeisen Bank synojnë të përforcojnë një kulturë e cila mbështet leadershipin dhe performancën e lartë. Synimi ynë është të nxisim dhe përforcojmë sjelljet/kompetencat e dëshiruara dhe të motivojmë njerëzit tanë përmes një sistemi të konsoliduar të menaxhimit të performancës.

Vlerësimi i Performancës

Kemi hartuar dhe vendosur një skemë incentive mujore për stafin e degëve dhe një skemë bonusi vjetore për stafin e Drejtorisë së Përgjithshme për të rritur motivimin dhe angazhimin e stafit, duke e integruar menaxhimin e performancës në kulturën e kompanisë. Për të motivuar punonjësit me performancë të lartë, të cilët duhet të jenë shembull për të tjerët, u prezantua iniciativa Mikro Mania, përmes programit të Shpërblimit dhe Vlerësimit, duke vlerësuar performuesit më të mirë dhe duke hapur rrugën kësaj iniciative për t'u përdorur edhe nga segmente të tjerë.

Trajnimi dhe zhvillimi

Trajnimi dhe zhvillimi i stafit është shumë i rëndësishëm për arritjen e objektivave të bankës dhe rritjen e produktivitetit të stafit. Divizioni i Burimeve Njerëzore dhe Trajnimit ka kontribuar si partner biznesi, duke ofruar mundësi zhvillimi dhe programe trajnimi që janë në përputhje me objektivat dhe strategjinë e Bankës. Aktivitetet kryesore të trajnimit dhe zhvillimit u fokusuan në:

Trajnimin orientues për punonjësit e rinj

Stafi i ri i bankës ka ndjekur Paketën Orientuese të Trajnimit, e cila është shumë e rëndësishme, sepse punonjësit njihen me misionin e bankës, vlerat, objektivat dhe politikat e korporatës. Stafit të segmenteve të ndryshme të biznesit u janë ofruar paketa të ndryshme trajnimi.

Trajnimet për stafin e degës

Shumë trajnime dhe seminare janë organizuar për të rifreskuar dhe rritur njohuritë mbi produktet dhe procedurat për stafin e degës. Në të njëjtën kohë, janë dhënë trajnime për aftësitë komunikuese, me synim rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj klientit dhe shitjes.

Trajnimet për manaxherët

Zhvillimi i pjesës manaxhuese është një fushë shumë e rëndësishme dhe në të investohet shumë, duke përzgjedhur dhe ofruar programe trajnimi dhe seminare që synojnë zhvillimin e kompetencave bazë që duhet të zotërojnë manaxherët dhe drejtuesit e organizatës.





Voskopoja është 21 km në perëndim të Korçës në një lartësi 1160 metra mbi nivelin e detit. Ka qënë një nga vëndet më të zhvilluara dhe të pasura gjatë shekullit 17-18 dhe sot e kësaj dite është një pasuri e artit, ku piktorët më të talentuar të Shqipërisë praktikojnë profesionin e tyre. Në një rajon të pasur me pyje të dendura dhe fshatra tipik, gjënden shtatë kisha me piktura afresko të mrekullushme.

RAIFFEISEN BANK SH.A.

Raporti i auditorit të pavarur
dhe Pasqyrat Financiare të Konsoliduara
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010

Pasqyra përmbledhëse

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Pasqyrat financiare të konsoliduara

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar	149
Pasqyra e konsoliduar përmbledhëse e të ardhurave	150
Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital	151
Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë	152
Shënime për pasqyrat financiare të konsoliduara	153 - 191

Raporti i Auditorit të Pavarur

Aksionarëve të Raiffeisen Bank sh.a.

Raporti mbi Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Raiffeisen Bank sh.a. ("Grupi") bashkëngjitur, të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më 31 dhjetor 2010 dhe pasqyrën e konsoliduar të të ardhurave përmbledhëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënime të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare të konsoliduara. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare të konsoliduara nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare të konsoliduara. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionimi mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare të konsoliduara.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare të konsoliduara paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Grupit më 31 dhjetor 2010 si dhe të performancës së tij financiare dhe rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

Deloitte.

Deloitte Albania shpk

18 prill 2011

Tiranë, Shqipëri

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar më 31 Dhjetor 2010

(të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

	Shënime	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Aktivët			
Paraja dhe ekuivalentët e saj	7	19,253,928	11,220,360
Shuma të kushtëzuara	8	23,297,417	20,345,307
Investime të mbajtura për tregtim	9.1	38,668,174	36,524,191
Investime të mbajtura deri në maturim	9.2	95,361,970	93,189,711
Hua dhe paradhënie për klientët	10	98,398,431	88,328,640
Aktive afatgjata materiale	11	1,565,787	1,647,341
Aktive afatgjata jomateriale	11	296,588	311,388
Investime në kapital	12	17,237	19,734
Emër i mirë	13	92,783	92,783
Tatim fitimi i parapaguar		-	163,374
Aktive të tjera	14	1,031,336	1,359,931
Totali i aktiveve		277,983,651	253,202,760
Detyrimet			
Detyrime ndaj institucioneve financiare	15	3,885,069	2,197,145
Marrëveshje të anasjallta të riblerjes	16	8,311,578	17,945,088
Detyrime ndaj klientëve	17	236,595,234	207,628,047
Tatimi për t'u paguar		81,296	-
Tatimi i shtyrë	18	134,597	202,464
Detyrime të tjera	19	1,322,235	728,593
Totali i detyrimeve		250,330,009	228,701,337
Kapitali			
Kapitali aksionar	20	9,926,093	4,348,233
Rezerva e përgjithshme	21	2,801,000	2,800,000
Rezerva e rivlerësimit		17,237	19,734
Fitimi i pashpërndarë		14,840,357	17,281,448
Totali i kapitalit që i përket aksionarëve të Bankës		27,584,687	24,449,415
Interesat jo kontrolluese	22	68,955	52,008
Totali i kapitalit aksionar		27,653,642	24,501,423
Totali i detyrimeve dhe kapitalit aksionar		277,983,651	253,202,760

Këto pasqyra financiare të konsoliduara u miratuan nga Këshilli Mbikqyrës më 8 mars 2011 dhe u nënshkruan në emër të tij nga:



Christian Canacaris
Drejtor i Përgjithshëm



Alexander Zsolnai
Zv. Drejtor i Bordit Drejtues

Pasqyra e konsoliduar e pozicionit financiar duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 52, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar përmbledhëse e të ardhurave për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Të ardhura nga interes	23	19,086,520	19,300,170
Shpenzime për interesa	24	(7,105,850)	(8,524,410)
Të ardhura neto nga interesat		11,980,670	10,775,760
Të ardhura nga komisionet	25	1,385,638	1,329,167
Shpenzime për komisionet	26	(277,499)	(215,182)
Të ardhura neto nga komisionet		1,108,139	1,113,985
Të ardhura neto nga tregtimi	27	2,092,358	1,226,968
Të ardhura të tjera operative, neto	28	4,012	173,621
		2,096,370	1,400,589
Primi i sigurimit të depozitave	29	(690,046)	(409,561)
Shpenzime për personelin	30	(2,040,820)	(1,726,537)
Zhvlerësimi dhe amortizimi	11	(538,024)	(621,712)
Shpenzime të përgjithshme administrative	31	(1,577,777)	(1,503,184)
Humbje neto nga zhvlerësimi i huave	10	(4,283,461)	(3,788,377)
		(9,130,128)	(8,049,371)
Fitimi para tatimit		6,055,051	5,240,963
Tatimi mbi fitimin	32	(694,072)	(547,056)
Fitimi neto për vitin		5,360,979	4,693,907
Të ardhura të tjera përmbledhëse			
Rezerva e vlerës së drejtë (aktive financiare të disponueshme për shitje)			
Ndryshimi neto në vlerën e drejtë	11	(2,497)	8,875
Total i të ardhurave përmbledhëse		5,358,482	4,702,782
I përket:			
Aksionarëve të Bankës		5,344,032	4,680,568
Interesave jo kontrolluese		16,947	13,339

Pasqyra e konsoliduar përmbledhëse e të ardhurave duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 52, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
(të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

	I përket aksionarëve të Bankës					
	Kapitali aksionar	Rezerva e përgjithshme	Rezerva e rivlerësimit	Fitimi i pashpërndarë	Totali kontrolluese	Totali i kapitalit
Gjendja më 31 Dhjetor 2008	4,348,233	850,000	10,859	14,550,880	19,759,972	38,669 19,798,641
Transferimi i fitimit të pashpërndarë në rezervën e përgjithshme	-	1,950,000	-	(1,950,000)	-	-
Të ardhura të tjera përmbledhëse (Shënimi 11)	-	-	8,875	-	8,875	- 8,875
Fitimi neto për vitin	-	-	-	4,680,568	4,680,568	13,339 4,693,907
Gjendja më 31 Dhjetor 2009	4,348,233	2,800,000	19,734	17,281,448	24,449,415	52,008 24,501,423
Rritje e kapitalit	5,577,860	-	-	(5,577,860)	-	-
Transferimi i fitimit të pashpërndarë në rezervën e përgjithshme	-	1,000	-	(1,000)	-	-
Dividend i paguar	-	-	-	(2,206,263)	(2,206,263)	- (2,206,263)
Të ardhura të tjera përmbledhëse (Shënimi 11)	-	-	(2,497)	-	(2,497)	- (2,497)
Fitimi neto për vitin	-	-	-	5,344,032	5,344,032	16,947 5,360,979
Gjendja më 31 Dhjetor 2010	9,926,093	2,801,000	17,237	14,840,357	27,584,687	68,955 27,653,642

Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve të kapitalit duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 52, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2010
 të gjitha balancat janë në mijë Lek, nëse nuk shprehet ndryshe)

	Viti i mbyllur më Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më Dhjetor 2009
Rrjedhja e parasë nga operacionet		
Fitimi para tatimit	6,055,051	5,240,963
Zëra jo-monetarë në pasqyrën e të ardhurave		
Zhvlërësimi dhe amortizimi	538,024	621,712
Aktivitet e qëndrueshme të nxjerra jashtë përdorimi	14,099	66,892
Humbje neto nga zhvlërësimi i aktiveve financiare	4,283,461	3,788,377
Të ardhurat neto nga interesi	(11,980,670)	(10,775,760)
Ndryshimi në provigjione për debitorë të tjerë	39,175	(190,562)
	(1,050,860)	(1,248,378)
(Rritje) / pakësim në hua dhe paradhënie për institucionet e kreditit	(2,951,639)	1,934,663
Rritje në hua dhe paradhënie për klientët	(14,343,226)	(8,401,766)
(Rritje) / pakësim në REPO të anasjelltë/REPO	(9,553,470)	6,497,528
Rritje në letra me vlerë të tregtueshme	(2,143,983)	(14,646,902)
Pakësim / (rritje) në aktive të tjera dhe emër të mirë	491,971	(470,580)
Rritje / (pakësim) në detyrimet ndaj institucioneve financiare	1,685,146	(978,839)
Rritje / (pakësim) në detyrimet ndaj klientëve	28,817,051	(7,322,434)
Rritje / (pakësim) në pasivet e tjera	401,080	(2,084,270)
	1,352,071	(26,720,978)
Interesi i arkëtuar	19,178,026	19,086,033
Interesi i paguar	(7,032,976)	(9,563,650)
Tatimi i paguar mbi fitimin	(527,256)	(461,846)
Paraja neto e gjeneruar / (përdorur) në aktivitetet operacionale	12,969,864	(17,660,441)
Rrjedhja e parasë nga investimet		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(544,820)	(224,258)
Arkëtime nga shitja / (blerje) e aktiveve afatgjata jomateriale	89,051	(135,263)
Maturimi i letrave me vlerë të mbajtura deri në maturim	(2,274,263)	22,676,634
Rrjedhja e parasë neto e (përdorur) / gjeneruar nga investimet	(2,730,033)	22,317,113
Rrjedhja e parasë nga financimet		
Dividend i paguar nga fitimi i pashpërndarë i vitit të kaluar	(2,206,263)	-
Rrjedhja e parasë neto e përdorur në financime	(2,206,263)	-
Rritje neto në para dhe ekuivalentët e saj	8,033,568	4,656,672
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fillim të vitit (shënimi 7)	11,220,360	6,563,688
Paraja dhe ekuivalentët e saj në fund të vitit (shënimi 7)	19,253,928	11,220,360

Pasqyra e konsoliduar e rrjedhjes së parasë duhet lexuar së bashku me shënimet nga faqja 5 deri në faqen 52, të cilat janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare të konsoliduara.

1. TË PËRGJITHSHME

Raiffeisen Bank sh.a ("Banka") është emri që Banka mori duke filluar nga data 1 tetor 2004 nga ish Banka e Kursimeve sh.a. Banka e Kursimeve u krijua në vitin 1991 nga ndarja e ish "Institutit të Sigurimeve dhe Arkave të Kursimit" me qëllim administrimin e depozitave të individëve dhe ndërmarrjeve, dhënien dhe administrimin e huave për individët, ndërmarrjet dhe subjektet shtetërore, si dhe për kryerjen e shërbimeve të ndryshme bankare.

Më 11 dhjetor 1992, Banka u regjistrua për të vepruar si Bankë në Republikën e Shqipërisë në përputhje me Ligjin nr.7560 "Për sistemin Bankar në Shqipëri". Banka e Shqipërisë i dha Bankës së Kursimeve një licensë të përgjithshme, të patransferueshme dhe të pakufizuar në kohë. Më 27 korrik 1997, në përputhje me Vendimin Nr.17426 të Gjykatës së Rrethit Tiranë, Banka u shndërrua në një Shoqëri me Kapital Aksionar. Aksionari i vetëm i Bankës ishte Ministria e Financës me një kapital fillestar prej 700 milionë Lek, i cili përbëhej nga 7,000 aksione me vlerë nominale 100,000 Lek për çdo aksion. Në bazë të këtij vendimi, Banka e Shqipërisë më 11 janar 1999 rinovoi licensën e Bankës për të pasqyruar këto ndryshime.

Më 14 prill 2004, Ministria e Financës së Shqipërisë i shiti Raiffeisen Zentralbank Osterreich Aktiengesellschaft (RZB AG) 100% të aksioneve të emetuara dhe në funksionim të Bankës.

Më 21 korrik 2004, RZB AG kaloi 100% të aksioneve në filialin krejtësisht në pronësi të RZB AG, Raiffeisen International AG, Vienna, Austria, i cili është tani aksionari i 100% të aksioneve të emetuara dhe në funksionim të Bankës.

Në Korrik 2010, aksionari i vetëm ndryshoi emrin nga Raiffeisen International Bank-Holding AG, në Raiffeisen Bank International AG. Ky ndryshim u regjistrua në regjistrin tregtar Austriak në Tetor 2010.

Më 28 prill 2006 Banka dhe RLI themeluan Raiffeisen Leasing Sh.a. Banka zotëron 75% të aksioneve të kompanisë. Më 15 janar 2009 Banka mori në pronësi 100% të aksioneve të Institutit Amerikan të Pensioneve Private Suplementare të Shqipërisë, sipas kontratës së shitblerjes së aksioneve të datës 26 dhjetor 2008. Më 23 prill 2009 emri i këtij të fundit ndryshoi në Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pensions sh.a.

Më tej, më 31 mars 2010, emir i filialit u ndryshua nga "Instituti Privat i Pensioneve Suplementare Raiffeisen - Raiffeisen Pensions sh.a.", në "Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a".

Pasqyrat e konsoliduara financiare të Grupit më 31 dhjetor 2010 dhe më 31 dhjetor 2009 përfshijnë Bankën, Raiffeisen Leasing Sh.a dhe Raiffeisen Pensions sh.a (së bashku "Grupi").

Më 31 dhjetor 2010, Banka operon me një rrjet bankar prej 103 pika shërbimi nëpër të gjithë Shqipërinë (më 31 dhjetor 2009: 102 pika shërbimi), të cilat drejtohen nga 8 Distrikte.

Drejtuesit dhe administratorët më 31 dhjetor 2010 dhe 2009:

Këshilli Drejtues (Këshilli Mbikqyrës)

Heinz Höedl	Kryetar
Herbert Stepic	Anëtar
Peter Lennkh	Anëtar
Martin Grüll	Anëtar
Aris Bogdaneris	Anëtar

Komiteti i Kontrollit

Heinz Höedl	Kryetar
Johannes Kellner	Anëtar
Susana Mitter	Anëtar

Bordi Drejtues

Christian Canacaris	Drejtor i Përgjithshëm
Alexander Zsolnai	Zv. Drejtor i Bordit Drejtues
John McNaughton	Anëtar
Raphaela Bischof-Rothauer	Anëtar

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Deklarata e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), dhe interpretimet e tyre të përshtatura nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

b) Baza e matjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur mbi bazën e kostos historike përveç sa më poshtë:

- Instrumentet derivative financiare janë matur me vlerë të drejtë,
- Instrumentet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë përmes fitim humbjes janë matur me vlerë të drejtë,
- Aktivet financiare të disponueshme për shitje janë matur me vlerë të drejtë.

c) Monedha funksionale dhe raportuese

Pasqyrat financiare të konsoliduara paraqiten në Lek, e cila është monedha funksionale e Grupit. Përveç rasteve ku tregohet ndryshe, informacioni financiar i prezantuar në Lek është rumbullakosur në mijëshen më të afërt.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimeve

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga vlerësimet.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacion mbi elementë të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare jepet në Shënimin 4.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL

Polikat kontabël të paraqitura më poshtë janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha periudhat e prezantuara në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Polikat kontabël janë zbatuar në mënyrë të qëndrueshme nga entitetet e Grupit.

a) Bazat e konsolidimit

(i) Kombinimi i bizneseve

Në përputhje me SNRF 3 "Kombinimi i bizneseve", një kombinim biznesi është bashkimi i entiteve ose bizneseve të veçanta në të njëjtin entitet raportues. Nëse transaksioni përmbush kriterin e kombinimit të bizneseve, duhet të përcaktohet nëse kombinimi i bizneseve përfshin entitete nën të njëjtin kontroll. Në përputhje me SNRF 3, dy entitete janë nën kontroll të përbashkët, kur entitetet ose bizneset e kombinuara kontrollohen nga e njëjta palë (palët) si para edhe pas kombinimit të biznesit dhe kur kontrolli nuk është i përkohshëm (kalimtar).

Kombinimet e biznesit janë kontabilizuar duke përdorur metodën e përvetësimit në datën e përvetësimit, e cila është data në të cilën kontrolli i është transferuar Grupit. Kontrolli është aftësia për të udhëhequr politikat financiare dhe operative të një entiteti, pra për të siguruar përfitime nga aktivitetet e tij. Për vlerësimin e kontrollit, Grupi merr në konsideratë të drejtat e mundshme të votës, të cilat janë aktualisht të ushtrueshme.

Emri i mirë është tejkalimi i kostos së përvetësimit nga Grupi përtej interesit të Grupit në vlerën (zakonisht vlera e drejtë) e aktiveve, detyrimeve dhe detyrimeve të mundshme të identifikueshme të entitetit që përvetësohet.

(ii) Filialet

Filialet janë entitete të cilat kontrollohen nga Grupi. Kontrolli ekziston atëherë kur Grupi në mënyrë direkte ose indirekte ka fuqi të drejtë politikat financiare dhe operative të një entiteti në mënyrë të tillë që të përfitojë të mira nga aktivitetet e tij. Për të vlerësuar kontrollin, merren në konsideratë të drejtat për të votuar të cilat janë të ushtrueshme ose të konvertueshme.

Pasqyrat financiare të filialeve janë përfshirë në pasqyrat financiare të konsoliduara që nga data e fillimit të kontrollit deri në datën e përfundimit të tij.

Grupi përgatit pasqyra financiare të konsoliduara dhe të veçanta në përputhje me SNRF dhe periudha raportuese është e njëjtë për të gjitha kompanitë e grupit.

Sipas natyrës së aktivitetit, filialet e Grupit kanë disa politika kontabël specifike të cilat detajohen në shënimin 3 (n) për Raiffeisen Leasing sh.a. dhe në shënimet 3 (r), (s), (t) për Shoqërinë Administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen – Raiffeisen Pension Funds Management Company sh.a.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

a) Bazat e konsolidimit (vazhdim)

(iii) Eliminimi i transaksioneve gjatë konsolidimit

Balancat brenda Grupit dhe të ardhurat dhe shpenzimet e perealizuara që lindin nga transaksionet brenda Grupit, eliminohen gjatë përgatitjes së pasqyrave financiare të konsoliduara. Humbjet e perealizuara eliminohen në të njëjtën mënyrë si të ardhurat e perealizuara, por deri në masën që nuk ka të dhëna për zhvlerësim.

b) Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj kthehen në Lek me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë raportimi, zërat monetarë të pasqyrës së pozicionit financiar të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen në Lek me kursin në datën e raportimit.

Fitimi ose humbja nga ndryshimi i kurseve të këmbimit është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të periudhës të rregulluara me interesin efektiv dhe pagesat gjatë periudhës, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të kthyer në monedhën funksionale me kursin e fundit të vitit. Aktivet dhe detyrimet jo monetare në monedhë të huaj të cilat maten me vlerë të drejtë, kthehen në monedhën funksionale me kursin e datës së caktimit të vlerës reale. Diferencat që lindin nga kurset e këmbimit regjistrohen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

c) Interesi

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skanton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivitetit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivitetit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset duke marrë parasysh njohjen fillestare të aktivitetit dhe detyrimit financiar dhe nuk ka rishikim të mëvonshëm.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, të cilat janë një pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksioneve janë kosto shtesë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen, ose emetimin e një aktiviteti apo detyrimi financiar.

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesi të paraqitura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve përfshijnë interesat nga aktivitetet ose detyrimet financiare me kosto të amortizuar mbi bazën e normës së interesit efektiv si dhe interesat nga letrat me vlerë të vlefshme për shitje të llogaritura mbi bazën e interesit efektiv.

d) Tarifa dhe Komisione

Të ardhurat dhe shpenzimet nga tarifat dhe komisionet të cilat janë pjesë integrale e normës së interesit efektiv në një aktiv ose detyrim financiar, përfshihen në matjen e normës së interesit efektiv.

Të ardhura të tjera nga komisionet dhe tarifat, duke përmendur këtu tarifat e shërbimeve kontabël, komisionet e shitjeve, tarifa të depozitave njihen në momentin që ofrohen shërbimet e lidhura me to. Shpenzime të tjera nga komisionet dhe tarifa lidhen kryesisht me tarifa transaksionesh ose shërbimesh të cilat shpenzohen në momentin që shërbimet përfitohen.

e) Të ardhurat neto nga tregtimi

Të ardhurat neto nga tregtimi përfshijnë fitimet minus humbje të lidhura me aktivitetet dhe detyrimet e tregtueshme, dhe gjithashtu të gjitha ndryshimet në vlerë të drejtë, të realizuara ose jo, interesin, dividendët dhe ndryshimet nga kurset e këmbimit.

f) Pagesat e qirasë dhe shpenzime të tjera operative

Pagesat e bëra nën qiranë operative janë njohur në të ardhura dhe shpenzime në bazë të metodës lineare mbi jetëgjatësinë e qirasë. Zbritje nga qiraja njihen si pjesë përbërëse e totalit të shpenzimit të qirasë gjatë jetës së qirasë. Shpenzimet operative regjistrohen atëherë kur ato ndodhin.

g) Përfitimet e punonjësve

• Plan pensioni me kontribute të përcaktuara

Kontributet ndaj planit të pensioneve me kontribut të përcaktuar ngarkohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve kur ato ndodhin. Grupi paguan kontribute për sigurimet shoqërore të detyrueshme për përfitimet e punonjësve që dalin në pension. Autoritetet Shqiptare janë përgjegjëse për përcaktimin e limitit minimal ligjor të vendosur për pensionet në Shqipëri sipas një plani kontributësh të përcaktuar për pensione.

• Leja vjetore e paguar

Grupi njësi detyrim vlerën e paskontuar të kostos së vlerësuar në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në këmbim të shërbimeve të punëmarrësit për periudhën.

• Përfitime afat-shkurtra

Detyrimet për përfitime afatshkurtra nuk skontojnë dhe regjistrohen në periudhën kur ofrohet shërbimi. Një provigjion mund të regjistrohet për shumën që pritet të paguhet në lidhje me bonuset afatshkurtra në para ose planet e pjesëmarrjes

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

g) Përfitimet e punonjësve (vazhdim)

në fitime, nëse Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv për të paguar këtë shumë si rezultat i shërbimeve të shkuara të ofruara nga punonjësi, dhe detyrimi mund të matet në mënyrë të besueshme.

- **Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënive të punës**

Përfitimet nga ndërprerja e marrëdhënive të punës regjistrohen atëherë kur Grupi në mënyrë të dukshme ka vendosur të zbatojë një plan formal të detajuar për të ndërprerë punësimin para datës së daljes në pension. Përfitime të ofruara për largimin vullnetar do të regjistrohen vetëm atëherë kur oferta është bërë, është e mundshme që do të pranohet, dhe numri i personave që do të pranojnë ofertën mund të matet në mënyrë të besueshme.

h) Tatim fitimi

Tatimi mbi fitimin përfshin tatimin e periudhës aktuale dhe tatimin e shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave përveç pjesës që lidhet me zëra të njohur direkt në kapital. Në këto raste tatimi njihet si zë i kapitalit. Tatimi aktual është tatimi që pritet të paguhet mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normën tatimore në fuqi ose që konsiderohet si e tillë në datën e mbylljes së pasqyrave financiare, dhe çdo sistemim të tatimit të pagueshëm për vitet e mëparshme.

Tatimi i shtyrë është llogaritur duke përdorur metodën e bilancit, nga diferencat e përkohshme ndërmjet vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe bazës tatimore. Shuma e tatimit të shtyrë është llogaritur duke përdorur normën tatimore të pritshme në datën kur diferencat e përkohshme do të rimerren, sipas ligjeve në fuqi në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit diferenca tatimore të zbritshme të mund të përdoren. Një pasiv tatimor i shtyrë njihet për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme. Aktivit tatimor i shtyrë dhe pasivi tatimor i shtyrë rishikohen çdo datë raportimi dhe zvogëlohen për aq sa nuk është e mundur të realizohet respektivisht përfitimi apo detyrimi fiskal i lidhur me të. Taksa të tjera shtesë lidhur me dividendin njihen kur njihet edhe detyrimi për pagimin e dividendit.

i) Aktivet dhe detyrimet financiare

(i) Njohja

Huatë dhe parapagimet dhe depozitat njihen fillimisht me kosto në datën e origjinës. Të gjitha aktivet financiare të tjera fillimisht njihen në datën e tregtimit, datë në të cilën Grupi bëhet palë e kontratës.

(ii) Ç'rregjistrimi

Aktivitetet financiare ç'rregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Grupit ndaj flukseve monetare që rrjedhin nga aktiviteti financiar mbarojnë, ose nëse Grupi i transferon aktivitetin financiar një pale tjetër, përmes një transaksioni ku të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivitetit transferohen. Çdo interes në aktive financiare të transferuara që përfitohet ose i mbahet Grupit njihet si një aktiv ose detyrim më vete.

Detyrimet financiare ç'rregjistrohen nëse detyrimet e Grupit të detajuara në kontratë mbarojnë, janë shlyer ose janë anuluar.

Grupi merr pjesë në transaksione me anë të të cilave transferon aktive të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar, por mban në të njëjtën kohë të gjitha risqet dhe përfitimet e aktivitetit të transferuar, ose një pjesë të tyre. Nëse të gjitha risqet dhe përfitimet mbahen, atëherë aktivitetet e transferuara nuk ç'rregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Transferimi i aktiveve për të cilat mbahen të gjitha risqet dhe përfitimet përfshin huadhënien e letrave me vlerë, dhe transaksionet e riblerjeve.

Kur aktivitetet i shiten një pale të tretë me një normë totale kthimi në këmbim ('swap'), transaksioni konsiderohet si një transaksion financiar i siguruar i ngjashëm me transaksionet e riblerjes.

Në transaksione në të cilat Grupi as nuk mban dhe as nuk transferon risqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivitetet financiare, e çregjistron aktivitetin nëse kontrolli mbi të humbet.

Të drejtat dhe detyrimet e mbajtura në transferim janë të njohura më vete si aktive ose detyrime sipas rastit.

Në transferimet e aktiveve mbi të cilat mbahet kontrolli Grupi vazhdon ta njohë aktivitetin deri në momentin e përfshirjes së tij të vazhdueshme, e përcaktuar kjo nga koha gjatë së cilës Grupi është i ekspozuar ndaj ndryshimeve në vlerën e aktivitetit të transferuar.

(iii) Matja e koston së amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktiviteti ose detyrimi financiar është vlera me të cilën aktiviteti ose detyrimi njihet në momentin fillestar duke i zbritur pagesat e principalit, plus/minus amortizimin e akumuluar duke përdorur metodën e interesit efektiv për çdo diferencë ndërmjet vlerës fillestare të njohur dhe vlerës në maturitet, minus çdo zbritje për efekt zhvlerësimi.

(iv) Matja e vlerës së drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare mbështetet mbi çmimet e kuotuar të tregut ose çmimet e agjentëve të shitjes për instrumenta financiare të tregtueshme në tregje aktive. Për të gjitha instrumentat e tjerë

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

i) Aktivet dhe detyrimet financiare (vazhdim)

financiare vlera e drejtë përcaktohet mbi bazën e teknikave të vlerësimit. Metodat e vlerësimit përfshijnë teknikën e vlerës aktuale neto, metodën e flukseve monetare të skontuara, dhe krahasimin me instrumenta të tjerë të ngjashëm për të cilat ekzistojnë çmime tregu dhe metoda vlerësimi.

Grupi përdor gjerësisht metodat e vlerësimit për të përcaktuar vlerën e drejtë të instrumentave financiare të zakonshme e të thjeshta si opsionet, swap-et e normave të interesit dhe të monedhës. Për të tilla instrumenta të dhënat për tu përdorur në modelet e vlerësimit janë lehtësisht të vëzhgueshme në treg.

(v) Netimi

Aktivët dhe detyrimet financiare netohen me njëra-tjetrën dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar atëherë dhe vetëm atëherë kur Grupi ka të drejtën ligjore për të netuar këto shuma dhe ka si qëllim ose t'i shlyejë neto ose të realizojë aktivin dhe të shlyejë detyrimin njëkohësisht.

Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten në bazë neto vetëm atëherë kur lejohet nga standardet kontabël, ose për fitimet dhe humbjet e krijuara nga një grup transaksionesh të ngjashme si ato në aktivitetin tregtues të Grupit.

(vi) Identifikimi dhe matja e zhvlerësimit

Në çdo datë raportimi Grupi vlerëson nëse ka evidencë objektive që aktivet financiare të cilat nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitim humbjes janë zhvlerësuar. Aktivet financiare zhvlerësohen kur evidenca objektive paraqet që një ngjarje që sjell humbje ka ndodhur pas njohjes fillestare të aktivit, dhe që ngjarja që sjell humbje ka një ndikim në flukset e ardhshme të parasë së aktivit, të cilat mund të maten me besueshmëri.

Grupi merr në konsideratë evidencat për zhvlerësim si për aktive specifike ashtu edhe në baza kolektive. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme trajtohen për zhvlerësim specifik. Të gjitha aktivet financiare të konsiderueshme të cilat specifikisht nuk kanë evidencë për zhvlerësim, trajtohen në grup për ndonjë zhvlerësim të ndodhur por të paidentifikuar ende. Aktivet të cilat nuk janë individualisht të konsiderueshme trajtohen së bashku për zhvlerësim duke u grupuar në aktive financiare (të mbajtura me kosto të amortizuar) me karakteristika të njëjta risku.

Evidenca objektive që aktivet financiare janë të zhvlerësuar mund të përfshijnë mospagesa ose shkelje nga huamarrësit, ristrukturimin e një huaje, të dhëna që një huamarrës po falimenton, zhdukjen e një tregu aktiv për një letër me vlerë, ose të dhëna të tjera të dukshme lidhur me një grup aktivesh si për shembull ndryshime të pafavorshme të aftësive paguese të një huamarrësi, ose kushte ekonomike që tregojnë për mospagime.

Për trajtimin e zhvlerësimit kolektiv Grupi përdor modelimin statistikor të trendave historike të propabilitetit të mospagimit, përcaktimin e kohës së rimarrjeve dhe vlerën e humbjes së ndodhur, përshtatur me gjykimin manaxherial nëse kushtet aktuale ekonomike dhe të kreditit janë të tilla që humbjet aktuale të jenë më të mëdha ose më të vogla se ato të përcaktuara nga modelimet historike. Normat e mospagimeve, normat e humbjes dhe përcaktimi i kohës së rimarrjes krahasohen përkundrejt rezultateve aktuale për të siguruar që ato të mbeten të përshtatshme.

Humbjet nga zhvlerësimi të aktiveve të mbajtura me kosto të amortizuar llogariten si diferencë e vlerës kontabël të aktiveve financiare dhe vlerës aktuale të flukseve monetare të skontuara me vlerën origjinale të interesit efektiv të këtyre aktiveve. Humbjet njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave dhe pasqyrohen në një llogari provigjoni përkundrejt huave dhe parapagimeve. Interesat mbi aktivet e zhvlerësuar vazhdojnë të njihen nëpërmjet skontimeve të pandryshueshme. Kur një ngjarje pas datës së raportimit shkakton uljen e humbjes nga zhvlerësimi, rimarrja e zhvlerësimit pasqyrohet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

(vii) Klasifikimi me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve

Grupi i klasifikon aktivet dhe detyrimet financiare me vlerë të drejtë nëpërmjet pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve kur:

- Aktivët ose detyrimet trajtohen, vlerësohen dhe raportohen me vlerën e drejtë të tyre.
- Klasifikimi shmang ose ul në një masë të konsiderueshme një mospërputhje kontabël që në kushte të tjera do të ishte e pranishme.
- Aktivi ose detyrimi përmban një derivativ që modifikon në mënyrë të konsiderueshme flukset monetare që do të kërkoreshin në rast të kundërt mbi bazën e kushteve kontraktuale.

j) Paraja dhe ekuivalentët e saj

Paraja dhe ekuivalentët e saj përfshijnë kartëmonedha, monedha, gjëndje të pakushtëzuara të Bankës Qëndrore, llogari rrjedhëse dhe depozita me afat maturimi më pak se tre muaj, të cilat nuk ndikohen shumë nga ndryshimet në vlerën e drejtë dhe përdoren nga Grupi për administrimin e angazhimeve afat shkurtra.

Këto aktive mbahen me koston e amortizuar në pasqyrën e pozicionit financiar.

k) Aktivet dhe detyrimet e tregtueshme

Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme janë ato aktive dhe detyrime që Grupi ka kryesisht për qëllimin e shitjes ose riblerjes në periudhën afatshkurtër, ose i mban si pjesë e portofolit i cili përdoret për ruajtjen e pozicionit ose për përfitime afatshkurtra. Aktivët dhe detyrimet e tregtueshme, fillimisht njihen me kosto dhe më vonë mbahen me vlerën e drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar, duke i kaluar kostot e transaksionit si fitim ose humbje në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

k) Aktivet dhe detyrimet e tregtueshme (vazhdim)

Çdo fitim ose humbje si pasojë e ndryshimit në vlerën e drejtë njihet si pjesë e "Të ardhura nga tregtimi". Aktivet dhe detyrimet e tregtueshme nuk riklasifikohen pas regjistrimit fillestar.

l) Derivatët jo të tregtueshëm

Derivatët e mbajtura për qëllime të manaxhimit të riskut përfshijnë të gjitha aktivet dhe detyrimet derivative të cilat nuk janë të klasifikuara si aktive ose detyrime të tregtueshme. Derivatët maten me vlerë të drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar. Kur një derivativ nuk është i tregtueshëm dhe nuk klasifikohet në një marrëdhënie hedge (mbrojtje) të kualifikuar, të gjitha ndryshimet në vlerën e drejtë të tij njihen menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave si një përbërës i të ardhurave të tregtimit. Vlera e drejtë e swap-eve të normës së interesit është shuma e vlerësueshme që Grupi do të mund të përfitonte ose paguante për të përfunduar swap-in në datën e mbylljes së raportimit, duke marrë parasysh normat aktuale të interesit dhe besueshmërinë e homologëve të swap-it. Vlera e drejtë e kontratave të këmbimit të ardhshëm ('forward') të monedhave të huaja është çmimi i tyre i tregut në datën e raportimit, pra vlera aktuale e çmimeve të ardhshme ('forward') të kuotuar në treg.

m) Huatë dhe paradhëniet

Huatë dhe paradhëniet janë aktive financiare jo-derivative, me pagesa fikse ose të përcaktueshme, të cilat nuk janë kuotuar në tregje aktive dhe Grupi nuk ka për qëllim t'i shesë në periudhë afatshkurtër.

Kur Grupi është qiradhënës në një kontratë qiraje që transferon thujtje të gjitha rreziqet dhe të mirat e lidhura me pronësinë e një aktivi tek një qiramarrës, marrëveshja prezantohet brenda huave dhe paradhënieve.

Kur Grupi blen një aktiv financiar dhe njëherësh hyn në një marrëveshje për ta rishitur këtë aktiv (ose një aktiv kyesisht të ngjashëm) me një çmim të fiksuar në një datë të ardhshme (marrëveshje të anasjellta të riblerjes), marrëveshja kontabilizohet si një hua apo paradhënie dhe aktivet në bazë të marrëveshjes nuk paraqiten në pasqyrat financiare të Grupit.

Huatë dhe paradhëniet fillimisht maten me vlerë të drejtë plus kosto direkte transaksioni dhe në vazhdim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

n) Qiraja financiare

Një qira klasifikohet si qira financiare nëse ajo transferon në mënyrë të konsiderueshme të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë tek qiramarrësi. Çdo marrëveshje tjetër qiraje përveç qirasë financiare klasifikohet si qira e zakonshme. Shumat për t'u marrë nga qiramarrësit njihen si të arkëtueshme me vlerën e investimit neto të Shoqërisë në qiranë financiare.

Pagesat minimale të qirasë nën qiratë financiare shpërndahen ndërmjet të ardhurave financiare dhe reduktimit të aktiveve të mbetura. E ardhura financiare shpërndahet në çdo periudhë gjatë jetës së qirasë në mënyrë që të prodhojë normë interesi konstante mbi shumën e mbetur të aktivitetit.

Pagesat e mundshme të qirasë kontabilizohen duke rishikuar minimumin e pagesave të qirasë mbi jetën e mbetur të qirasë kur konfirmohen rregullimet.

o) Letrat me vlerë

Investimi në letrat me vlerë matet me vlerën e tregut duke i shtuar kostot direkte të transaksionit dhe në vijim kontabilizohet mbi bazën e klasifikimit si të mbajtura deri në maturim, me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve, ose të disponueshme për shitje.

(i) Letra me vlerë të mbajtura deri në maturim

Letrat me vlerë që mbahen deri në maturim janë investime që kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe për të cilat Grupi ka qëllimin dhe mundësinë për t'i mbajtur deri në maturim, të cilat nuk janë klasifikuar si të disponueshme për shitje, apo me vlerë të drejtë përmes pasqyrës së të ardhurave dhe regjistrohen pas njohjes fillestare me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çdo shitje ose riklasifikim i shumave të konsiderueshme të investimeve të mbajtura deri në maturim, jo shumë afër maturimit, do të çonte në riklasifikimin e të gjithë portofolit të mbajtur deri në maturim si investim i mbajtur për shitje dhe do ndalonte Grupin për klasifikimin e tyre si investim i mbajtur deri në maturim për periudhën aktuale dhe për dy vitet pasuese.

(ii) Me vlerë të drejtë përmes pasqyrës përmbledhëse të të ardhurave

Grupi mban disa letra me vlerë me vlerën e tregut, me ndryshimet në vlerë të njohura menjëherë në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave siç përshkruhet në politikën kontabël 3(i)(vii).

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABEL (VAZHDIM)

o) Letrat me vlerë (vazhdim)

(iii) Letra me vlerë të disponueshme për shitje

Investime të disponueshme për shitje janë investime jo-derivative të cilat nuk klasifikohen në ndonjë kategori tjetër të aktiveve financiare. Investimet në kapital të cilat nuk janë të kuotuar dhe vlera e drejtë nuk mund të matet në mënyrë të besueshme, maten me kosto. Mjetet e tjera të disponueshme për shitje mbahen në pasqyrat financiare me vlerën e drejtë të tyre.

Të ardhurat nga interesi regjistrohen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave sipas metodës së interesit efektiv. Ndryshimet në vlerën e drejtë njihen direkt në kapital deri në momentin që letra me vlerë shitet ose zhvlerësohet, kur vlera progresive e njohur në kapital, kalon si fitim ose humbje në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

p) Aktivët afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Kosto përfshin shpenzime që janë drejtpërdrejt të ngarkueshme për blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Grupi përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore, si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejt me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar nga drejtimi, dhe kostot e çmontimit dhe kthimit të vendndodhjes në kushtet e duhura.

Kur pjesë të një elementi të aktiveve afatgjata materiale kanë jetëgjatësi të dobishme të ndryshme, ato kontabilizohen si elementë të konsoliduara të aktiveve afatgjata materiale.

(ii) Kostot vijuese

Kostoja e zëvendësimit të një pjese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur të elementit nëse është e mundur që përfitime ekonomike në të ardhmen që i atribuohen atij elementi do të rrjedhin në Grup, dhe kostoja e tij mund të matet me besueshmëri. Kostot e shërbimeve ditore të aktiveve afatgjata materiale njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

(iii) Zhvlerësimi

Zhvlerësimi njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave me anën e metodës lineare gjatë jetës së çdo aktivi afatgjatë material. Aktivët e marra me qera zhvlerësohen për më të shkurtrën midis kohës së qirasë dhe jetëgjatësisë së aktivitetit. Toka nuk zhvlerësohet.

Jetëgjatësia për periudhën aktuale dhe atë krahasuese është si vijon:

	2010 (në vite)	2009 (në vite)
• Ndërtesa	20	20
• Kompjuteri, ATM dhe pajisje informatike	4	4
• Automjete	5	5
• Investime në mjetet e marra me qira	2-4	2-4
• Të tjera (Pajisje Zyre)	5	5

Jetëgjatësia dhe vlera e mbetur rishikohen në datën e raportimit.

q) Aktivët afatgjata jomateriale

Aktivët afatgjata jomateriale të blera nga Grupi njihen me koston historike zvogëluar me amortizimin dhe humbjet e akumuluar nga rënia në vlerë.

Shpenzimet e mëvonshme mbi aktivët afatgjata jomateriale kapitalizohen vetëm kur këto shpenzime lidhen me rritjen e përfitimit të ardhshëm ekonomik prej këtij aktivi. Të gjitha shpenzimet e tjera njihen në periudhën që ndodhin në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Shpenzimi i amortizimit njihet në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave, bazuar mbi metodën lineare të amortizimit gjatë jetës së dobishme ekonomike, prej datës në të cilën aktivi është i gatshëm për përdorim. Jeta e dobishme ekonomike e aktiveve afatgjata jomateriale është 4 vjet.

Shpenzimet e kërkimit, të kryera me qëllim përfitimin e një njohurie shkencore ose teknike regjistrohen si shpenzim në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin kur ndodhin.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

r) Fondi i Pensioneve Vullnetare Raiffeisen

Shoqëria vepron si Shoqëri Administruese e një Fondi Vullnetar me Kontribute të përcaktuara "Fondin e Pensionit Vullnetar Raiffeisen / Raiffeisen Voluntary Pension Fund" ("Fondi") i cili, bazuar në ligjin e ri, nuk ka personalitet ligjor dhe nuk mund të rregjistrohet si një Shoqëri më vete. Gjithsesi, kërkesat e ligjit të ri përcaktojnë përgjegjësinë e Shoqërisë për të përgatitur pasqyra të veçanta financiare për Shoqërinë dhe për Fondin.

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen ka bërë përgatitjet e duhura për të qenë në përputhje me ligjin e ri duke filluar nga 1 Janari 2011, përfshirë mbajtjen më vete të veprimtarisë dhe të dhënave financiare të Shoqërisë dhe të Fondit. Për të realizuar këtë, një program i ri kompjuterik është blerë me qëllim llogaritjen ditore të parametrave të Fondit siç kërkohet nga ligji i ri.

Si rrjedhojë e pasigurive lidhur me kuadrin rregullator të raportimit dhe në mungesë të politikave apo rregulloreve lidhur me kërkesat për raportim të veçantë të pasqyrave financiare të Shoqërisë dhe të Fondit në datën e përgatitjes dhe aprovimit të pasqyrave financiare, Shoqëria nuk ka përgatitur pasqyra financiare të veçanta më 31 dhjetor 2010 dhe për rrjedhojë aktiviteti dhe aktivet e Fondit janë përfshirë në aktivitetin dhe pasqyrat financiare të Shoqërisë.

s) Fondi i Pensioneve Vullnetare

Bazuar në ligjin 7943 "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve", Fondi i Pensioneve Vullnetare mbledh kontribute nga punëdhënësit dhe individët, ku minimumi i kontributit, i përcaktuar nga ligji është 500 Lek. Fondi është krijuar për të siguruar shërbimin e pensioneve për publikun. Në përputhje me kontratat e nënshkruara me punëdhënësit, ose me individët, përfitimet janë të pagueshme në të ardhmen. Përfitimet përbëhen nga kontributet vullnetare të mbledhura dhe interesi i përfutur nga këto kontribute. Interesi fillon të përllogaritet 15 ditë pas çdo arkëtimi individual.

Kontributet vullnetare të akumuluar janë investuar në bono thesari, obligacione të qeverisë shqiptare dhe është përllogaritur një normë kthimi vjetore. Shuma vjetore e interesit, e cila është shtuar në llogarinë individuale të çdo kontribuesi, është përllogaritur duke përdorur një normë, e cila është më e ulët se norma e kthimit të investimeve (për të realizuar kostot e manaxhimit sipas rregullit 75/25).

Në bazë të Vendimit të Administratorëve të Kompanisë Nr. 717, datë 17 Janar 2011, norma vjetore e përdorur në llogaritjen e interesave të kontribuesve për vitin 2010 është 6,89% (2009: 28,49%).

Interesi i fituar nga anëtarët është kredituar në detyrimet e fondit të pensionit dhe të ardhurat nga interesat dhe nga transaksionet me letrat me vlerë janë prezantuar neto duke zbritur interesat e fituara nga anëtarët e fondit.

t) Plani i kontributeve të përcaktuara

Sipas planit të kontributeve të përcaktuara, shuma e përfitimeve në të ardhmen për një anëtar përcaktohet nga kontributet e paguara si dhe interesat e fituara nga kontributet e investuara.

Detyrimet janë njohur në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në momentin e duhur dhe janë paraqitur si interes që i kreditohet fondit të pensionit nga të ardhurat nga investimet.

Shoqëria përfiton të ardhura nga investimet, të cilat llogariten si një pjesë e normës së interesave nga investimet të arritura nga Fondi (shiko shënimin 2). Kjo mesatare përllogaritet çdo vit për Fondin dhe Shoqërinë. Përveç kësaj, Shoqëria merr një tarifë fillestare prej 200 Lek.

Tarifa fillestare mbledhet në hapjen e një llogarie të re personale. Kjo praktikë gjithashtu bazohet në ligjin 7943 "Për Pensionet Suplementare dhe Institutet Private të Pensioneve".

u) Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare janë burimet kryesore të financimit të Grupit.

Kur Grupi shet një aktiv financiar dhe hyn në një marrëveshje ri-blejeje për ta blerë këtë aktiv (ose një aktiv të ngjashëm) me një çmim fiks në të ardhmen, marrëveshja kontabilizohet si një depozitë, dhe aktivi vazhdon të njihet në pasqyrat financiare të Grupit.

Grupi klasifikon instrumentet kapitale si detyrime financiare ose instrumenta kapitale në përputhje me thelbin e kushteve kontraktuale të instrumentit.

Depozitat dhe detyrimet e tjera financiare maten fillimisht me vlerën e tregut duke i shtuar kostot e transaksionit dhe në vijim maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv.

v) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Grupit, përveç inventarit dhe aktiveve tatimore të shtyra rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka evidenca për zhvlerësim. Nëse ka evidenca të tilla atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivit.

Humbje nga rënia në vlerë njihet nëse vlera kontabël e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare tejkalon vlerën e rikuperueshme. Njësia gjeneruese e mjeteve monetare është grupi me i vogël i identifikueshëm i aktiveve që gjeneron flukse monetare që janë të pavarura nga aktivet dhe grupet e tjera. Humbjet nga rënia në vlerë njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave.

Vlera e rikuperueshme e një aktivi ose e njësisë gjeneruese të mjeteve monetare është vlera më e madhe ndërmjet vlerës

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

v) Rënia në vlerë e aktiveve jo-financiare (vazhdim)

së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës së tij në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, flukset e ardhshme të vlerësuar të mjeteve monetare janë skontuar në vlerën e tyre aktuale duke përdorur një normë skontimi para taksave që reflekton vlerësimin aktual të tregjeve për vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike për aktivin.

Humbjet e mëparshme rishikohen në çdo datë raportimi për të vlerësuar nëse ka evidencë se rënia në vlerë është ulur apo nuk ekziston më. Një humbje anulohet nëse ka evidencë se nuk ka zhvlerësim, dhe ka patur ndryshim në vlerësimet e përdorura për përcaktimin e vlerës së rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë anulohet deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur zhvlerësimin apo amortizimin, dhe sikur të mos ishte njohur më parë ndonjë humbje nga rënia në vlerë.

x) Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i ngjarjeve të mëparshme, Grupi ka një detyrim ligjor ose konstruktiv i cili mund të matet në mënyrë të besueshme, dhe është e mundur që të mira ekonomike do të kërkohen për shlyerjen e këtij detyrimi. Provigjonet caktohen duke skontuar flukset e pritshme të parave me një normë para takse e cila reflekton vlerën e tregut, dhe nëse është e përshtatshme, rrezikun specifik të detyrimit.

y) Standarde dhe interpretime efektive në periudhën aktuale

Rishikimet e mëposhtme për standardet ekzistuese të nxjerra nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe interpretimet e nxjerra nga Komiteti i Interpretimeve të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar janë të vlefshme për periudhën aktuale:

- **SNRF 1 (i rishikuar) "Aplikimi për herë të parë i SNRF"** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **SNRF 3 (i rishikuar) "Kombinimet e Biznesit"** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNRF 1 "Aplikimi për herë të parë i SNRF"** – Përfshijet shtesë për herën e parë të zbatimit. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2010 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNRF 2 "Pagesa të Bazuara në Aksione"** – Grup transaksionesh për pagesë aksionesh të shlyer në mjete monetare (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2010 ose pas kësaj date),
- **Rishikimi i SNK 27 "Pasqyrat Financiare të Konsoliduara dhe Individuale"** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNK 39 "Instrumentet Financiare: Njohja dhe Matja"** – Artikujt mbrojtës të pranueshëm. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **Ndryshimet në disa standarde dhe interpretime "Përmirësimet e IFRS-ve (2009)"** që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimet në cilësi të SNRF-ve të publikuara më 16 Prill 2009 (SNRF 2, SNRF 5, SNRF 8, SNK 1, SNK 7, SNK 17, SNK 18, SNK 36, SNK 38, SNK 39, KIRFN 9, KIRFN 16) kryesisht me qëllim heqjen e paqëndrueshmërive dhe përmirësimin e tekstit (shumica e rishikimeve do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2010 ose pas kësaj date),
- **KIRFN 17 "Shpërndarja e Aktiveve Jo-monetare ndaj Pronarëve"** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date),
- **KIRFN 18 "Transferimi i Aktiveve nga Klientët"** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2009 ose pas kësaj date), [duke supozuar se një transferim i tillë i aktiveve nuk ka ndodhur në gjysmën e dytë të vitit 2009 dhe se Shoqëria e ka aplikuar KIRFN 18 për herë të parë në 2010].

Aplikimi i këtyre rishikimeve dhe standardeve e interpretimeve ekzistuese nuk ka çuar në ndonjë ndryshim në politikat kontabël të Grupit.

z) Standarde dhe interpretime të publikuara akoma të pa-miratuara

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, standardet, rishikimet dhe interpretimet e mëposhtme ishin publikuar, por ende jo në fuqi:

- **SNRF 9 "Instrumentet Financiare"** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2013 ose pas kësaj date). SNRF 9 "Instrumentet Financiare" u publikua nga BSNK më 12 nëntor 2009. Më 28 shtator 2010, BSNK ripublikoi SNRF 9, duke shtuar kërkesa të reja mbi kontabilizimin e detyrimeve financiare dhe duke mbajtur nga SNK 39 kërkesat për çrregjistrimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Standardi përdor një metodologji të vetme për të përcaktuar nëse aktivi financiar matet me kosto të amortizuar apo me vlerë të drejtë, duke zëvendësuar rregullat e shumta në SNK 39. Metodologjia e SNRF 9 bazohet mbi mënyrën se si një Shoqëri manaxhon instrumentat financiare (sipas modelit të biznesit) dhe karakteristikat e rrjedhjes së parasë së kontraktuar të aktivit financiar. Standardi i ri gjithashtu kërkon përdorimin e një metode zhvlerësimi, duke zëvendësuar metodat e ndryshme të zhvlerësimit në SNK 39. Kërkesat e reja për kontabilizimin e detyrimeve financiare adresojnë problemin e luhatjeve në fitim humbjet që lindin kur lëshuesi zgjedh ta vlerësojë borxhin me vlerën e drejtë. BSNK vendosi të mbajë vlerësimin aktual me kosto të amortizuar për shumicën e detyrimeve, duke u kufizuar në ndryshimet e kërkuara për

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL (VAZHDIM)

z) Standarde dhe interpretime të publikuara akoma të pa-miratuara (vazhdim)

të adresuar problemet e vetë kreditimit. Me kërkesat e reja, Grupi që zgjedh të vlerësojë një detyrim me vlerën e drejtë do paraqesë pjesën e ndryshimit në vlerën e drejtë si pasojë e ndryshimeve në rrezikun e kreditimit, në të ardhura të tjera përmbledhëse. SNRF 9 e publikuar pasqyron pjesën e pare të punës së BSNK në zëvendësimin e SNK 39 dhe lidhet me klasifikimin dhe matjen e aktiveve dhe detyrimeve financiare të përkufizuara nga SNK 39. Në faza të mëtejshme, Bordi do adresojë zhvlerësimin dhe mbrojtjen [hedge]. Përfundimi i projektit pritet në mes të 2011. Aplikimi i fazës së parë të SNRF 9 kryesisht do ketë efekt në klasifikimin dhe matjen e aktiveve financiare. Grupi aktualisht po vlerëson efektin e aplikimit të SNRF 9, gjithsesi, efekti do varet nga aktivet që do ketë Grupi në datën e aplikimit, ndaj aktualisht nuk mund të kuantifikohet efekti.

- **Rishikim i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF”**- Përjashtimet e limituara për shifrat krahasuese sipas SNRF 7; për paraqitjet për herën e parë të zbatimit (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2010 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNRF 1 “Aplikimi për herë të parë i SNRF”**- Hiperinflacion i rëndë dhe heqja e datave të përcaktuara për herën e parë të zbatimit (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2011 ose pas kësaj date),
- **Rishikimi i SNRF 7 “Instrumentet Financiare: Paraqitja”** –Transferimi i aktiveve financiare (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2011 ose pas kësaj date),
- **Rishikimi i SNK 12 “Tatimet mbi të ardhurat”** – Taksa e shtyrë: Rimarrja e aktivitet bazë (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2012 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNK 24 “Dhënia e Informacioneve Shpjeguese për Palët e Lidhura”** – Thjeshtësimi i kërkesave për paraqitjet e entiteteve të lidhura me qeverinë dhe qartësimi i përkufizimit të palëve të lidhura. (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2011 ose pas kësaj date),
- **Rishikim i SNK 32 “Instrumentet Financiare: Paraqitja”** – Kontabilizimi i të drejtave për të emetuar (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Shkurt 2010 ose pas kësaj date)
- **Ndryshimet në disa standarde dhe interpretime “Përmirësimet e IFRS-ve (2010)”** që rezultojnë nga projektet vjetore për përmirësimet në cilësi të SNRF-ve të publikuara më 6 Maj 2010 (SNRF 1, SNRF 3, SNRF 7, SNK 1, SNK 27, SNK 34, KIRFN 13) kryesisht me qëllim heqjen e paqëndrueshmërive dhe përmirësimin e tekstit (rishikimet do të aplikohen për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2010 ose pas kësaj date ose në 1 Janar 2011 se pas kësaj date në varësi të standardit / interpretimit),
- **Rishikim i KIRFN 14 “SNK 19 – Limiti i Aktivitet për përfitime të përcaktuara, Kërkesat minimale për fonde dhe ndërveprimet e tyre.** – Parapagimet e një minimumi të kërkesës për fonde (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Janar 2011 ose pas kësaj date),
- **KIRFN 19 “Shuarja e Detyrimeve me instrumente Kapitali”** (e vlefshme për periudhat vjetore që fillojnë në 1 Korrik 2010 ose pas kësaj date).

Grupi ka zgjedhur të mos aplikojë këto standarde, rishikime dhe interpretime përpara datave efektive të tyre. Përveç siç shpjegohet më lart lidhur me SNRF 9, Grupi parashikon se aplikimi i këtyre standardeve, rishikimeve dhe interpretimeve nuk do të ketë ndikim material në pasqyrat e tij financiare të konsoliduara në periudhën e aplikimit fillestar.

w) Krahasueshmëria

Për efekt krahasueshmërie, aktivet afatgjata jomateriale të filialit të paraqitura në kategorinë software në 2009 janë shpërndarë midis kategorive përkatëse të Liçensa dhe Software të aktiveve afatgjata jomateriale. Vlera e mbetur neto e aktiveve afatgjata jomateriale të riklasifikuara është 6,994 mijë Lek.

Për qëllime krahasueshmërie, një pjesë e shpenzimeve të trajnimit për personelin janë riklasifikuar nga zëri “Shpenzime për personelin” i pasqyrës së të ardhurave përmbledhëse në zërin “Shpenzime të përgjithshme administrative” të pasqyrës së të ardhurave përmbledhëse.

4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE DHE GJYKIMEVE

Drejtimi i Grupit diskuton me Komitetin e Kontrollit zhvillimin, zgjedhjen dhe paraqitjen e politikave dhe vlerësimeve kritike kontabël të Grupit, dhe aplikimin e këtyre politikave dhe vlerësimeve.

Këto shënime shpjeguese mbështesin komentet mbi administrimin e rrezikut financiar (shënimi 5).

Burimet kryesore të pasigurisë në matje

Provizione për humbje nga kreditë

Aktivët e regjistruara me kosto të amortizuara vlerësohen për të identifikuar rënie në vlerë të aktivitetit, në bazë të politikave të përshkruara në 3(i)(vi).

Përbërësi specifik në totalin e fondit të zhvlerësimit të aktiveve financiare të vlerësuara individualisht, bazohet në vlerësimin më të mirë të flukseve të pritshme të parasë. Për të llogaritur këto flukse të parave drejtimi gjykon mbi situatën financiare të palës tjetër dhe vlerën neto të realizueshme të ndonjë garancie. Çdo aktiv i zhvlerësuar, matet bazuar mbi cilësitë e tij, dhe llogaritja e flukseve të parasë që konsiderohen të arkëtueshme aprovet në mënyrë të pavaruar nga Risku i Kredisë.

Fondi i zhvlerësimit të portofolit mbulon humbje nga kreditë dhënë klientëve me karakteristika ekonomike të ngjashme, kur nuk ka ndonjë evidencë të dukshme për humbje, por humbja mund të ketë ndodhur dhe pse e paidentifikueshme në datën e pasqyrave financiare. Një element i fondit kolektiv për zhvlerësimin e kredive është rreziku i vendit ku është dhënë kredia. Në vlerësimin e nevojës për fond kolektiv, drejtimi konsideron faktor si cilësia e kreditimit, madhësia e portofolit, përqëndrimi si dhe faktorë ekonomik. Në mënyrë që të vlerësohet fondi i kërkuar, janë bërë supozime për të përcaktuar se si janë modeluar humbjet dhe për të përcaktuar parametrat e kërkuar, bazuar në të kaluarën ose nga kushtet aktuale ekonomike. Saktësia e vlerësimit të fondit kolektiv të zhvlerësimit varet nga sa të matshme janë flukset e ardhshme të projektuara nga aktivi dhe supozimet dhe parametrat e përdorura në modelin e vlerësimit.

Përcaktimi i vlerës së drejtë

Banka përcakton vlerën e drejtë duke përdorur Nivelin 2 të hierarkisë së vlerës së drejtë që paraqet rëndësinë e të dhënave të marra në përcaktimin e vlerësimit, të përshkruara si më poshtë:

- Niveli 2: Teknika vlerësimi të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme, qoftë në mënyrë direkte (si çmimet) ose në mënyrë indirekte (si për shembull të dhëna që rrjedhin prej çmimeve). Kjo kategori përfshin investime të vlerësuara duke përdorur: çmime të kuotuar të tregut në tregje aktive për instrumenta të ngjashëm; çmime të kuotuar për instrumenta identike ose të ngjashme në tregje që konsiderohen më pak aktive; ose teknika të tjera vlerësimi ku të gjitha të dhënat e rëndësishme janë në mënyrë direkte ose indirekte të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare që tregtohen në tregje aktive bazohet në çmimet e kuotuar të tregut apo në kuotimet e tregtuesve. Për të gjithë instrumentet e tjerë financiarë, vlera e drejtë përcaktohet duke përdorur teknika vlerësimi siç përshkruhen në politikën kontabël 3(i)(iv). Për instrumentet financiarë që kanë treg financiar, por jo aktiv dhe çmimi i tregut nuk është transparent mjaftueshëm, vlera është më pak objektive dhe kërkon shkallë variabël gjykimi në varësi të likuiditetit, përqëndrimit, pasigurisë e faktorëve të tregut, supozime rreth çmimit dhe risqe të tjera që ndikojnë mbi instrumentin specifik.

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR

a) Të përgjithshme

Përdorimi i instrumentave financiarë e ekspozojnë Grupin ndaj rreziqeve të mëposhtme:

- rreziku i kreditimit
- rreziku i likuiditetit
- rreziku i tregut
- rreziku operacional

Ky shënim paraqet informacion rreth ekspozimit të Grupit ndaj çdo rreziku të përmendur më lart, objektivat, politikat dhe procedurat për vlerësimin dhe administrimin e rrezikut, dhe administrimin e kapitalit të Grupit.

Struktura e administrimit të rrezikut

Bordi Drejtues ka përgjegjësi për themelimin dhe vëzhgimin e strukturës së administrimit të rrezikut. Bordi ka themeluar Komitetin e Aktiveve dhe Detyrimeve (ALCO) dhe Komitetin e Kredisë së Grupit, të cilët janë përgjegjës për zhvillimin dhe monitorimin e politikave të administrimit të riskut. Të gjitha komitetet përbëhen nga anëtarë ekzekutiv dhe jo-ekzekutiv dhe raportojnë rregullisht tek Bordi Drejtues.

Politikat e administrimit të rrezikut janë krijuar për të identifikuar dhe analizuar rreziqet e hasura nga Grupi, për të vendosur kufizime dhe kontrole, dhe për të monitoruar zbatimin e këtyre kontroleve. Politikat e administrimit të rrezikut rishikohen rregullisht për të reflektuar ndryshimet në kushtet, produktet dhe shërbimet e tregut. Grupi, nëpërmjet trainimeve, standardeve dhe procedurave drejtuese, synon të zhvillojë një mjedis kontrolli të disiplinuar dhe konstruktiv, në të cilin çdo punonjës do kuptojë rolin dhe detyrimet përkatëse.

Komiteti i kontrollit është përgjegjës për monitorimin e përputhshmërisë me politikat dhe procedurat e administrimit

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

a) Të përgjithshme (vazhdim)

të rrezikut dhe për të vlerësuar mjaftueshmërinë e strukturës së administrimit të rrezikut në lidhje me rreziqet e hasura nga Grupi. Komiteti i kontrollit mbështetet nga kontrolli i brendshëm i Grupit për të kryer funksionet e veta. Kontrolli i brendshëm vëzhgon në mënyrë të rregullt politikat dhe procedurat e administrimit të rrezikut, dhe raporton rezultatet e vëzhgimeve tek Komiteti i Kontrollit.

Zhvillimet aktuale

Grupi operon në kushtet e një zhvillimi dinamik të një krize financiare dhe ekonomike. Zgjerimi i saj mund të rezultojë në implikime negative të pozicionit financiar të Grupit. Drejtimi i Grupit performon çdo ditë monitorimin e pozicioneve të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, si edhe të zhvillimit të tregjeve ndërkombëtare financiare, duke vënë në zbatim praktikat më të mira bankare. Drejtimi është i bazuar në analizat e fitimit, likuiditetit dhe kostos së fondeve dhe merr masa të përshtatshme në lidhje me kreditimin, tregun (kryesisht normën e interesit) dhe rrezikun e likuiditetit, duke kufizuar kështu efektet e mundshme negative të krizës globale financiare dhe ekonomike. Në këtë mënyrë Grupi i përgjigjet ndryshimeve të tregut, duke mbajtur një kapital dhe një pozicion likuiditeti të qëndrueshëm.

b) Rreziku i kreditimit

Rreziku i kreditimit është rreziku i humbjes financiare nëse klienti, apo pala e instrumentit financiar nuk arrin të përmbushë detyrimet kontraktuale që rrjedhin nga instrumenti. Ky rrezik vjen kryesisht nga kreditë dhe paradhëniet e klientëve, bankave dhe investimi në letra me vlerë. Për qëllime raportimi të administrimit të kredisë, Grupi konsideron të gjitha elementët e ekspozimit ndaj rrezikut të kredisë (si rreziku që rrjedh nga vetë klienti, pozicioni gjeografik dhe sektori). Për qëllime të administrimit të rrezikut, rreziku i kredisë nga letrat me vlerë të tregtueshme trajtohet në mënyrë të pavarur, por raportohet si një komponent i ekspozimit të riskut të tregut.

Administrimi i rrezikut të kreditimit

Bordi i drejtuesve ka deleguar përgjegjësinë për administrimin e rrezikut tek Komiteti i Kreditimit të Bankës. Një divizion i veçantë i administrimit të rrezikut të kreditimit, i cili raporton te Komiteti i Kreditimit, është përgjegjës për mbikqyrjen e rrezikut të kredisë duke përfshirë:

- Formulimin e politikave të kreditimit duke u konsultuar me njësitë e biznesit, rreth kërkesave për kolateral, vlerësimin e kredive, klasifikimin dhe raportimin e rrezikut, dhe përputhshmërinë me ligjet dhe procedurat ligjore në fuqi.
- Themelimin e strukturës autorizuese për aprovimin dhe rinovimin e faciliteteve të kreditimit. Komiteti i Kreditimit ose Bordi Drejtues i Grupit ka në dorë kufizimet për sa i përket autorizimeve të ndryshme.
- Mbikqyrjen dhe vlerësimin e rrezikut të kreditimit. Grupi vlerëson të gjitha ekspozimet ndaj rrezikut të kreditimit të cilat e kalojnë kufirin e vendosur, përpara se facilitetet të jenë të angazhuara ndaj klientëve nga njësitë përkatëse të biznesit. Rinovimet dhe rishikimet e faciliteteve janë subjekt i të njëjtit proces rishikimi.
- Të kufizojë ekspozimin ndaj palëve, zonave gjeografike dhe industrive (për huatë dhe parapagimet), bandën e klasifikimit të kredive dhe nivelin e kreditimit të institucionit financiar, likuiditetin e tregut dhe ndaj shteteve të ndryshme (për investimet në letra me vlerë).
- Zhvillimin dhe përdormin e sistemit të vlerësimit të rrezikut të Grupit në mënyrë që të kategorizojë ekspozimin në bazë të shkallës së rrezikut të humbjeve financiare, dhe të fokusojë Drejtimin në rreziqet aktuale të Grupit. Sistemi i kategorizimit të rrezikut përdoret për të përcaktuar se kur duhet të krijohen fonde për zhvlerësime të mundshme kundrejt ekspozimeve specifike ndaj rrezikut të kreditimit. Sistemi aktual i kategorizimit të rrezikut konsiston në dhjetë kategori të cilat reflektojnë shkallën e rrezikut të mospagimit dhe disponibilitetin e kolateraleve, ose lehtësime të tjera të rrezikut të kreditimit. Përgjegjësia për të caktuar nivelet e rrezikut është e niveleve që afrojnë kredinë. Kategoritë e rrezikut janë subjekt i vëzhgimeve nga Divizioni i Administrimit të Rrezikut të Kreditimit të Grupit.
- Monitorimin e zbatimit të kufijve të aprovuar të ekspozimit nga njësitë e biznesit, duke përfshirë dhe ato për industritë e zgjedhura, rrezikut të vendit dhe llojeve të produkteve. Divizioni i Administrimit të Rrezikut të Kredisë merr dhe shqyrton rregullisht raporte mbi cilësinë e kreditimit dhe ndërmerr veprime përkatëse korrigjuese.
- Sigurimin e këshillave, udhëzimeve dhe afësi të specializuara njësisë të biznesit për të zhvilluar praktikat më të mira për administrimin e rrezikut të kreditimit në të gjithë Grupin.

Çdo njësi biznesi duhet të zbatojë politikat dhe procedurat e Grupit për administrimin e rrezikut të kreditimit. Kontrolli i brendshëm kryen në mënyrë të rregullt kontrolle ndaj njësisë të biznesit dhe divizionit të administrimit të rrezikut.

(i) Investime në letra me vlerë

	Investime të mbajtura për tregtim		Investime të mbajtura deri në maturim	
	2010	2009	2010	2009
Pa vonesa dhe të pazhvlerësuar (klasifikimi për qëllime të brendshme)				
Klasifikimi i vendit: B4	38,668,174	36,524,191	95,361,970	93,189,711
Vlera kontabël	38,668,174	36,524,191	95,361,970	93,189,711

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)

(ii) Hua dhe paradhënie klientëve

	Hua dhe paradhënie klientëve	
	2010	2009
Të zhvlerësuar individualisht		
Shkalla 5: Të zhvlerësuara	13,756,492	8,432,858
Vlera Bruto	13,756,492	8,432,858
Provigjon për zhvlerësim	(7,371,477)	(4,649,622)
Vlera kontabël (A)	6,385,015	3,783,236
Provigjone për humbjet bazuar në portofol		
Shoqëritë		
Shkalla 1	1,779,924	4,222,480
Shkalla 1.5	2,455,105	3,850,042
Shkalla 2	6,996,709	6,872,231
Shkalla 2.5	6,159,445	4,479,439
Shkalla 3	8,883,553	8,617,462
Shkalla 3.5	27,622,333	18,579,786
Shkalla 4	10,996,767	10,057,152
Shkalla 4.5	5,662,388	6,193,412
Shkalla 5 (pa klasifikuar)	3,094,198	2,587,918
	73,650,422	65,459,922
Individë	20,269,831	20,384,531
Vlera bruto	93,920,253	85,844,453
Provigjon për zhvlerësim	(1,906,837)	(1,299,049)
Vlera kontabël (B)	92,013,416	84,545,404
<i>Me vonesë por jo të zhvlerësuara përfshin:</i>		
30-60 ditë:	4,062,973	1,445,842
60-180 ditë:	5,920,829	1,469,885
Vlera kontabël	9,983,802	2,915,727
Vlera kontabël Totale (A+B)	98,398,431	88,328,640

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuara

Hua dhe letra me vlerë të zhvlerësuara janë ato hua dhe letra me vlerë për të cilat Grupi ka përcaktuar se është e mundur që mos të arketojë të gjithë shumën e interesit dhe principalit të huasë në bazë të kushteve të kontratës. Këto hua vlerësohen me shkallën 0.5 deri në 5 në sistemin e brendshëm të kategorizimit të rrezikut.

Hua me vonesë por jo të zhvlerësuara

Hua dhe letra me vlerë ku pagesat e interesit janë me vonesë por që Grupi beson se zhvlerësimi nuk është i përshtatshëm për shkak të shkallës së garancive / kolateralit të vlefshëm dhe /ose shkallës së arkëtimit të shumës së huasë.

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)

Hua me kushte të rinegociueshme

Hua me kushte të rinegociueshme janë hua të cilat janë ristrukturuar për shkak të përkeqësimit të situatës financiare të klientit dhe kur Grupi ka bërë lëshime të cilat nuk do ti bënte në rast të kundërt. Pasi huaja është ristrukturuar, qëndron në të njëjtën kategori, edhe pse performanca pas ristrukturimit mund të përmirësohet.

Fondi për zhvlerësim

Grupi vendos një provigjon për humbjet nga zhvlerësimet që përfaqëson vlerësimin e Grupit për humbjet e ndodhura të portofolit. Përbërësit kryesorë të këtij provigjoni janë, një komponent për humbjet specifike që lidhet me ekspozimet e konsiderueshme individuale, dhe një provigjon i përgjithshëm për grupet e aktiveve të ngjashme në lidhje me humbjet e realizuara por që nuk janë identifikuar në huatë që janë subjekt i vlerësimit individual për zhvlerësime.

Politikat e nxjerrjes jashtë përdorimit

Grupi nxjerr jashtë përdorimi një hua/letër me vlerë (dhe çdo provigjon për humbjet nga zhvlerësimi) kur Komiteti i Kredive me probleme të Grupit vendos që huatë/ letrat me vlerë janë të pa-arkëtueshme. Ky përcaktim arrihet pasi janë marrë në konsideratë informacione si ndodhia e ngjarjeve të konsiderueshme të cilat kanë ndikuar në gjendjen financiare të huamarrësit në mënyrë të tillë që ai nuk është në gjendje të paguajë detyrimin, ose të ardhurat nga ekzekutimi i kolateralit nuk do të jenë të mjaftueshme për të mbuluar ekspozimin total.

Më poshtë është paraqitur analiza e shumave neto dhe bruto (e provigjoneve për zhvlerësim) të aktiveve individualisht të zhvlerësuara, sipas shkallës së rikut.

Hua dhe paradhënie klientëve		
	Bruto	Neto
31 Dhjetor 2010		
<i>Individualisht të zhvlerësuara</i>		
Shkalla 5: Të zhvlerësuara	13,756,492	6,385,015
Totali	13,756,492	6,385,015
31 Dhjetor 2009		
<i>Individualisht të zhvlerësuara</i>		
Shkalla 5: Të zhvlerësuara	8,432,858	3,783,236
Totali	8,432,858	3,783,236

Grupi mban kolaterale për huatë dhe paradhëniet klientëve në formën e hipotekave për pasuritë, letra të tjera me vlerë të bllokuara dhe garanci. Vlerësimet e vlerave të drejta bazohen në vlerën e kolateralit në kohën kur merret huaja, dhe në përgjithësi nuk ndryshohen përveç rasteve kur huaja zhvlerësohet individualisht. Për huatë që u jepen bankave të tjera nuk mbahet kolateral, përveç rasteve kur letra me vlerë mbahen si pjesë e riblerjeve të anasjellta dhe aktivitetit huamarrës të letrave me vlerë. Në përgjithësi nuk mbahet kolateral për investimet në letra me vlerë, dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2010 dhe 31 dhjetor 2009 nuk është mbajtur një kolateral i tillë.

	2010		2009	
	Kundrejt zhvlerësimeve individuale	Kundrejt zhvlerësimeve kolektive	Totali	Totali
Prona	4,443,184	26,102,308	30,545,492	27,718,309
Peng	1,918,276	14,357,129	16,275,405	12,778,747
Para	503	1,463,979	1,464,482	2,166,305
Garanci	-	5,605,221	5,605,221	5,267,365
Totali	6,361,963	47,528,637	53,890,600	47,930,726

5. ADMINISTRIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Rreziku i kreditimit (vazhdim)

Minimumi i pagesave të qirasë

Qiraja financiare paraqitet sëbashku me hua dhe paradhënie klientëve. Më poshtë paraqitet një rakordim i investimit bruto me vlerën aktuale të minimumit të pagesave të qirasë:

	Qira Financiare	
	2010	2009
Investimi bruto	4,376,787	3,958,921
Të ardhura financiare të perealizuara	(460,328)	(524,793)
	3,916,459	3,434,128

Rreziku i vendosjes

Aktivitetet e Grupit mund të shkaktojnë risk në momentin e realizimit të transaksioneve. Rreziku i vendosjes është rreziku i humbjeve për shkak të dështimit të një shoqërie në përmbushjen e detyrimeve të saj në para, letra me vlerë ose aktive të tjera ashtu siç është rënë dakord në kontratë.

Në "Të ardhura të tjera" përfshihen të ardhurat nga shitja e aktiveve të qëndrueshme në shumën 14,754 mijë Lek (2009: 108,516 mijë Lek). Në "Shpenzime të tjera" përfshihet: nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të qëndrueshme në shumën prej 9,058 mijë Lek (2009: 16,757 mijë Lek) dhe taksa të tjera përveç tatimit mbi fitimin në shumën prej 25,321 mijë Lek (2009: 16,443 mijë Lek).

29. PRIMI I SIGURIMIT TË DEPOZITAVE

Duke filluar nga 18 tetori 2002 legjislacioni ka përcaktuar se bankat duhet të paguajnë një prim për sigurimin e depozitave. Primi bazohet në normën 0.5% në vit, e pagueshme çdo 3-mujor dhe llogaritet si përqindje mbi balancat mesatare ditore të depozitave deri në 2,500,000 Lek (2009: 2,500,000 Lek) për individët, për periudhën nga Tetori deri në Dhjetor të vitit të mëparshëm.

30. SHPENZIME PËR PERSONELIN

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Pagat	1,751,581	1,457,380
Sigurimet shoqërore	202,325	195,388
Shpenzime për trainimin e personelit	39,341	38,007
Kosto të tjera të personelit	47,574	35,762
Totali	2,040,820	1,726,537

Më 31 Dhjetor 2010, Grupi ka 1,401 punonjës (2009: 1,389 punonjës).

31. SHPENZIME TË PËRGJITHSHME ADMINISTRATIVE

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Shpenzime për zyrat	431,378	343,904
Shpenzime për IT	355,715	343,407
Shpenzime marketingu	289,466	263,894
Tarifa konsulence dhe ligjore	166,251	251,918
Shpenzime të ndryshme administrative	135,614	100,512
Shpenzime për komunikim	60,424	64,806
Shpenzime për kancelari	54,320	55,932
Shpenzime për makinat	34,695	33,925
Shpenzime sigurie	25,900	25,570
Shpenzime udhëtimi	24,014	19,316
Totali	1,577,777	1,503,184

Në "Tarifa konsulence dhe ligjore" përfshihet edhe tarifa e administrimit të zyrës qendrore, që arrin në shifrën 76,150 mijë Lek në 2010 (2009: 210,859 mijë Lek).

32. TATIMI MBI FITIMIN

Tatimi mbi fitimin në Shqipëri matet me 10% (2009: 10%) të të ardhurave të tatueshme.

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2010	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor 2009
Tatimi aktual	761,939	512,515
Tatimi i shtyrë	(67,867)	34,541
Totali	694,072	547,056

Më poshtë paraqitet rakordimi i tatimit i llogaritur me normën e aplikueshme të tatimit me fitimin kontabël.

	Viti i mbyllur më 31 Dhjetor			
	Norma e taksës	2010	Norma e taksës	2009
Fitimi para tatimit		6,055,051		5,240,963
Tatimi i llogaritur me 10% (2009: 10%)	10.0%	605,505	10.0%	524,096
Shpenzime të pazbritshme	0.5%	88,567	0.5%	22,960
Diferenca kohore që nuk janë njohur	0.0%	-	0.0%	-
Zbritje në normën e tatimit	-	-	-	-
Tatim Fitimi	10.5%	694,072	10.5%	547,056

33. ANGAZHIME DHE DETYRIME TË MUNDSHME

	31 Dhjetor 2010			31 Dhjetor 2009
	Lek	Monedhë e huaj	Totali	Totali
<i>Detyrime të mundshme</i>				
Garanci bankare të lëshuara	763,441	3,826,783	4,590,224	3,449,141
Letër kredi	109,807	376,020	485,827	635,154
Linja të papërdorura krediti	3,938,304	3,667,703	7,606,007	6,621,470
Detyrime qera financiare		3,960	3,960	38,692
Çështje gjyqësore	43,005	-	43,005	3,829
Totali	4,854,557	7,874,466	12,729,023	10,748,286
<i>Angazhime (Aktive)</i>				
Garanci bankare të marra	22,298	2,629,863	2,652,161	2,807,571
Angazhime për qeratë operative	147,086	551,453	698,540	440,767
Totali	169,384	3,181,316	3,350,700	3,248,338

Pjesa më e madhe e garancive bankare dhe letër kredive të mësipërme janë për periudha kohore më pak se një vit, dhe kolateralizohen nga depozitat e bllokuara të klientëve.

Çështjet gjyqësore

Më 31 dhjetor 2010 dhe 31 dhjetor 2009 Grupi paraqitet i përfshirë në pretendime dhe procese gjyqësore të cilat konsiderohen të një natyre normale për aktivitetin e tij. Shkalla e këtyre pretendimeve dhe proceseve gjyqësore korrespondon me shkallën e pretendimeve dhe proceseve gjyqësore gjatë vitit të kaluar. Drejtimi i Grupit është i mendimit se Grupi nuk do të pësojë humbje materiale si rezultat i çështjeve ligjore pezull më 31 dhjetor 2010 dhe më 31 dhjetor 2009.

Angazhimet për qiratë

Grupi ka hyrë në angazhime të pakthyeshme qiraje për Drejtorinë e Përgjithshme dhe degët. Angazhime të tilla më 31 dhjetor 2010 dhe 31 dhjetor 2009 janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Jo më vonë se 1 vit	222,480	207,716
Më vonë se 1 vit dhe jo më vonë se 5 vjet	476,060	233,051
Totali	698,540	440,767

34. PALËT E LIDHURA

Kompania mëmë dhe filialet e tyre

Grupi është palë e lidhur me Raiffeisen Bank International AG, Raiffeisen Zentralbank Österreich Aktiengesellschaft (RZB AG), dhe me filialet e tyre.

Vlerat agregate të transaksioneve të kryera me këto entitete dhe balancat e mbetura janë si më poshtë:

	31 Dhjetor 2010	31 Dhjetor 2009
Detyrime nga:		
RZB AG	-	630,454
Raiffeisen Bank Bulgaria Ead	-	575
Raiffeisen Bank International AG	2,679,404	-
Raiffeisen Bank Kosovo	4,585	-
Raiffeisen Bank Budapest	-	19
Aktive total	2,683,989	631,048
Detyrime ndaj:		
RZB AG	-	(375,651)
Raiffeisen Bank International AG	(410,195)	-
Raiffeisen Bank Kosovo	-	(152,428)
Detyrime total	(410,195)	(528,079)

Vlera agregate e detyrimeve të mundshme të Grupit ndaj shoqërive të lidhura është 1,100,442 mijë Lek më 31 dhjetor 2010 (31 dhjetor 2009: 1,228,113 mijë Lek) dhe përfaqëson garanci bankare dhe letra të kredisë.

	2010	2009
Të ardhura nga interesat, neto		
RZB AG	-	3,002
Raiffeisen Bank International AG	(3,611)	-
Raiffeisen Bank Bulgaria Ead	-	2
Raiffeisen Leasing Bulgaria Ood	-	1,474
Raiffeisen Bank Kosovo	37	(26,871)
Raiffeisen Factoring Ltd., Sofia (BG)	-	20,233
Të ardhura nga komisionet, neto		
RZB AG	(13,300)	(9,891)
Raiffeisen Bank International AG	816	-
Raiffeisen Bank d.d. Bosna i Hercegovina	(5)	-
Raiffeisen Bank Kosovo	(10)	-
Raiffeisen Bank Bulgaria Ead	(29,614)	(16)
Tatra Banka	(54,766)	(15,092)
Ukrainian Processing Center	(66,253)	(51,298)
Regional Card Processing Centre,s.r.o	(13,300)	(62,779)
Fitimi neto nga tregtimi		
Raiffeisen Bank Zrt., 1054 Budapest (H)	-	70,632
Blerje aktivesh dhe shpenzime administrative		
RZB AG	(36)	(2,820)
Raiffeisen Bank International AG	(193,568)	-
Raiffeisen International AG	-	(377,561)
Tatra Banka	(2,397)	(1,964)
RSC Raiffeisen Daten Service Center GmbH	(273)	(263)
Centralised Raiffeisen International Services & Payments S.R.L.	(10,807)	-
Raiffeisen Leasing International G. m.b.H	(1,568)	(660)
Transaksionet neto	(388,655)	(453,872)

34. PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Administratorët

Vlerat agregate të transaksioneve dhe balancave në fund të vitit lidhur me administratorët janë si më poshtë:

	2010	2009
Pasqyra e pozicionit financiar		
Detyrimet nga administratorët	81,977	85,135
Detyrimet ndaj administratorëve	(15,508)	(45,935)
Balancat neto nga administratorët	66,469	39,200
Shpenzime		
Pagat, rroga fikse, shpërblimet	(169,060)	(181,636)
Totali	(169,060)	(181,636)

Filiali

Banka zotëron 75% të aksioneve të Raiffeisen Leasing sh.a. Rrjedhimisht, Banka e konsolidon këtë filial. Banka zotëron 100% të aksioneve të Raiffeisen Pensions sh.a. Rrjedhimisht, Banka e konsolidon këtë filial.

35. NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Më 8 mars 2011 Këshilli Mbikëqyrës i Raiffeisen Bank sh.a. aprovoi pasqyrat financiare të konsoliduara dhe të veçanta për vitin 2010 dhe shpërndarjen e fitimit pas tatimit të vitit si më poshtë:

	Vlera në '000 LEK
a) Shpërndarje dividendi aksionerit të vetëm	4,512,000
b) Transferim në fitime të mbartura	1,270,659
	5,782,659

Gjithashtu u aprovua transferimi nga fitimi i mbartur në të tjera rezerva si më poshtë:

	Vlera në '000 LEK
a) Transferim në rezerva të tjera	3,500,000

Në janar 2011 hyn në fuqi ligji nr 10364, datë 16.12.2010 i cili ndryshoi nenin 25 "Rezervat speciale për bankat dhe shoqëritë e sigurimit" të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar". Sipas ligjit të ri në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të bankave janë shpenzime të njohura provizionet e bankave, të krijuara në përputhje me standardet e hartuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe të certifikuara pa vërejtje nga auditues të jashtëm, por, në çdo rast, pa tejkalluar masën e përcaktuar në rregullat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim. Shumat e rimarra nga këto rezerva apo provizione i shtohen fitimit të tatueshëm.

Ky ndryshim në ligj nuk ka efekt në rezultatin financiar të vitit 2010 pasi provigjionet e njohura në përputhje me SNRF nuk tejkalojnë masën e përcaktuar në rregullat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim, megjithatë ligji mund të ndikojë në fitimin e tatueshëm të viteve të mëpasshme nëse provigjioni i njohur në përputhje me SNRF tejkallon masën e përcaktuar në rregullat e Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim.

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme pas datës së raportimit që kërkojnë rregullim apo prezantim në pasqyrat financiare të konsoliduara.





Golemi ndodhet në Kavajë. Është një plazh mjaft tërheqës për turistët gjatë muajve të nxehtë të verës, me plazhe të gjata me rërë dhe një vijë të mrekullueshme bregdetare. Pishat i japin pamje ekzotike dhe të freskët këtij plazhi, duke ndihmuar pushuesit me hijen natyrale përgjatë gjithë ditës. Pozicioni gjeografik i Golemit, shumë pranë kryeqytetit të Shqipërisë, e bën edhe më tërheqës plazhin për fundjavat me diell në dimër.

Raiffeisen Leasing

Raiffeisen Leasing mbetet lideri kryesor në tregun e lizingut në Shqipëri. Aktiviteti i Kompanisë është të sigurojë financimin e asetëve nëpërmjet lizing-ut financiar. Në vitin 2010, e gjithë industria e investimeve u përball me sfida të mëdha, por gjithsesi për Raiffeisen Leasing ka qënë një tjetër vit rritjeje, me një rritje prej më shumë se 13 përqind në total aktivesh dhe vlera totale e financimit ka arritur deri në 12.1 milionë Euro.

Të gjithë produktet e lizingut i janë ofruar segmenteve të biznesit si Korporatat dhe bizneset e mesme, ndërkohë që individët e përdorin kryesisht për makina personale. Rritja e klientelës, kreativiteti dhe produktet të fokusuar për klientët, fitimi i qëndrueshëm, raporti konkurrues i shpenzime/ të ardhura na vendosin në një pozicion shumë të mirë për t'u zgjeruar më tej si lider në tregun e lizingut në Shqipëri.

Portofoli ynë përfshin produkte të ndryshme lizing-u duke filluar nga autoveturat deri tek makineritë e rënda, pajisjet dhe linjat e reja teknologjike. Një fokus të veçantë në vitin 2010 ka qënë financimi i autobusëve urban në qytetin e Tiranës, si një nga kërkesat e bashkisë së këtij qyteti për rritjen e standarteve të mjeteve për transportin publik. Makineritë e ndërtimit vazhdojnë të mbeten në objektivat tona, pamvarësisht faktit që viti që kaluam ka qënë shumë i vështirë për këtë industri gjë që u reflektua edhe në kërkesën shumë të ulët të këtij sektori në investimet për mjete dhe makineri të reja. Gjithsesi, pjesa më e madhe e portofolit është përqëndruar pikërisht në këtë segment, ku Raiffeisen Leasing është edhe lider i padiskutueshëm.

Pjesë e aktivitetit tonë është edhe rimarketimi e rishitja e mjeteve. Përsa i përket rishitjes kemi implementuar procedura që na kanë pozicionuar si ekspert për vendosjen e standarteve në treg. Gjithsesi kompania ka përdorur njohuritë dhe eksperiencën e Raiffeisen Leasing International si dhe të kompanive të tjera të lizing-ut që operojnë në rajon, lidhur me produktet dhe shërbimet e qirasë financiare, si dhe në fushën e marketingut. Për më tepër, kompania ka akses të plotë në rrjetin e madh të furnitorëve ndërkombëtarë të makinave me tonazh të rëndë, makinerive dhe paisjeve, me të cilat Grupi Raiffeisen ka lidhje të qëndrueshme, në dobi të klientëve ekzistues dhe potencialë të kompanisë për realizimin e planeve të tyre investuese.

Më 10 Qershor 2010 hyri në fuqi Rregullorja "Për Administrimin e Rrezikut në veprimtarinë e Subjekteve Financiare Jo-Banka". Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e subjekteve financiare jobanka, ku përfshihet dhe aktiviteti i qirasë financiare, sipas së cilës kompania mban në kontroll ekspozimet e mëdha kundrejt kapitalit të vet.

Në dhjetor 2010 Raiffeisen Leasing finalizoi procesin e dërgimit të portofolit të lizing-ut në Regjistrin e Kredive. Kjo do të ndihmojë në njohjen më të mirë të klientëve me probleme dhe rritjen e cilësisë së portofolit dhe fokusimin në financimin e klientëve cilësorë.

Punonjësit e kualifikuar në kompani janë themeli kryesor për zhvillimin e qëndrueshëm të Raiffeisen Leasing. Manaxhimi dëshiron të përfitoj nga ky oportunitet për t'i falenderuar për punën e bërë në interes të kompanisë dhe partnerëve të biznesit.

Raiffeisen Leasing publikon një gamë të gjerë materialesh si të printuar ashtu edhe në faqen e internetit www.raiffeisen-leasing.al. Gjatë vitit 2010, Raiffeisen Leasing SHA ka ndërmarrë fushata marketingu, kryesisht të bazuar dhe të koordinuar me politikat dhe aktivitetet e marketingut të konçesionerëve vendas si partnerët tanë kryesorë në biznes. Gjithashtu në qytete të ndryshme, në bashkëpunim me projektin e USAID – Zhvillimi i Sipërmarrjeve Konkurruese (industritë e targetuara – tekstile/veshje, riciklimi dhe teknologjia informative dhe komunikacioni) janë zhvilluar takime frytdhënëse me biznesin.

Raiffeisen Leasing SHA, themeluar në Prill të vitit 2006, është regjistruar në Regjistrin Tregtar me vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë numër 35733, datë 15.05.2006, me akcionerë Raiffeisen Bank SHA me 75 përqind të aksioneve dhe Raiffeisen Leasing International GmbH me 25% të aksioneve.

Perspektivat për vitin 2011

Objektivat për vitin 2011 janë vendosur dhe po kështu edhe strategjia për t'i arritur ato, të cilat i janë komunikuar të gjithë punonjësve si edhe funksioneve mbështetëse.

Kompania angazhohet të vazhdojë rritjen e saj në portofolin e qirasë financiare nëpërmjet financimit (lizing-ut) të mjeteve të lartpërmendura. Klientët tanë të synuar për financimin e autoveturave janë individët dhe bizneset, ndërsa përsa i përket financimit të makinave me tonazh të rëndë dhe paisjeve, ne do të vazhdojmë të fokusohemi tek korporatat dhe shoqëritë e mesme dhe të vogla.

Fakti që kompania është lideri në tregun e lizing-ut për vite me radhë është së pari si rezultat i shumë viteve eksepriencë dhe gamës së gjerë të aftësive për vlerësimin e klasave të ndryshme asetesh, por gjithashtu edhe përgjegjësia si partnere biznesi dhe duke patur këtë parasysh misioni ynë mbetet që Raiffeisen Leasing të jetë lider në tregun e qirasë financiare në Shqipëri duke ofruar një paketë të plotë të produkteve lizing, duke kënaqur plotësisht nevojat e klientëve dhe duke kontribuar në zhvillimin e ekonomisë shqiptare nëpërmjet financimit të teknologjisë së re dhe bashkëkohore, makinerive dhe paisjeve.

Në të ardhmen do të shtojmë fokusin në rritjen e penetrimit të klientët Paga+, dhe për këtë ne do të mbështetemi në rrjetin gjithpërfshirës të bankës Raiffeisen dhe gjithashtu nga vitet e eksperiencës që kemi fituar në treg.

Përmbushja e objektivave tona do të ketë si mbështetje të rëndësishme edhe marketingun intensiv, aktivitetin e shitjeve në mënyrë direkte dhe indirekte, si dhe rritjen e mëtejshme të burimeve njerëzore dhe kanaleve të shitjes si në Tiranë ashtu edhe në qytete të tjera të mëdha të vendit.

Perfeksionimi i cilësisë së shërbimit të Raiffeisen Leasing SHA, si dhe shpejtësia e procesimit dhe aprovimit, kanë dhënë efektin e tyre në rritjen e shpejtë të këtij biznesi. Klientët e kërkojnë lizing si një alternativë financiare për të blerë një makinë. Fillimisht është parashikueshmëria e pagesave, që përfshijnë edhe shërbimet e nevojshme që tërheqin jo vetëm individët por edhe bizneset për përdorimin e lizigut.

Raiffeisen Pensione

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen sh.a

I. Të dhëna rreth Fondit

Numri i anëtarëve në Fond u rrit nga 1,679 anëtarë në fund të vitit 2009 në 1,786 anëtarë në fund të vitit 2010. Vlera neto e aseteve të Fondit u rrit nga 53,215,538 lekë në fund të vitit 2009 në 66,261,587 lekë në fund të vitit 2010.

II. Krijimi dhe Drejtimi

A) Krijimi i Fondit

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen sh.a zotërohet 100% nga Raiffeisen Bank sh.a. Shoqëria e realizoi procesin e ri-licensimit brenda vitit 2010 duke qenë kështu e para dhe e vetmja shoqëri që do të ushtrojë aktivitetin në përputhje me kërkesat e Ligjit nr.10197 datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar". Ky ligj e përaftron shumë industrinë e pensioneve me standartet ndërkombëtare dhe ne jemi shumë krenarë që mund t'u ofrojmë klientëve tanë të gjitha përfitimet nga ky ligj. Liçenca e re është miratuar më datë 18 Tetor 2010 nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Shoqëria Administruese aktualisht ka nën administrimin e saj një fond i cili quhet "Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen". Ky Fond është miratuar dhe rregjistruar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare me vendimin nr. 107 datë 18 Tetor 2010. Objektiv i ynë është të arrijmë një kthim sa më të lartë të investimit afatgjatë pa rritur rrezikshmërinë.

B) Zhvillimet në kuadrin ligjor

Që nga data 15 Janar 2010 kur hyri në fuqi Ligji nr. 10197 datë 10.12.2009 "Për fondet e pensionit vullnetar", Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare të Shqipërisë ka miratuar 5 rregullore në zbatim të këtij ligji. Kuadri rregullativ vazhdon të plotësohet. Disa nga rregulloret e miratuara janë:

- Rregullore nr.1 datë 28.01.2010 "Për aktivet e lejuara, kufizimet dhe kufirin maksimal të investimit të fondit të pensionit"
- Rregullore nr.125, datë 07.12.2010 "Për penaltitetet e zbatuara në rastin e tërheqjes së parakohshme nga fondi i pensionit vullnetar"
- Rregullore nr.126, datë 7.12.2010 "Mbi mënyrat, kushtet dhe procedurat e pagesave të pensionit vullnetar"

C) Drejtimi i Shoqërisë

Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen sh.a, drejtohet nga Këshilli i Administrimit i përbërë nga 7 anëtarë, prej të cilëve 5 janë anëtare jo-ekzekutive, ndërsa dy janë anëtarë ekzekutiv.

Këshilli i Administrimit:

Anëtarët jo-ekzekutivë

Z. Damir Grbavac – Kryetar

Znj. Christa Bernbacher – Zv. Kryetare

Znj. Alda Shehu – anëtar

Znj. Mirela Boriçi – anëtar

Zj. Stela Gjinali – anëtar

Anëtarët ekzekutivë

Znj. Majlinda Gjata – Administratore e Përgjithshme

Zj. Gentiana Gjonça – Zv. Administratore e Përgjithshme

Z. Grbavac ka një eksperiencë të gjatë në sektorin bankar si dhe në fushën e menaxhimit të fondeve të pensionit. Ai është aktualisht President i Bordit të Administrimit të Fondeve të Pensioneve të Detyrueshme Raiffeisen në Kroaci.

Znj. Bernbacher është Drejtore Ekzekutive e Kompanisë Këshilluese të Fondeve Ndërkombëtare Raiffeisen.

Përfshirja dhe përkushtimi i Z. Grbavac dhe Znj. Bernbacher është një aset për shoqërinë tonë duke na sjellë eksperiencën të vlefshme nga vende si Austria dhe Kroacia.

Këshilli i Administrimit i Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen sh.a mbledhet të paktën tre herë në vit por mund të mbledhet edhe më shpesh sipas nevojave të biznesit.

Komiteti i Investimit, një tjetër organ i rëndësishëm, mbikëqyr të gjitha çështjet që kanë lidhje me investimet e aseteve. Ky Komitet i bën rekomandimet e duhura mbi mënyrat e Investimit Këshillit të Administrimit.

Gjatë vitit 2010, stafi i shoqërisë i kushtoi një rëndësi të veçantë hartimit të politikave të mëposhtme:

-Politika e Menaxhimit të Riskut;

-Politika dhe Strategjia e Investimeve;
 -Politika mbi Delegimin e Funksioneve të Shoqërisë Administruese.

Çdo proces është në përputhshmëri të plotë me misionin tonë për t'u siguruar klientëve tanë të ardhura të mjaftueshme në kohën e pensionit.

III. Menaxhimi i Riskut

Këshilli i Administrimit ka përgjegjësi të plotë për mbarevajtjen e kontrolleve të brendshme si dhe proceseve të menaxhimit të riskut. Këshilli i Administrimit është duke punuar me shumë rigorizitet për të identifikuar, vlerësuar dhe manaxhuar të gjitha llojet e risqeve. Këshilli i Administrimit është angazhuar për implementimin e të gjitha procedurave të nevojshme për mbajtjen nën kontroll dhe uljen e risqeve deri në një nivel të pranueshëm.

Përfaqsa e Shoqërisë Administruese të Fondeve të Pensionit Raiffeisen është që risku nuk mund të eliminohet por mund të manaxhohet.

Përsa i përket riskut që rrjedh nga investimi i aseteve, Komiteti i Investimit i Shoqërisë ka përcaktuar saktë kufijtë maksimalë dhe minimalë për investimin në instrumenta të ndryshëm financiarë. Gjithashtu, Banka Kujdestare luan një rol të rëndësishëm për të garantuar që risqet që lidhen me aktivitetin e shoqërisë të jenë mbajtur në nivele të kënaqshme.

IV. Investimet


A) Strategjia e Investimeve

Strategjia e investimeve është fokusuar në dinamikën e optimizimit të performancës së fondit duke mbajtur parasysh riskun dhe kthimin nga investimi. Në këtë mënyrë ne synojmë të realizojmë një rritje të qëndrueshme të pozitës financiare të fondit duke mbajtur një pozicion sa më të minimizuar të mundshëm të riskut. Prandaj, forca kryesore drejtuese e strategjisë sonë mbetet eficaenca dhe siguria e fondeve të investuara, e cila përcakton horizontin e investimeve siç janë instrumentat pa risk, ose më saktë letrat me vlerë të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë me një afat një ose më shumë vjet. Ne synojmë të jemi lider në treg në ofrimin e produkteve me maksimumin e përfitimit për anëtarët e fondit të pensionit. Për vitin 2010, kthimi neto nga investimi ishte 6.89 përqind.

B) Struktura e investimeve

Më 31 Dhjetor, peshën kryesore të portofolit (rreth 74 përqind) e zënë Obligacionet me afat 7 vjeçar, të emetuara nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë. Kjo strategji investimesh vjen si rrjedhojë e normave të larta të interesit që ofrojnë letrat me vlerë afatgjata. Pjesa tjetër e portofolit përbëhet nga Obligacione me afat 3 vjeçar dhe Bono Thesari me afat 1 vjeçar.

Struktura e Portofolit, Dhjetor 2010



Objekti ynë në vitet që vijjnë është të diversifikojmë portofolin dhe të investojmë të paktën 5 përqind të tij në aksione dhe 10 përqind në letra me vlerë të garantuara nga Qeveritë e Shteteve Anëtare të Bashkimit Evropian, duke qenë gjithmonë të vëmendshëm mbi zhvillimet e tregut dhe duke u kujdesur për përmirësimin e performancës së portofolit.

C) Komiteti i Investimeve

Për të garantuar eficaencë në marrjen e vendimeve, Këshilli i Administrimit ka krijuar Komitetin e Investimit që monitoron dhe këshillon lidhur me çështjet e investimeve. Komiteti i Investimit mbikëqyr funksionin e drejtimit të investimeve dhe i bën rekomandimet përkatëse Këshillit të Administrimit, por ai nuk ka fuqi ekzekutive.

V. Banka Depozitare

Mbështetur në Ligjin nr.10197, datë 10.12.2009, "Për fondet e pensionit vullnetar", Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit Raiffeisen sh.a ka lidhur një marrëveshje të Depozitarit me Bankën e Parë të Investimeve të Shqipërisë sh.a. e cila është licënsuar nga dy autoritete rregullatore financiare, nga Banka e Shqipërisë dhe Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Në përputhje me standartet ndërkombëtare, letrat me vlerë janë regjistruar në emër të Fondit, anëtarët e të cilit gëzojnë pronësinë mbi to. Banka Depozitare i mban asetet, veprimet dhe dokumentat e fondit të pensionit rigorozisht të ndara nga asetet, veprimet dhe dokumentat e saj.

Raiffeisen Bank International një vështrim i shkurtër

Raiffeisen Bank SHA është filial i Raiffeisen Bank International AG (RBI), një lider absolut në sektorin bankar të Evropës Qendrore dhe Lindore dhe një nga ofruesit kryesor për korporatat dhe shërbimit të investimeve bankare në Austri. RBI ka origjinën nga bashkimi i qendrës së biznesit të Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB) me Raiffeisen International Bank-Holding AG. Ky bashkim përfundoi ligjërisht në Tetor 2010. RBI është një filial plotësisht i konsoliduar i RZB-së, e cila zotëron 78.5 përqind të aksioneve të zakonshme të bankës. Pjesa tjetër e aksioneve është në treg të lirë, me aksionet e listuara në bursën e Vjenës.

RBI ofron për korporatat dhe investitorët bankar të kompanive austriake dhe ndërkombëtare, një rrjet të gjerë bankar dhe lizing-ut në Evropën Qendrore dhe Lindore si për klientët korporatë ashtu edhe për individët, si edhe shërbime për korporatat dhe investitorët bankar në Azi dhe qendrat kryesore financiare në botë. Zgjerimi i grupit bankar ka shtrirë aktivitetin në tregjet e mëposhtme të Evropës Qendrore dhe Lindore:

• Shqipëri	Raiffeisen Bank SHA.
• Bjellorusi	Priorbank, OAO
• Bosnje dhe Hercegovinë	Raiffeisen Bank d.d. Bosna i Hercegovina
• Bullgari	Raiffeisenbank (Bulgaria) EAD
• Kroaci	Raiffeisenbank Austria d.d.
• Republika Çeke	Raiffeisenbank a.s.
• Hungari	Raiffeisen Bank Zrt.
• Kosovë	Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.
• Poloni	Raiffeisen Bank Polska S.A.
• Rumani	Raiffeisen Bank S.A.
• Rusi	ZAO Raiffeisenbank
• Serbi	Raiffeisen banka a.d.
• Sllovaki	Tatra banka, a.s.
• Slloveni	Raiffeisen Banka d.d.
• Ukrainë	VAT Raiffeisen Bank Aval

Raiffeisen International vepron si kompani drejtuese për këto banka, duke zotëruar pjesën më të madhe ose në të shumtën e rasteve 100 përqind të aksioneve. Veç kësaj, kompani të shumta financimi lizing (përfshirë dhe në Kazakistan dhe Moldavi) dhe ofrues të shërbimeve të tjera financiare, janë pjesë e grupit Raiffeisen Bank International.

Në Evropën Perëndimore dhe SHBA, RBI vepron me degën në Londër dhe zyrat përfaqësuese në Frankfurt, Madrid, Milano, Paris, Stokholm dhe Nju Jork. Kompania financiare në Nju Jork dhe banka në Maltë plotësojnë qëllimin e prezencës së bankës. Në Azi, fokusi dytësor gjeografik i grupit, RBI drejton degët në Pekin, Xiamen, Singapor, kompania financiare në Hong Kong, si dhe zyrat përfaqësuese në qytetin Ho Chi Minh, Hong Kong, Mumbai dhe Seul. Ky forcim i prezencës tregon qartë strategjinë tregëtare të grupit.

Në vijim të aktivitetit bankar, RBI drejton disa kompani të specializuara në Evropën Qendrore dhe Lindore që ofrojnë zgjidhje në disa fusha përfshirë, shit-blerje, investime, pasuri të paluatshme, menaxhim projektsh dhe menaxhim fondesh.

Angazhimi i vazhdueshëm i grupit RBI në cilësi reflektohet rregullisht nga disa çmime lokale dhe ndërkombëtare, duke përfshirë disa publikues lider në industrinë financiare si "The Banker", "Euromoney" dhe "Global Finance".

RZB dhe Grupi Bankar Austriak Raiffeisen

RBI është filial i RZB me qendër në Vjenë. I themeluar në vitin 1927, RZB është zotëruesi i aksioneve të të gjithë Grupit RZB dhe institutin qendror të grupit Austriak Raiffeisen Bank (RBG), grupi më i madh bankar në vend.

RBG përfaqëson pothuajse një të katërtën e të gjithë biznesit bankar në Austri dhe përfshin rrjetin më të madh bankar në vend, me më shumë se 550 banka të pavarura dhe 1,700 degë. Në fund të vitit 2009, bilanci total i konsoliduar i RBG ishte 260 miliard Euro. Struktura prej tre nivelesh e RBG konsiston në Banka Raiffeisen në nivel lokal, Banka Raiffeisen Rajonale dhe RZB si institucion qendror. Bankat Raiffeisen janë institucione private kooperative kreditimi që operojnë si banka që ofrojnë shërbime të përgjithshme për individë. Çdo bankë Raiffeisen e provincës është zotëruese e Bankës Raiffeisen Rajonale përkatëse, që në tërësi përbën pothuajse 88 përqind të aksioneve të zakonshme të RZB. Ideja kooperative në të cilën bazohet organizata Raiffeisen, reflekton parimet dhe punën e reformatorit social Gjerman Friedrich Wilhelm Raiffeisen (1818-1888).

Raiffeisen Bank International AG Raiffeisen Zentralbank Österreich AG

Am Stadtpark 9 Am Stadtpark 9

A-1030 Vienna A-1030 Vienna

Tel: +43-1-71 707-0

Tel: +43-1-26 216-0

Fax: +43-1-71 707-1715

Fax: +43-1-26 216-1715

www.rbinternational.com

www.rzb.at





Dukagjini: Zona e Dukagjinit në Shqipërinë veriore është një nga zonat e fundit malore ende të paeksploruara në Evropë. E megjithatë, një udhëtim në zemrën e vendit malor e çon vizitorin në një botë me bukuri goditëse, me rregulla arkaike dhe një shije të vërtetë aventurë. Në Dukagjin, vetëm mikëpritja ja kalon krenarisë së vendasve. Do të futeni në një botë që nuk është e hapur për të gjithë, ama do të takoni nga njerëzit më të dashur dhe krenarë, do të shihni natyrë me bukuri të papërshkrueshme dhe do të ecni në rrugë të pashkelura nga njerëzit.

Rrjeti i Raiffeisen Bank SHA

Distrikti Tirana 1

"Rruga e Kavajës" Tiranë

Tel: ++355 4 2253 644/6;
++355 4 2233 396;
++355 4 2224 540
Fax: ++355 4 2230 013;
++355 4 2247 912

Distrikti Tirana 2

Kompleksi "Gintash" Laprakë, Tiranë

Tel: ++355 4 2357828

Distrikti Perëndimor

L. 4, Rr. "Skënderbej", P. 915, Durrës

Tel: ++355 52 254 95;
++355 52 25 027

L. "28 Nëntori", Berat

Tel: ++355 32 32628

Distrikti Jug perëndimor

L. "Kastrioti", Rr. "Brigada e 11 Sulmuese", Fier

Tel: ++355 34 22231;
++355 34 22282;
++355 34 22502

Distrikti Jugor

L. "11 Janari" (Qafa e Pazarit), Gjirokastrë

Tel: ++ 355 84 682 86
++ 355 84 625 97

Distrikti Verior

L. "Vasil Shanto", Rr. "Çajupi",
Hotel Rozafa, Shkodër

Tel: ++355 22 43171;
++355 22 43764

L. 5, Kukës

Tel: ++355 24 22279

Distrikti Elbasan

Bldv "Rinia", Elbasan

L. "Luigj Gurakuqi", P.18

Tel: ++355 54 42260

Distrikti Korçë

Shëtitore "Fan Noli", Sky Center, Korçë

Tel: ++355 82 43179
Fax: ++355 82 45870

Ju lutem vizitoni web sit-in tonë: www.raiffeisen.al

Adresa dhe Kontakte

Raiffeisen Bank International AG

Austri
Am Stadtpark 9
1030 Vienna
Tel: +43-1-71707 0
Fax: +43-1-71707 1715
www.rbinternational.com
ir@rbinternational.com
rbi-pr@rbinternational.com

Rrjeti Bankar

Shqipëri

Raiffeisen Bank Sh.a.
European Trade Center
Bulevardi "Bajram Curri"
Tirana
Tel: +355-4-238 1000
Fax: +355-4-2275 599
SWIFT/BIC: SGSBALTX
www.raiffeisen.al

Bjellorusi

Priorbank JSC
31A V. Khoruzhey
220002 Minsk
Tel: +375-17-289 9090
Fax: +375-17-289 9191
SWIFT/BIC: PJCBY2X
www.priorbank.by

Bosnje dhe Hercegovinë

Raiffeisen BANK d.d. Bosna i
Hercegovina
Zmaja od Bosne bb
71000 Sarajevo
Tel: +387-33-287 101
Fax: +387-33-213 851
SWIFT/BIC: RZBABA2S
www.raiffeisenbank.ba

Bullgari

Raiffeisenbank (Bulgaria) EAD
18/20 Ulica N. Gogol
1504 Sofia
Tel: +359-2-9198 5101
Fax: +359-2-943 4528
SWIFT/BIC: RZBBBGSF
www.rbb.bg

Kosovë

Raiffeisen Bank Kosovo J.S.C.
Rruga UÇK, No. 51
10000 Pristina
Tel: +381-38-222 222
Fax: +381-38-2030 1130
SWIFT/BIC: RBKORS22
www.raiffeisen-kosovo.com

Kroaci

Raiffeisenbank Austria d.d.
Petrinjska 59
10000 Zagreb
Tel: +385-1-456 6466
Fax: +385-1-481 1624
SWIFT/BIC: RZBHHR2X
www.rba.hr

Poloni

Raiffeisen Bank Polska S.A.
Ul. Piękna 20
00-549 Warsaw
Tel: +48-22-585 2001
Fax: +48-22-585 2585
SWIFT/BIC: RCBWPLPW
www.raiffeisen.pl

Rumani

Raiffeisen Bank S.A.
Piata Charles de Gaulle 15
011857 Bucharest 1
Tel: +40-21-306 1000
Fax: +40-21-230 0700
SWIFT/BIC: RZBRROBU
www.raiffeisen.ro

Rusi

ZAO Raiffeisenbank
Smolenskaya-Sennaya sq., 28
119002 Moscow
Tel: +7-495-721 9900
Fax: +7-495-721 9901
SWIFT/BIC: RZBMRUMM
www.raiffeisen.ru

Serbi

Raiffeisen banka a.d.
Bulevar Zorana Djindjića 64a
11070 Novi Beograd
Tel: +381-11-320 2100
Fax: +381-11-220 7080
SWIFT/BIC: RZBSRSBG
www.raiffeisenbank.rs

Slovaki

Tatra banka, a.s.
Hodžovo námestie 3
81106 Bratislava 1
Tel: +421-2-5919 1111
Fax: +421-2-5919 1110
SWIFT/BIC: TATRKBX
www.tatrabanka.sk

Sloveni

Raiffeisen Banka d.d.
Zagrebska cesta 76
2000 Maribor
Tel: +386-2-229 3100
Fax: +386-2-303 442
SWIFT/BIC: KREKSI22
www.raiffeisen.si

Republika Çeke

Raiffeisenbank a.s.
Hvezdova 1716/2b
14078 Prague 4
Tel: + 420-221-141 111
Fax: +420-221-142 111
SWIFT/BIC: RZBCCZPP
www.rb.cz

Ukrainë

Raiffeisen Bank Aval JSC
Vul Leskova, 9
01011 Kiev
Tel: +38-044-490 8888
Fax: +38-044-285 3231
SWIFT/BIC: AVALUAUK
www.aval.ua

Hungari

Raiffeisen Bank Zrt.
Akadémia utca 6
1054 Budapest
Tel: +36-1-484 4400
Fax: +36-1-484 4444
SWIFT/BIC: UBRTHUHB
www.raiffeisen.hu

Kompani Lizingu

Austri

Raiffeisen-Leasing International
GmbH
Am Stadtpark 3
1030 Vienna
Tel: +43-1-71707 2966
Fax: +43-1-71707 2059
www.rli.co.at

Shqipëri

Raiffeisen Leasing Sh.a.
Rruga Kavajës 44
Tirana
Tel: +355-4-2274 920
Fax: +355-4-2232 524
www.raiffeisen-leasing.al

Bjellorusi

JLLC Raiffeisen Leasing
31A V. Khoruzhey
220002 Minsk
Tel: +375-17-289 9394
Fax: +375-17-289 9394
www.rl.by

Bosnja dhe Hercegovina

Raiffeisen Leasing d.o.o. Sarajevo
Zmaja od Bosne bb, Building B
71000 Sarajevo
Tel: +387-33-254 354
Fax: +387-33-212 273
www.rlbh.ba

Bullgari

Raiffeisen Leasing Bulgaria OOD
Business Park Sofia
Building 7B, 4th floor
1766 Sofia
Tel: +359-2-491 9191
Fax: +359-2-974 2057
www.rlbh.bg

Kazakistan

Raiffeisen Leasing Kazakhstan LLP
146, Shevchenko St., Flat 1
050008 Almaty
Tel: +7-727-3785 430
Fax: +7-727-3785 447
www.rlkz.kz

Kosovë

Raiffeisen Leasing Kosovo
Str. Agim Ramadani, No. 15
10000 Pristina
Tel: +381-38-2222 22
Fax: +381-38-2030 3011

Kroaci

Raiffeisen Leasing d.o.o.
Radnicka cesta 43
10000 Zagreb
Tel: +385-1-6595 000
Fax: +385-1-6595 050
www.rl-hr.hr

Moldavi

ICS Raiffeisen Leasing SRL
51 Alexandru cel Bun
2012 Chi in u
Tel: +373-22-2793 13
Fax: +373-22-2283 81
www.raiffeisen-leasing.md

Poloni

Raiffeisen-Leasing Polska S.A.
Ul. Prosta 51
00-838 Warsaw
Tel: +48-22-3263 600
Fax: +48-22-3263 601
www.rl.com.pl

Rumani

Raiffeisen Leasing IFN S.A .
Nusco Tower
Sos Pipera nr 42, Etaj 1A
020112 Sector 2, Bucharest
Tel: +40-21-306 9696
Fax: +40-37-287 9988
www.raiffeisen-leasing.ro

Rusi

ООО Raiffeisen Leasing
Stanislavskogo St. 21/1
109004 Moscow
Tel: +7-495-721 9980
Fax: +7-495-721 9572
www.rlr.ru

Serbi

Raiffeisen Leasing d.o.o.
Milutina Milankovi a 134a
11070 Novi Beograd
Tel: +381 11 2017700
Fax: +381 11 7130081
www.raiffeisen-leasing.rs

Slovaki

Tatra Leasing s.r.o.
Hodžovo námestie 3
81106 Bratislava 1
Tel: +421-2-5919 3168
Fax: +421-2-5919 3048
www.tatraleasing.sk

Siloveni

Raiffeisen Leasing d.o.o.
Tivolska 30 (Center Tivoli)
1000 Ljubljana
Tel: +386-1-241 6250
Fax: +386-1-241 6268
www.rl-sl.com

Republika Çeke

Raiffeisen-Leasing s.r.o.
Hvezdova 1716/2b
14078 Prague 4
Tel: +420-221-5116 11
Fax: +420-221-5116 66
www.rl.cz

Ukrainë

LLC Raiffeisen Leasing Aval
Moskovskiy Prospect, 9
Corp. 5 Office 101
04073 Kiev
Tel: +38-044-590 2490
Fax: + 38-044-200 0408
www.rla.com.ua

Hungari

Raiffeisen Lizing Zrt.
Hungaria krt. 40-44
1087 Budapest
Tel: +36-1-298 8000
Fax: +36-1-298 8010
www.raiffeisenlizing.hu

Kompani Leazingu për Pasuritë e
Paluajtshme

Republika Çeke

Raiffeisen Leasing Real Estate s.r.o.
Hvezdova 1716/2b
14078 Prague 4
Tel: +420-2-215116 10
Fax: +420-2-215116 41
www.realestateleasing.cz

Zyrat e përfaqësimit në Evropë

Gjermani

Zyra përfaqësuese e RBI në Fankfurt
Mainzer Landstrasse 51
60329 Frankfurt am Main
Tel: +49-69-2992 1918
Fax: +49-69-2992 1922

Francë

Zyra përfaqësuese e RBI në Paris
9-11, Avenue Franklin D. Roosevelt
75008 Paris
Tel: +33-1-4561 2700
Fax: +33-1-4561 1606

Mbretëria e Bashkuar

Dega e RBI në Londër
10, King William Street
London EC4N 7TW
Tel: +44-20-7929 2288
Fax: +44-20-7933 8099

Itali

Zyra përfaqësuese e RBI në Milano
Via Andrea Costa 2
20131 Milan
Tel: +39-02-2804 0646
Fax: +39-02-2804 0658

Rusi

Zyra përfaqësuese e RBI në Moskë
Smolenskaya-Sennaya sq., 28
119002 Moscow
Tel: +7-495-721 9905
Fax: +7-495-721 9907

Suedi

Zyra përfaqësuese e RBI në Vendet
Nordike
Drottninggatan 89
P.O. Box 3294
10365 Stockholm
Tel: +46-8-440 5086
Fax: +46-8-440 5089

Spanjë

RBI Representative Office Madrid
Príncipe de Vergara 11, 4^oC
28001 Madrid
Tel: +34-91-431 6536
Fax: +34-91-431 8772

Zyrat e përfaqësimit në Azi dhe Amerikë

Kina

Dega e RBI në Pekin
Beijing International Club 200 2nd floor
Jianguomenwai Dajie 21
100020 Beijing
Tel: +86-10-653 23388
Fax: +86-10-653 25926

Zyra përfaqësuese e RBI në Hong Kong

Unit 2106-08, 21st Floor,
Tower One, Lippo Centre
89 Queensway, Hong Kong
Tel: +85-2-2730 2112
Fax: +85-2-2730 6028

Dega e RBI në Xiamen
Unit 01-02, 32/F, Zhongmin Building
No. 72 Hubin North Road
Xiamen
Fujian Province
361012 China
Tel: +86-592-2623 988
Fax: +86-592-2623 998

Indi

Zyra përfaqësuese e RBI në Mumbai
803, Peninsula Heights
C.D. Barfiwala Road, Andhere (W)
400 058 Mumbai
Tel: +91-22-2623 0657
Fax: +91-22-2624 4529

Korea

Zyra përfaqësuese e RBI në Kore
Leema Building, 8th floor
146-1, Soosong-dong
Chongro-ku
Seoul 110-755
Tel: +82-2-398 5840
Fax: +82-2-398 5807

Singapore

Dega e RBI në Singapor
One Raffles Quay
#38-01 North Tower
Singapore 048583
Tel: +65-6305 6000
Fax: +65-6305 6001

SHBA

RB International Finance (USA) LLC
1133, Avenue of the Americas, 16th Floor
10036 New York
Tel: +01-212-845 4100
Fax: +01-212-944 2093
<http://usa.rbinternational.com>

Zyra përfaqësuese e RBI në Nju Jork

1133, Avenue of the Americas, 16th Floor
10036 New York
Tel: +01-212-593 7593
Fax: +01-212-593 9870

Vietnam

Zyra përfaqësuese e RBI në qytetin
Ho Chi Minh
6 Phung Khac Khoan Street,
Room G6
District 1, Ho Chi Minh City
Tel: +84-8-3829 7934
Fax: +84-8-3822 1318

Raiffeisen Zentralbank AG

Austri

Am Stadtpark 9
1030 Vienna
Tel: +43-1-26216 0
Fax: +43-1-26216 1715
www.rzb.at

Kompani të specializuara Raiffeisen

F.J. Elsner Trading Gesellschaft m.b.H.

Am Heumarkt 10
1030 Vienna
Tel: +43-1-79 736 0
Fax: +43-1-79 736 9142
www.elsner.at

Kathrein & Co. Privatgeschäftsbank Aktiengesellschaft

Wipplingerstraße 25
1010 Vienna
Tel: +43-1-53 451 269
Fax: +43-1-53 451 233
www.kathrein.at

Raiffeisen-Leasing International Gesellschaft m.b.H.

Am Stadtpark 3
1030 Vienna
Tel: +43-1-71707 2966
Fax: +43-1-71707 76 2966
www.rli.co.at

Fjalori Raiffeisen

Kryqi Gable

Logoja ndërkombëtare e Raiffeisen është Kryqi Gable. Ai është i formuar nga kryqëzimi i dy koka kuajsh dhe origjina e tij daton shekuj më parë në traditat folklorike evropiane. Ai është simbol i mbrojtjes nga e keqja dhe rreziqeve të jetës dhe mund të haset ende në shtëpitë rurale në Evropën Qendrore. Themeluesit kishin si objektiv mbrojtjen e anëtarëve të Raiffeisen-it ndaj rreziqeve ekonomike duke u bashkuar në një kooperativë dhe zgjodhën Kryqin Gable si emblemën e mbrojtjes nën çatinë e përbashkët. Logoja ka evoluar në një markë ndërkombëtare të mirënjohur dhe përdoret gjerësisht në botë.

Grupi Bankar Raiffeisen

Grupi Bankar Raiffeisen (RBG) është grupi më i madh bankar në Austri për nga totali i aktiveve. Bazuar në shifrat për fundvitin 2009, bilanci i konsoliduar i RBG në total arriti në 260 miliard Euro. Kjo përfaqëson rreth një të katërtën e të gjithë biznesit të brendshëm bankar dhe përbën rrjetin më të madh bankar me afërsisht 2,200 pika biznesi dhe rreth 23,000 punonjës. RBG përbëhet nga Bankat Raiffeisen në nivel lokal, Bankat Raiffeisen Rajonale, në nivel krahine dhe RZB si institucion qendror. RZB vepron gjithashtu si “ndërmjetës” mes operacioneve të saj ndërkombëtare dhe RBG-së. Bankat Raiffeisen janë institucione krediti kooperative private, të cilat funksionojnë si banka me një shërbim të përgjithshëm për individë. Çdo bankë Raiffeisen krahinore është pronare e bankës rajonale Raiffeisen respektive që në tërësinë e tyre zotërojnë rreth 88% të aksioneve të RZB.

Banka Raiffeisen i ka fillimet nga iniciativa e një reformatori social gjerman Friedrich Wilhelm Raiffeisen (1818-1888), i cili me krijimin e kooperativës bankare më 1862, vuri themelin e organizimit global të shoqërive kooperative Raiffeisen. Vetëm 10 vjet pas themelimit të kooperativës bankare Austriake Raiffeisen në 1886, rreth 600 banka kursimi dhe krediti funksiononin sipas sistemit Raiffeisen në të gjithë vendin. Sipas parimit themelor të vetë-ndihmës, promovimi i interesave të anëtarëve është objektivi kryesor i politikave të tyre të biznesit

Raiffeisen Bank International

Raiffeisen International Bank AG (RBI) ka shtrirë aktivitetin e saj tregëtar në rajonet kryesore të Evropës Qendrore dhe Lindore përfshirë këtu edhe Austrinë. Në Evropën Qendrore dhe Lindore RBI operon si bankë universale që ka në vartësi një rrjet bankar, kompanish lizingu dhe disa shërbime të specializuara shërbimesh financiare në 17 vende. Në Austri, RBI është një nga bankat kryesore tregëtare dhe investuese. Ajo është e pranishme edhe në qendrat financiare të botës dhe ka degët dhe zyrat përfaqësuese në Azi. Në fund të vitit 2010 rreth 60,000 punonjës ju kanë shërbyer 14 milionë klientëve në rreth 3,000 qendra biznesi. Totali i asetëve të grupit është rreth 131.2 miliard Euro.

RBI lindi nga bashkimi i Raiffeisen International Bank AG-Holding (RI), me fushat kryesore të biznesit të Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB), në vjeshtë të 2010. Duke siguruar njohjen e saj të mirë për klientët individë dhe korporatave dhe bashkimin e produkteve të RI dhe RZB, RBI ka rindërtuar veten strategjikisht si një grup bankar universal në rajonin e Evropës Qendrore dhe Lindore. Deri më tani manaxhimi i

riskut dhe përmirësimi thelbësor i aksesit në tregun e kapitalit dhe të të gjithë produkteve sigurojnë që banka është e aftë të rritet akoma në të ardhmen dhe të përballojë sfidat.

Aksionet e RBI-së, të cilat janë të përfshira në ATX, Bankat e Euro DJ Stoxx dhe indekse të tjera të mëdha, janë të publikuara në bursën e Vjenës. Rreth 21.5 përqind të aksioneve mbahen nga investitorët ndërkombëtarë, kryesisht në Mbretërinë e Bashkuar dhe SHBA, si dhe nga ana e investitorëve privat austriakë. Aksionet e mbetura (rreth 78.5 përqind) mbahen në mënyrë indirekte nga RZB. Me të dhënat e saja afat-gjatë "A" (S&P, Fitch) dhe "A1" (Moody's), RBI është gjithashtu një lëshues i rregullt i letrave me vlerë.

RZB

Themeluar më 1927, Raiffeisen Zentralbank Österreich AG (RZB) është institucioni qendror i Austrian Raiffeisen Banking Group (RBG) dhe vepron si qendra e grupit për të gjithë grupin RZB, duke përfshirë këtu edhe RBI-në. RZB funksionon si lidhja kryesore midis Austrian Raiffeisen Banking Group dhe RBI-së, me rrjetin e saj bankar në Evropën Qendrore dhe Lindore dhe disa veprimatrive ndërkombëtare.

RZB Group

Grupi zotërohet dhe drejtohet nga RZB-ja. Raiffeisen Bank International është njësia më e madhe e këtij grupi.

